Gjatë vitit 2012 në fokusin e vizitave parandaluese të MPN-së ishin institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe spitalet psikiatrike, me ç'rast u vizituan të gjitha institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe institucionet publike shëndetësore – spitalet psikiatrike në Republikën e Maqedonisë. Në vitin 2012, janë realizuar gjithsej 32 vizita parandaluese në vendet e privimit nga liria. Gjatë realizimit të vizitave MPN-ja hasi në bashkëpunim të kënaqshëm dhe konstruktiv nga ana e zyrtarëve dhe realizoi kontroll të papenguar në të gjitha hapësirat, objektet dhe instalimet sipas zgjedhjes së vetë, si dhe zhvilloi bisedë me persona të privuar nga liria sipas zgjedhjes së vetë, pa mbikëqyrje dhe pa dëshmitarë. Në asnjë rast, ekipit të MPN-it nuk iu kufizua hapësira e lëvizjes, e as liria e përzgjedhjes së personave për bisedë. Mekanizmi Parandalues Nacional, në bazë të gjendjeve të konstatuara, harton raport të veçantë me gjendjet e konstatuara dhe rekomandimet përkatëse, të cilin Avokati i Popullit ua dërgon organeve kompetente dhe propozon masa të cilat duhet të ndërmerren, me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe të trajtimit të personave në vendet për privim nga liria.

Mekanizmi Parandalues Nacional arriti të vendos dialog konstruktiv me organet dhe institucionet shtetërore, në atë mënyrë që në vazhdimësi e ndjek gjendjen me

zbatimin e rekomandimeve nga ana e organeve dhe institucioneve shtetërore. Organet kompetente, personat zyrtarë në organet, organizatat dhe institucionet në të cilat liria e lëvizjes është e kufizuar, në përputhje me nenin 3 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Avokatin e Popullit, e kanë për detyrë të veprojnë sipas sugjerimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ndërsa për veprimin ta informojnë brenda 30 ditësh, nga dita e marrjes së raportit të veçantë.

MPN-ja nga raportet e veçanta me rekomandime të dërguara, gjatë vitit 2012, ka marrë përgjigje në kohë vetëm nga 12 organe dhe institucione, në përputhje me afatin e paraparë ligjor, ndërsa për numrin tjetër të raporteve, ekipi i MPN-së në mënyrë plotësuese ka dërguar urgjencë në drejtim të marrjes së përgjigjes nga institucionet kompetente. Të gjitha organet pas urgjencave të dërguara, në mënyrë përkatëse kanë dërguar përgjigje, ndërsa gjatë kohës së hartimit të këtij Raporti vjetor MPN-ja ende priste përgjigje nga tre organe/institucione ku afati ligjor prej 30 ditësh pas marrjes së raportit të veçantë ende nuk kishte skaduar.

Sa i përket veprimit të katër ministrive kompetente (Ministra e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Ministria e Shëndetësisë) në 16 raste MPN-ja ka marrë përgjigje në kohë sipas raporteve të dorëzuara të posaçme nga vizitat e rregullta dhe për ri-kontroll, ndërsa sipas raporteve të tjera, ka dërguar urgjenca deri te ministrinë kompetente, me ç'rast numri më i madh i urgjencave iu dërguan Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa vetëm një urgjencë Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Maqedonisë. Gjatë hartimit të këtij Raporti vjetor MNP-ja ende priste përgjigje për tre raporte, ku afati ligjor prej 30 ditësh pas marrjes së raportit të veçantë ende nuk kishte skaduar.

Si shembull pozitiv MNP-ja dëshiron ta theksojë iniciativën e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë për mbajtjen e takimeve të rregullta të punës, në të cilat do të diskutohet për vërejtje konkrete, rekomandimet dhe mendimet e MPN-së. Takimi i parë i këtillë i punës u mbajt më 09.10.2012, me përfaqësuesit e Sektorit për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe përfaqësuesit e Sektorit të Policisë dhe Çështjeve Kriminalistike të Byrosë për Sigurim Publik të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në takim u diskutuan gjendjet e konstatuara dhe rekomandimet e dhëna në raportet e dërguara të veçanta dhe njëkohësisht MPN-ja u njoftua me konkluzionin e grupit të punës në lidhje me atë se cilat hapësira në SPKP-t plotësojnë standardet e nevojshme për mbajtje. Në takim u ra dakord që MPN-së t'i dërgohet Plani i veprimit për rinovimin e hapësirave për mbajtje në stacionet policore në periudhën 2012-2015.

C Qasja multidisiplinare e vizitave parandaluese të MPN-së

Avokati i Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional në vitin raportues ka siguruar një qasje multidisiplinare gjatë realizimit të vizitave parandaluese përmes nënshkrimit të Memorandumit për bashkëpunim me Shoqatën e Psikiatërve të Republikës së Maqedonisë. Në përputhje me nenin 4 të Ligjit për ratifikimin e Protokollit Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Llojeve tjera të Trajtimit apo Ndëshkimit Brutal, Jonjerëzor ose Nënçmues („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 165/2008), Avokati i Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional u pajtua që Shoqata e Psikiatërve të Republikës së Maqedonisë, si një shoqatë profesionale e psikiatërve të Republikës së Maqedonisë, në bashkëpunim me Avokatin e Popullit, të ndërmarrë një pjesë të kompetencave të Mekanizmit Parandalues Nacional, d.m.th., të ndërmarrë kompetenca dhe aktivitete në pjesën e sigurimit të ekspertizës psikiatrike gjatë kryerjes së vizitave parandaluese dhe hartimit të raporteve të posaçme. Në përputhje me Memorandumin, përfaqësuesit zyrtar të Shoqatës së Psikiatërve të Republikës së Maqedonisë do ta sho-

qërojnë ekipin e MPN-së gjatë realizimit të vizitave të caktuara dhe do të kontribuojnë në hartimin e raportit të veçantë për vizitën e realizuar.

Përfaqësuesve të autorizuar të shoqatës së psikiatërve u sigurohet një qasje e papenguar deri te vendet e privimit nga liria dhe instalimet e objektet e tyre, si dhe mundësi për biseda pa mbikëqyrje me personat e privuar nga liria pa dëshmitarë dhe atë ose personalisht ose me përkthyes, nëse kjo konsiderohet si e nevojshme. Ata kanë qasje në dokumentacionin mjekësor dhe në çdo informacion tjetër i cili do t'u shërbejë për konstatimin e gjendjeve dhe njëkohësisht detyrohen ta respektojnë konfidencialitetin e informacioneve të mbledhura gjatë ndërmarrjes së ndonjëres nga kompetencat e Mekanizmit Parandalues Nacional.

Ekipi i MPN-së, së bashku me bashkëpunëtorin e jashtëm-psikiatër, realizoi vizitë në Institucionin Edukues-Korrektues "Idrizovë" – Shkup, në tre spitalet psikiatrike dhe në Entin Special Demir Kapi. Përfshirja e bashkëpunëtorit të jashtëm-psikiatrit në vizitat parandaluese të MPN-së, si dhe marrja e mendimit të specialistit dhe raportit të shkurtër, të përgatitur nga ana e psikiatërve, është ndihmë e madhe për realizimin me sukses të kompetencës së MPN-së përmes sigurimit të qasjes profesionale dhe kompetente në lidhje me problematikën që është objekt i analizës.

Ç. Struktura organizative dhe buxheti i MPN-së

MPN-ja funksionon si një njësi e veçantë e ndarë organizative në përbërje të Avokatit të Popullit, detyra themelore e së cilës është parandalimi i torturës dhe llojeve tjetra të trajtimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose degradues. Mekanizmi Parandalues Nacional punon në përputhje me Metodologjinë e posaçme e cila, mes tjerash, përfshin edhe një sistem të vizitave të rregullta parandaluese në të gjitha vendet e privimit nga liria që janë nën juridiksionin e shtetit.

Ekipin e Mekanizmit Parandalues Nacional e përbëjnë tre këshilltarë për parandalimin nga tortura dhe trajtimi apo ndëshkimi tjetër brutal, jonjerëzor ose nënçmues. Anëtarët e MPN-së janë juristë e diplomuar të cilët i përmbushin parakushtet dhe kriteret e nevojshme për kryerjen e mandatit të Mekanizmit Parandalues Nacional në përputhje me OPCAT. Në ekip janë të përfshirë anëtarë të të dy gjinive, ndërkaq ka edhe përfaqësime etnik përkatës.

Në përputhje me nenin 18, paragrafin, 3 të Protokollit Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Llojeve tjera të Trajtimit Brutal, Jonjerëzor, Nënçmues ose Ndëshkues, shtetet pjesëmarrëse ndërmarrin obligimin për t'i vënë në dispozicion resurset e nevojshme për funksionimin e mekanizmave parandaluese nacionale³. Me emërimin e Avokatit të Popullit për të vepruar si një Mekanizëm Parandalues Nacional, Republika e Maqedonisë nuk ka ndarë mjete të posaçme financiare, të nevojshme për kryerjen e detyrave të MPN-së, të cilat dalin nga Protokollin Opsional. Për këtë shkak, gjatë vitit 2012, MPN-ja nuk kishte në dispozicion një zë të posaçëm buxhetor në përbërjen e buxhetit të Avokatit të Popullit përmes së cilit në mënyrë të drejtpërdrejtë do të vendoste për nevojat e veta dhe në mënyrë përkatëse do të dispononte në drejtim të sigurimit të pavarësisë së plotë operative dhe funksionale gjatë veprimit së tij. Mekanizmi Parandalues Nacional për aktivitetet e realizuara në vitin 2012 përdori mjete nga buxheti i përgjithshëm i Avokatit të Popullit.

³ Neni 18, paragrafi 3 të Protokollit Fakultativ të Konventës kundër Torturës dhe Llojeve tjera të Trajtimit Brutal, Jonjerëzor, Nënçmues ose Ndëshkues.

D. Dukshmëria dhe transparenca në punën e MPN-së

Mekanizmi Parandalues Nacional në drejtim të sigurimit të transparencës në punë, përmes faqes së internetit të Avokatit të Popullit në kohë e njoftonte publikun për të gjitha aktivitetet e tij të realizuara gjatë vitit 2012. Avokati i Popullit – MPN në mënyrë efikase i përditësonte informacionet e shkurtra për të gjitha aktivitetet e tij, vizitat e realizuara dhe mendimet e iniciativat e dhëna, ndërsa në të njëjtën faqe janë në dispozicion edhe rregullat dhe standardet relevante ndërkombëtare, si dhe korniza ligjore vendase nga fusha e parandalimit dhe mbrojtjes nga tortura. Të gjitha këto të dhëna janë në dispozicion në tri gjuhë: maqedonisht, shqip dhe anglisht, në linkun në vijim:

http://www.ombudsman.mk/ombudsman/MK/nacionalen_preventiven_mehanizam

Avokati i Popullit – MPN konsideron se transparenca në punë rrit vetëdijen tek qytetarët e Republikës së Maqedonisë dhe shërbimet në organet dhe institucionet për privim nga liria për gjendjen në vendet e privimit nga liria dhe për vendosjen dhe realizimin e të drejtave të kësaj kategorie personash.

Dh. Aktivitete ndërkombëtare të MPN-së

Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës për zhvillimin e kapaciteteve të mekanizmave parandaluese nacionale evropiane, Avokati i Popullit si MPN ishte nikoqir i ekipeve të formuara dhe operative të MPN-ve të vendeve të Evropës Juglindore – ekipet nga Shqipëria dhe Sllovenia. Në takim, përfaqësuesit e mekanizmave parandaluese kanë shkëmbyer përvoja nga puna e tyre dhe kanë realizuar vizitë të përbashkët parandaluese në Stacionin Policor Karposh në Shkup.

Njëkohësisht, në kuadër të projektit të njëjtë të Këshillit të Evropës në Tiranë, Republika e Shqipërisë, u organizua një takim pune i mekanizmave parandalues nacionalë të: Maqedonisë, Shqipërisë, Sllovenisë dhe Serbisë. Në takim, u shkëmbyen përvojat dhe metodologjitë për realizimin e vizitës së një institucion psikiatrik, ndërkaq u realizua edhe një vizitë e përbashkët në Klinikën Universitare të Psikiatrisë në Tiranë ku u dhanë udhëzime dhe rekomandime për tejkalimin e mangësive të konstatuara.

Përfaqësuesi i Mekanizmit Parandalues Nacional ka marrë pjesë në një takim pune në Gjenevë, Zvicër, i organizuar dhe i mbështetur nga Këshilli i Evropës përmes Projektit për vendosjen e një rrjeti aktiv të mekanizmave parandaluese nacionalë. Në këtë takim pune, përveç mekanizmave parandalues nacionalë, kanë marrë pjesë edhe organe të tjera ndërkombëtare që janë të përfshira në parandalimin dhe mbrojtjen nga tortura dhe llojet e tjera të trajtimit dhe ndëshkimit brutal, jonjerëzor ose nënçmues gjatë deportimit të imigrantëve ilegal. Në të njëjtin takim u përfshinë ekspertë nga: Komiteti Evropian për parandalimin e Torturës, Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës, Asociacioni për Parandalimin e Torturës, përfaqësues të BE-ja dhe anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare për Migrim.

Aktivitetet ndërkombëtare kanë vazhduar me atë që përfaqësuesi i MPN-së mori pjesë në punëtorinë e nëntë tematike të Mekanizmave Evropiane Nacionale në temë: "Imigrantë ilegal, Fronteks dhe Mekanizmat parandalues nacional" që nën patronazhin e Këshillit të Evropës u mbajt në Beograd, Republika e Serbisë. Në takim, morën pjesë përfaqësues nga shumica e MPN-ve nga Evropa, ndërsa diskutimi u zhvillua në drejtim të përcaktimit të rolit të mundshëm të MPN-së, në monitorimin e kthimit të imigrantëve ilegal në vendet e tyre, si edhe pranimin e imigrantëve të kthyer sipas marrëveshjeve për riatdhesim. Përfaqësuesi i Mekanizmit Parandalues Nacional i Republikës së Maqedonisë mbajti një fjalim.

Në kuadër të projektit Tuining për mbështetje të Avokatit të Popullit, në të cilin morën pjesë Ombudsmeni Nacional i Spanjës dhe Ndërmjetësuesi i Francës, u realizuan tre aktivitete gjatë vitit 2012. Aktiviteti i parë ishte një takim pune me Mekanizmin Parandalues Nacional të Spanjës (MPN), në të cilin u këmbyen përvoja nga vizitat parandaluese në vendet e privimit nga liria. Dy ekipet së bashku vizituan Stacionin Policor në Kavadar dhe bënë vërejtje dhe udhëzime të përbashkëta për përmirësimin e gjendjeve dhe trajtimin e personave të arrestuar dhe të paraburgosur. Në kuadër të aktivitetit të dytë të këtij projekti, përfaqësuesi i MPN-së mori pjesë në vizitën studimore të Ombudsmanit të Spanjës. Gjatë qëndrimit studimor, përfaqësuesi i MPN-së mbajti takime pune me nikoqirët, dhe njëkohësisht u vizitua edhe Qendra për të Mitur në Madrid. Me mbështetjen e projektit të njëjtë u realizua edhe aktiviteti i fundit në formë të takimit të punës të Avokatit të Popullit si MPN me përfaqësues të MPN-së të Spanjës dhe përfaqësues të Ombudsmanit të Francës. Në kuadër të takimit të punës u paraqitën dhe raporte vjetore të mekanizmave parandalues për vitin 2011, ndërsa MPN-ja e Maqedonisë e prezantoi raportin e veçantë për vizitën e realizuar në Stacionin Policor Kavadar. Njëkohësisht, në këtë takim të fundit u theksua rëndësia nga bashkëpunimi i deritanishëm, si edhe nevoja për vazhdimin me aktivitete të ngjashme me qëllim të realizimit të suksesshëm të autorizimeve që i ka MPN në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Në organizim të Asociacionit të Ombudsmanëve të Mesdheut, në Paris u realizua një trajnim në temë: "Ballafaqimi i Ndërmjetësuesve dhe Ombudsmanëve me fenomenin e migrimit" në të cilin mori pjesë edhe një përfaqësues i Mekanizmit Parandalues Nacional të Republikës së Maqedonisë. Në trajnim u përfshin tema për realizimin e standardeve të Këshillit të Evropës dhe Gjykatës së Evropës për të Drejtat e Njeriut në trajtimin e imigrantëve, pastaj si komunikojnë Ombudsmanët dhe si vijnë në kontakt me imigrantët, kontrolli i Ombudsmanit të Evropës mbi agjencitë evropiane që bëjnë kthimin e imigrantëve ilegal dhe të cilët u bëjnë kontroll kufijve të jashtëm të BE-së. Njëkohësisht, u diskutua edhe për atë se cili është ndikimi i Ombudsmanit mbi politikat publike me të cilat rregullohet procedura dhe trajtimi i imigrantëve, gjendja me personat e mitur të pashoqëruar, si edhe standardet e tjera ndërkombëtare dhe nacionale për mbrojtjen e imigrantëve.

2 VIZITAT PARANDALUESE NË VITIN 2012

Avokati i Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional në bazë të autorizimeve që i ka me ratifikimin e Protokollit Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Llojeve tjera të Trajtitimit apo Ndëshkimit Brutal, Jonjerëzor ose Nënçmues, në vitin 2012 ka përgatitur një plan vjetor për parandalimin e torturës dhe në përputhje me të njëjtin ka ndër marrë aktivitetet nga më shumë aspekte.

Mekanizmi Parandalues Nacional ka kompetencë ta analizojë trajtimin ndaj personave të privuar nga liria në vendet e privimit nga liria, t'u jep rekomandime autoriteteve relevante me qëllim të përmirësimit të trajtimit dhe kushteve për personat e privuar nga liria, si dhe t'i paraqesë propozimet dhe pikëpamjet e tij në lidhje me legjislacionin ekzistues apo draft-legjislacionin.

Në përputhje me kompetencën, ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional, gjatë vitit 2012, pati një qasje të papenguar deri te të gjitha informacionet të cilat kanë të bëjnë me: numrin e personave të privuar nga liria, trajtimin e këtyre personave, kushtet e privimit të tyre nga liria, si edhe qasjen deri te të gjitha vendet e privimit nga liria dhe instalimet e objektet e tyre.

Këtij ekipi iu mundësua që pa mbikëqyrje dhe pa dëshmitarë të bisedojë me personat e privuar nga liria, si edhe me çdo person tjetër për të cilin Mekanizmi Parandalues Nacional konsideron se mund të jep informacione relevante dhe njëkohësisht pati edhe liri gjatë zgjedhjes së vendeve që i ka vizituar dhe personat me të cilët ka biseduar.

Në vitin 2012, Mekanizmi Parandalues Nacional ka realizuar gjithsej 32 vizita parandaluese nga të cilat 25 kanë qenë të rregullta, dhe 7 kanë qenë vizita për ri-kontroll. Me vizitat e rregullta në vendet e privimit nga liria, MPN-ja i përcaktonte kushtet e qëndrimit dhe strehimit të personave të privuar nga liria, realizimin e të drejtave, si edhe identifikimin e rreziqeve të mundshme nga tortura dhe trajtimi apo ndëshkimi tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues, ndërsa me vizitat për ri-kontroll ekipi i MPN-së bënte vlerësimin e implementimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e posaçme nga vizitat që ishin realizuar gjatë vitit 2011. Të gjitha vizitat e rregullta u realizuan pa paralajmërim dhe atë në 12 stacione policore, 7 institucione ndëshkuese-korrektuese, 3 institucione psikiatrike si dhe në 3 institucione të tjera (Qendra për Pranimin e të Huajve, IP Enti Special Demir Kapi dhe IP për Kujdesin e Fëmijëve me Probleme Edukative-Sociale "25 Maji" Shkup). Për këto vizita departamenti për parandalim ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të posaçme me gjendjet e konstatuara dhe rekomandime deri te institucionet përkatëse dhe ministritë kompetente. Vizitat e ri-kontrollit u realizuan në pesë stacione policore me kompetencë të përgjithshme, në një institucion ndëshkues-korrektues dhe në një institucion edukues-korrektues.

A. STACIONET POLICORE

Në vitin 2012, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizita të paparalajmëruara në 12 stacione policore me kompetencë të përgjithshme (SPKP), të cilat në përputhje me vendimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme janë përcaktuar si vende për mbajtjen e personave. Sipas vendimit, personat mund të mbahen në të gjitha 38 stacione policore me kompetencë të përgjithshme, ndërsa në bazë të Programit vjetor të Mekanizmit Parandalues Nacional janë vizituar stacionet policore në vijim: SP Karposh, SP Qendër, SP Shën Nikollë, SP Radovish, SP Kavadar, SP Kratovë, SP Dibër, SP Gjevgjeli, SP Dellçevë, SP Gjorçe Pertov, SP Strugë dhe SP Gazi Babë. Vizitat e rregullta të stacioneve policore u realizuan në përputhje me Programin vjetor të Avokatit të Popullit – Mekanizmin Parandalues Nacional dhe sipas Metodologjisë së punës të përcaktuar paraprakisht. Konform Metodologjisë së përcaktuar, Mekanizmi Parandalues Nacional harton raporte të veçanta për çdo vizitë të realizuar. Raportet e veçanta të MPN-së janë me karakter sekret dhe përmbajnë një analizë të gjendjeve, konstatime dhe rekomandime për tejkalimin e mangësive të konstatuara. Për vizitat e realizuara të stacioneve policore në vitin 2012 janë hartuar dhe dërguar raporte të veçanta. Çdo raport përmban gjendjet pozitive dhe negative, si edhe rekomandimet në dy nivele:

- rekomandime deri te organi udhëheqës i institucionit ose entit që është vizituar, të cilat kanë të bëjnë me gjendjet që janë nën kompetencë të atij organi dhe ku gjendjet e konstatuara negative mund të tejkalohen përmes ndërmarrjes së punëve dhe masave të caktuara nga ana e vet institucionit ose entit dhe

- rekomandime deri te organi kompetent i hierarkisë (ministra) që kërkojnë plotësimin e parakushteve të caktuara tekniko-materiale, implikime buxhetore, ndryshime të akteve ligjore dhe nënligjore, me qëllim të përmirësimit të mangësive të konstatuara.

Vizitat e rregullta parandaluese në masë të madhe u realizuan pa paralajmërim ose më saktë nga 12 vizita të realizuara të stacioneve policore, 10 ishin vizita të paparalajmëruara, ndërsa për vizitat e SP Karposh dhe SP Kavadar u paralajmërua realizimi i vizitave, pa u treguar data konkrete, për shkak të pranisë së delegacioneve të mekanizmave parandalues nacionalë të: Sllovenisë, Shqipërisë dhe Spanjës. Në SP Karposh, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të përbashkët me përfaqësuesit e MPN-së së Sllovenisë dhe Shqipërisë, ndërsa në kornizat e Tuining projektit për mbështetje të MPN-së u realizua një vizitë në SP Kavadar me ekipin e MPN-së të Spanjës.

Gjatë vizitave të stacioneve policore, MPN-ja hasi në bashkëpunim konstruktiv nga ana e zyrtarëve dhe realizoi kontroll të papenguar në të gjitha hapësirat dhe dokumentet që e rregullojnë materien e mbajtjes së personave të privuar nga liria.

Trajtimi i personave të privuar nga liria

Gjatë vizitës së stacioneve policore, MPN-ja hasi dy persona të ndaluar në SP Qendër dhe dy persona të ndaluar në SP Kratovë. Gjatë bisedës me një person të ndaluar MPN-ja pranoi ankesë se ai nuk ishte trajtuar në mënyrë profesionale nga momenti i privimit nga liria dhe nuk ka qenë i njoftuar me shkaqet e privimit, e as me shkakun se pse e dërgojnë në stacionin policor (SP Qendër). Njëkohësisht, i njëjti person u ankua për keqtrajtim fizik nga disa nëpunës të policisë të cilët e kanë rrahur në pjesën e kokës dhe shpinës gjatë qëndrimit në stacion.

Në të njëjtin stacion policor, në bisedë me personin e dytë të ndaluar, MPN-së iu

pohua se personi i parë i ndaluar ishte rrahur nga nëpunësit e policisë, ndërkaq kur ka kërkuar ujë, atij nuk i ishte mundësuar të pinte ujë. Personi i dytë i ndaluar ka thënë se nuk ka qenë i njoftuar për shkaqet e ndalimit nga ana e Njësisë Speciale për Luftë Kundër Krimit "Alfa", ndërsa pastaj kur është shoqëruar në SP Qendër së pari është mbajtur në hapësirë për mbajtje, ndërsa pastaj është vendosur në dhomën e pritjes, sepse në hapësirën e mbajtjes ka qenë i vendosur personi i parë i ndaluar. Ky person, gjithashtu, tregoi se nuk i ishte dhënë as ujë, as ushqim gjatë gjithë kohës derisa ka qenë i arrestuar dhe i mbajtur në stacion. MPN-ja ua bëri me dije dy personave se mund të parashtrajnë parashtrësë dhe të kërkojnë mbrojtje nga Avokati i Popullit, ndërsa gjatë këqyrjes në dokumentet individuale u konstatua se personat janë udhëzuar për të drejtat e tyre gjatë përpilimit të procesverbalit për ndalim.

Në raportin e veçantë të dërguar deri te SP Qendër dhe Ministria e Punëve të Brendshme, MPN-ja ka shprehur shqetësim për mënyrën e mbajtjes së personave në këtë stacion policor, sidomos gjatë orëve të natës, në ato situata kur duhet të mbahen dy ose më shumë persona, duke pasur parasysh se ky stacion ka në dispozicion vetëm një hapësirë individuale për mbajtje. Njëkohësisht, Avokati i Popullit – MPN ka kërkuar të analizohen të dhënat në lidhje me keqtrajtimin fizik dhe pamundësinë e realizimit të së drejtës për ujë dhe ushqim, gjë që duhet të mundësohet nga ana e zyrtarëve.

MPN-ja në bisedën me personat e ndaluar në SP Kratovë nuk ka marrë ankesa për keqtrajtim fizik nga ana e zyrtarëve të policisë gjatë mbajtjes, si edhe në lidhje me realizimin e të drejtave në procedurën e policisë, por u informua se gjatë ndalimit personat ishin kërcënuar nga zyrtarët.

Kushtet materiale:

Hapësira për mbajtje

Gjatë vizitave në vitin 2012 u realizua kontroll në 4 stacione policore me kompetencë të përgjithshme me hapësira të reja dhe të rinovuara për mbajtje dhe në 8 stacione policore me kompetencë të përgjithshme me hapësira të vjetra. Në përgjithësi, në hapësirat e vjetra të mbajtjes pjesërisht janë apo nuk janë të plotësuar standardet e dëshiruara ndërkombëtare, ndërsa gjatë vizitës së stacioneve policore u konstatuan hapësira për mbajtje në pjesën e bodrumit (SP Dellçevë, SP Kavadar, SP Radovish), si edhe hapësira që nuk i plotësojnë standardet sa i përket madhësisë, ngrohjes dhe ndriçimit (SP Shën Nikollë, SP Kratovë, SP Dibër), ndërkaq në disa stacione policore, për shkak të mungesës së hapësirave përkatëse për mbajtjen e personave të privuar nga liria, përdoren zyrat zyrtare (SP Strugë dhe SP Gjorçe Petrov). Edhe pse në Stacionin Policor Strugë ka katër hapësira për mbajtjen e personave të privuar nga liria, këto hapësira nuk përdoren për mbajtje për shkak të mungesës së kushteve përkatëse, ndërsa personat e privuar nga liria vendosen në një zyrë zyrtare. Kjo hapësirë nuk ka në dispozicion mjete përkatëse për pushim (shtrat, dyshek, shtrojë) dhe nuk i plotëson kushtet për mbajtje më të gjata gjatë orëve të natës. Mekanizmi Parandalues Nacional u informua se mbajtja në këtë hapësirë është e përkohshme, d.m.th., me intervale të shkurtra, por pas kontrollit të regjistrit të personave të privuar nga liria u konstatua se në Stacionin Policor Strugë ka edhe mbajtje gjatë natës dhe mbajtje më të gjata.

Në përbërje të Stacionit Policor Dellçevë ka tre hapësira të vjetra për mbajtje në bodrum të cilat gjenden në një objekt të posaçëm, fizikisht i ndarë nga vet stacioni policor. Mekanizmi Parandalues Nacional për disa stacione policore ka konstatuar se ka hapësira për mbajtje të cilat personin e ndaluar e vënë pozicion nënçmues, duke e vendosur në hapësirat e bodrumit (SP Dellçevë, SP Kavadar, SP Radovish), por edhe me ekspozimin e drejtpërdrejtë në shikimin e të punësuarve apo qytetarëve që vijnë

për të denoncuar ngjarje në stacionin policor (SP Strugë dhe SP Gjorçe Petrov). Në SP Dellçevë ku ka hapësira në bodrum, nuk ka asnjë qasje të veçantë për personat me aftësi të kufizuara fizike, por qasja deri te të njëjtat bëhet përmes shkallëve me çka mund ta vë në rrezik personin e privuar nga liria.

Për qasjen deri te hapësirat për mbajtje në SP Dellçevë, MPN-ja konstatoi se qasja bëhet vetëm nëpër shkallë të cilat janë mjaft të ngushta, të pjerrëta dhe të pasigurta, me çka rritet rreziku nga lëndimi jo vetëm i personave të privuar nga liria gjatë futjes së tyre në hapësirat e mbajtjes, por edhe i nëpunësve policorë. Hapësirat e SPKP Shën Nikollë gjenden në pjesën e bodrumit-qilarit të stacionit policor, ndërsa qasja deri te të njëjtat bëhet vetëm përmes shkallëve, më saktë nuk janë plotësuar standardet për qasje të personave me nevoja të posaçme, ndërkaq në SP Shën Nikollë nuk ka hyrje të posaçme të pasme deri te këto hapësira përmes së cilës do të hynin personat e arrestuar dhe të mbajtur.

Në SP Gjorçe Petrov, MPN-ja ka konstatuar se hapësira e vjetër për mbajtje është në afërsi të dhomës së pritjes dhe hyrjes në stacionin policor, kështu që në këtë aspekt personi i privuar nga liria mund të vihet në pozicion shumë nënçmues, madje edhe për vendosje të shkurtër në të. SP Gjorçe Petrov nuk e përdor këtë hapësirë për shkak të mungesës së kushteve, prandaj personat e privuar nga liria mbahen shkurtë në sallën e takimeve, ndërsa për mbajtje më të gjata personat transferohet në SP Karposh. Duke pasur parasysh se edhe në SP Dibër hapësirat e mbajtjes nuk i plotësojnë standardet e kërkuara, në këtë stacion mbajtja realizohet në një hapësirë të posaçme e cila gjendet në katin përdhes, e njëjta është e pajisur me mjete për pushim dhe gjendet në afërsi të zyrës së kujdestarisë, me çka sigurohet edhe mbikëqyrje e përforcuar dhe kujdes mbi personat e privuar nga liria.

Në pjesën më të madhe të stacioneve të vizituara policore të cilat kanë hapësira të vjetra, MPN-ja ka konstatuar se pjesërisht ose aspak nuk i plotësojnë standardet për mbajtjen e personave. Për disa prej tyre u konstatua se nuk i plotësojnë standardet sa i përket madhësisë së hapësirës për mbajtjen e personave (SP Shën Nikollë, SP Radovish), për një pjesë të tyre u konstatua se nuk kanë një sistem të posaçëm për thirrje, përkatësisht alarmim (SP Kavadar), ndërsa në disa të tjera nuk ka të instaluar sistem për ngrohje dhe u konstatuan temperatura të ulëta të cilat janë nën standardet e përcaktuara minimale (SP Shën Nikollë, SP Radovish, SP Kavadar, SP Kratovë, SP Dibër, SP Dellçevë). Në fakt, gjatë vizitës, në këto hapësira ishte mjaft ftohtë, ndërkaq për shkak se në to nuk janë vendosur trupa për ngrohje, parashtrohet pyetja se në cilën mënyrë të njëjtat ngrohen gjatë dimrit. Në hapësirat e vjetra të mbajtjes u vërejt lagështi, ndërsa në disa prej tyre nuk ishin plotësuar standardet sa i përket depërtimit të mjaftueshëm të dritës ditore ose artificiale (SP Shën Nikollë, SP Radovish, SP Kavadar, SP Kratovë).

Në lidhje me pajisjen e hapësirave të vjetra për mbajtje u konstatua se në pjesën më të madhe të tyre kishte shtrojë përkatëse, e cila mbahej në mënyrë të rregullt (SP Shën Nikollë, SP Dellçevë, SP Kavadar, SP Dibër), ndërsa në dy stacione policore shtretërit e vendosur ishin të fiksuar për dyshemenë, me çka rritet siguria e personave të privuar nga liria (SP Kratovë dhe SP Dellçevë).

Në një pjesë të stacioneve të vizituara policore, me qëllim të mbikëqyrjes më të madhe dhe kujdesit për personat e mbajtur, ishin vendosur sisteme për thirrje (SP Shën Nikollë, SP Dellçevë, SP Radovish, SP Kratovë), por gjatë kontrollit të SP Kratovë MPN-ja konstatoi se në hapësirën e parë për mbajtje aparati për thirrje ishte i dëmtuar, ndërsa në hapësirën e dytë aparati nuk ishte i vënë në funksion. Përmes sistemit të thirrjes, personat e mbajtur mund të alarmojnë për raste konkrete të urgjencës ose nevojës. Në pjesën ku nuk ka ose nuk funksionon sistemi i thirrjes MPN-ja ka shprehur shqetësim në lidhje me atë se në ç'mënyrë personat e privuar nga liria do t'i lajmërojnë në kohë nëpunësit e policisë për nevojat e tyre. Në asnjë nga hapësirat e vjetra për mbajtje nuk ka instalim për video-mbikëqyrje, por mbikëqyrja bëhet drejtpërdrejtë

nga ana e nëpunësve të policisë dhe udhëhiqen lista kontrolluese për personat e mbajtur. Gjatë kontrollit në hapësirat e SP Kratovë, ishte evidente se në derë ka vend të posaçëm për fletën e kontrollit (karton i personit të mbajtur). Si mbrojtje shtesë edhe në SP Shën Nikollë realizohet mbikëqyrje e drejtpërdrejtë mbi personat e mbajtur, që regjistrohet në një fletë të posaçme kontrolluese, me qëllim që me kohë dhe në mënyrë preventive të vepohet në rast të paraqitjes së nevojës për veprim urgjent. Praktika e këtillë realizohet edhe në SP Dellçevë, SP Kavadar, ndërsa ky lloj rekomandimi iu dërgua SP Radovish, duke pasur parasysh se personat mbahen në hapësirat e bodrumit në të cilat nuk ka video-mbikëqyrje, me qëllim të mbrojtjes së personave që vendosen në të njëjtat.

Nga kontrolli i realizuar i Mekanizmit Parandalues Nacional, veçanërisht është shqetësuese gjendja në SP Strugë, kur personat e mbajtur qëndrojnë në zyrën zyrtare, e cila nuk i plotëson as standardet e sigurisë për vendosjen e personave të privuar nga liria, e as nuk ka në dispozicion mjete adekuate për pushim. Në bazë të këqyrjes në evidencën e SP Strugë u konstatua se një mbajtje ka zgjatur më shumë se 15 orë dhe e njëjta është zbatuar në orët e natës, si dhe mbajtje të një personi të mitur, i cili ka qenë gjatë orëve të natës edhe atë nga ora 18:50 deri në orën 06:30 ditën e ardhshme. Për këto raste nuk ishte regjistruar ndonjë informacion se personat ishin transferuar në një stacion tjetër policor, ndërkaq edhe nga informacioni i përgjegjësit të turnit u vërtetua se hapësira e njëjtë përdoret edhe për mbajtje më të gjata edhe për mbajtja të natës. Në këtë drejtim, MPN-ja kërkoi informacion edhe nga Ministria e Punëve të Brendshme, me ç'rast u informua se në përputhje me Planin aksionar për rinovimin e stacioneve policore, SP Strugë, është caktuar si stacion me prioritet, duke pasur parasysh gjendjen në të cilën gjenden hapësirat e vjetra për mbajtje, si edhe mbajtjet e përkohshme të personave të privuar nga liria në zyrën zyrtare.

Gjatë kontrollit të stacioneve policore, të cilat kanë hapësira të reja për mbajtje, MPN-ja ka konstatuar se të njëjtat i plotësojnë standardet e kërkuara dhe në to është vendosur shkallë e lartë e masave të sigurisë-mbrojtjes të cilat janë ndërmarr gjatë përzgjedhjes së materialeve dhe vetë ndërtimit të hapësirave për mbajtje. MPN-ja ka konstatuar se këto hapësira janë të bërë në mënyrë dhe nga materiale që mundësojnë një shkallë të lartë të mbrojtjes së personave nga lëndimet, ndërsa si një masë shtesë mbrojtëse është edhe fakti se në të gjitha hapësirat e reja ka video-mbikëqyrje përkatëse, si edhe fakti se shtretërit janë të fiksuar për dyshemenë, me çka pamundësohet përdorimi i tyre në mënyrë të parregullt dhe keqpërdorimi. Në vitin 2012 MPN-ja realizoi vizitë në: SP Karposh, SP Qendër, SP Gjevgjeli dhe SP Gazi Babë. Në një pjesë të tyre (SP Karposh) u konstatua se në lidhje me madhësinë janë plotësuar pjesërisht apo nuk janë plotësuar standardet e parashtruara nga Komiteti i Evropës për Parandalimin e Torturës (KPT) përkatësisht, hapësirat individuale janë më të vogla sesa standardi i përcaktuar prej 6-7 m² (në SP Karposh njëra hapësirë është me sipërfaqe prej 4,77 m², ndërsa e dyta është me sipërfaqe prej 5,70 m²). Situatë e ngjashme u vërejt edhe në SP Gazi Babë, për dallim nga SP Gjevgjeli dhe SP Qendër në të cilat u konstatua se, sa i përket madhësisë, i plotësojnë standardet e vendosura ndërkombëtare. Duhet të theksohet se MPB-ja ende nuk ka miratuar një Rregullore përkatëse për përcaktimin e standardeve të cilat duhet t'i plotësojnë vendet për mbajtje në stacion policor. Këto katër stacione policore kanë qenë të përfshira në projektin për rinovimin e vendeve për mbajtjen e personave të privuar nga liria, i cili është zbatuar nga ana e MPB-së, ndërsa është mbështetur financiarisht nga BE-ja. Në vitin e kaluar, Ministria ka përgatitur një Rregullore për normativat e përgjithshme dhe standardet që duhet t'i plotësojnë hapësirat për mbajtjen e personave në stacionet policore me kompetencë të përgjithshme, por për të njëjtën filloi procedura për ndryshimin dhe plotësimin e saj, me ç'rast edhe Avokati i Popullit – MPN dha mendimin e tij.

Në lidhje me furnizimin me pajisje të hapësirave të reja për mbajtje, është konstatuar se hapësirat e reja janë të pajisura me shtretër të standardizuar, të cilët kanë pajisjen përkatëse për pushime gjatë natës, por në SP Gjevgjeli u vërejt se shtretërit

nuk kanë shtojë dhe jastëkë, ndërsa gjatë kontrollit të SP Gazi Babë u konstatua se në hapësirat për mbajtje, këllëfët e jastëkëve nuk janë ndërruar dhe të njëjtë janë të fëlliqur.

Në hapësirat e reja për mbajtje është vendosur video-mbikëqyrja gjë që paraqet masë shtesë për mbrojtjen e personave të privuar nga liria, sidomos kur ata janë të shqetësuar në mënyrë të dukshme ose tek të cilët ekzistojnë instinkte të vetëlëndim. Përmes video-mbikëqyrjes ndiqet gjendja e personave të mbajtur, përmes një monitori i cili është i vendosur në shërbimin e kujdestarisë. Video-mbikëqyrje përkatëse ka edhe në korridorin para hapësirave për mbajtje dhe në hapësirat për marrjen në pyetje të personave. Gjatë kontrollit të funksionalitetit të video-mbikëqyrjes, MPN-ja konstatoi se në pjesë më të madhe e njëjta zhvillohet pa pengesa, por në SP Gazi Babë u konstatua se kamerat nuk ishin në rregull. Në këtë stacion policor, gjithashtu, nuk ishte në funksion edhe sistemi i thirrjes, prandaj parashtrohet pyetja se si thirren dhe njoftohen nëpunësit policorë kur personat e mbajtur kanë nevojë për ta, duke pasur parasysh se kamerat, në dy nga hapësirat, nuk ishin në funksion. Nga ana e nëpunësve policorë u tha se video-mbikëqyrja funksionon dobët edhe në orët e natës. Njëkohësisht, në SP Qendër u konstatua se imazhi që prodhon kamera e instaluar në hapësirën për mbajtje është pjesërisht i paqartë. Video-mbikëqyrja është e vendosur vetëm në hapësirat e reja për mbajtje. E njëjta nuk bëhet në tualetet për shkak të respektimit të privatësisë dhe integritetit të personalitetit të individëve të privuar nga liria. Në SP Gjevgjeli, është vendosur qartë dhe dukshëm një lajmërim që u mundëson personave të privuar nga liria të njihen me kryerjen e video-mbikëqyrjes. Regjistrimet e video monitorimit ruhen në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Duke pasur parasysh se MPN-ja në SP Qendër kishte marrë ankesa nga një person i mbajtur për maltretim fizik në periudhën e mbajtjes, dhe kjo kishte ndodhur në një pjesë të stacionit policor që është përtej përfshirjes së kamerave, MPN-ja kërkoi qasje deri te video materiali, me qëllim për të përcaktuar se në periudhën kohore a ka qëndruar personi jashtë hapësirës për mbajtje⁴. Me qëllim të përcaktimit të gjendjeve, ndërkaq në drejtim të zvogëlimit të rreziqeve gjatë veprimeve të ardhshme të ardhshme të nëpunësve policorë në këtë stacion, MPN-ja kërkoi nga Ministria qasje deri te materiali i video-mbikëqyrjes nga gjashtë kamerat e brendshme në SP Qendër.

Avokati i Popullit – MPN u njoftua se MPB-ja nuk ka mundësi ta sigurojë materialin e kërkuar, duke pasur parasysh afatin e shkurtër prej 14 ditësh për ruajtjen e të dhënave në bazën qendrore. Megjithatë, MPN-ja konsideron se për rastin në fjalë nuk i ishte mundësuar qasje deri te materialet e kërkuara nga video-mbikëqyrja, duke pasur parasysh se kërkesa ishte dorëzuar në kohë deri te ministria përkatëse.

Në ato stacione policore me kompetencë të përgjithshme ku janë ndërtuar hapësira të reja për mbajtje, MPN-ja ka sugjeruar që hapësirat e vjetra, në rastet kur të njëjtat ende ekzistojnë, të ri-dedikohen dhe të përdoren për qëllime të tjera (magazinë, arkiv etj.). Në të kundërtën ekziston rrezik që, në mungesë të vendit, këto hapësira të cilat nuk i plotësojnë standardet minimale, të përdoren përsëri për mbajtjen e personave. Kështu, MPN-ja konstatoi se nuk janë ri-dedikuar siç duhet hapësirat e vjetra në SP Karposh dhe SP Gazi Babë, edhe pse nga ana e MPN-së ishte përcaktuar se të njëjtat nuk përdoren tanimë një kohë më të gjatë (ishin të dukshme pezhishkat e merimangave përreth hapësirave)

Në pjesën e qasjes deri te stacionet policore, MPN-ja konstatoi se në pjesën më të madhe të rasteve nuk ka një platformë për personat me nevoja të posaçme në hyrje të stacionit policor. Platforma hyrëse deri te hapësirat e mbajtjes ishte e vërejtur

⁴ Personi ka deklaruar se para se të vendosej në hapësirën për mbajtje kishte kaluar nëpër shkallë të cilat çojnë drejt hapësirave të bodrumit, ku në njërin dorë i ishin vendosur mjete për lidhje (pranga), ndërsa me pjesën tjetër të prangave ishte lidhur për rrethojnë metalike të shkallëve. Personi i vendosur në këtë mënyrë ka qenë jashtë përfshirjes së kamerave të instaluar në stacionin policor. Personi u anka se në këtë mënyrë, në shkallë ishte mbajtur rreth 15-20 minuta derisa të qetësohej, ndërsa gjatë kësaj kohe ka qenë i keqtrajtur fizikisht (nëpunësit policorë i kishin rënë në pjesën e kokës dhe kurrizit).

në SP Karposh. Edhe pse hapësirat e reja për mbajtje kanë një hyrje të pasme, ka edhe raste kur deri te e njëjta nuk mund të arrihet, sepse është e rrethuar me makina (SP Qendër). Në këtë stacion policor qasja e makinave deri te hyrja e pasme është e vështirësuar për shkak të hapësirës së ngushtë dhe zonës së kufizuar të parkimit, e cila është e përbashkët me objekte të tjera me karakter publik.

Në stacionet policore me kompetencë të përgjithshme nuk ekzistojnë hapësira të posaçme për të bërë kontrollin e personit të mbajtur, ndërkohë që vetëm në hapësirat e rinovuara për mbajtje ekzistojnë arka të posaçme për ruajtjen e sendeve të konfiskuara përkohësisht. MPN-ja konsideron se Ministria e Punëve të Brendshme duhet t'i përkushtoj vëmendje më të madhe pajisjes së hapësirës së posaçme (gardërobë) me qëllim për të kryer kontrollin e personit, jashtë shikimit të nëpunësve të tjerë policorë dhe të pranishmëve të tjerë në stacionin policor. Në fakt, në disa stacione policore kontrolli personal mbi personat e arrestuar dhe të mbajtur realizohet në zyrën e kujdestarisë. Njëkohësisht, edhe në një pjesë të hapësirave të reja për mbajtje (SP Qendër dhe SP Gjevgjeli), MPN-ja konstatoi se kontrolli i personave realizohet në zyrën e kujdestarisë, me ç'rast shkelet e drejta e integritetit personal dhe dinjitetit të personave që janë të arrestuar ose të mbajtur në stacionin policor.

Gjatë kontrollit, në të gjitha stacione policore, MPN-ja nuk hasi në mjete ose sende të tjera të dyshimta me të cilat mund të bëhet presion, frikësim apo dhunë fizike ndaj personave. Megjithatë, në disa stacione të caktuara policore u vërejtën sende të cilat e rrisin rrezikun nga lëndimi ose vetëlëndimi i personave të privuar nga liria, ndërkaq në një stacion policor u vërejtën sende të sekuestruara në zyrat zyrtare ku zhvillohen biseda me personat e arrestuar ose të mbajtur, si dhe sende të cilat janë në afërsi të vendeve të mbajtjes. Edhe pse bëhet fjalë për sende të sekuestruara, ekipi i MPN-it konsideron se të njëjtat duhet të regjistrohen siç duhet dhe të ruhen në një magazinë të posaçme e jo në zyrat zyrtare dhe në afërsi të vendeve për mbajtje. Si një shembull pozitiv për ruajtjen e rregullt të sendeve të sekuestruara, MPN-ja e potencon SP Kratovë, ku të njëjtat ruhen në një vend adekuat, më saktë në hapësirën e bodrumit e cila është e siguruar siç duhet me derë metalike dhe grila, si dhe me grila metalike në dritare. Magazina për sende të sekuestruara përkohësisht është e ndarë tërësisht nga hapësirat e tjera të punës, në një objekt të posaçëm, që paraqet edhe një mbrojtje shtesë nga keqpërdorime të mundshme.

Tualetet

Kushtet në tualete dallohen edhe pse, në pjesën më të madhe të stacioneve të vizituara policore me kompetencë të përgjithshme, ku vendet për mbajtje nuk janë të rinovuara, u konstatua se nuk ka ndarje të tualeteve, më saktë tualetet e njëjta përdoren edhe nga personat e mbajtur edhe nga nëpunësit zyrtar të stacionit.

Në SP Shën Nikollë, në përbërje të hapësirave të vjetra për mbajtje, gjendet një tualet i cili përdoret vetëm për personat e mbajtur. Një tualet i posaçëm për personat e mbajtur u vërejt edhe në SP Kratovë, por MPN-ja konstatoi se i njëjti nuk është ndërtuar në mënyrën adekuate, përkatësisht qasja deri te hapësirat e mbajtjes realizohet përmes tualetit. Përdorimi i tualetit në këtë stacion policor mund t'i vë personat e privuar nga liria në një pozicion degradues dhe ta shkelë dinjitetin e tyre dhe integritetin personal. Njëkohësisht, u konstatuan edhe rreziqe të mundshme në lidhje me sigurinë e personave me pasqyrën e vendosur dhe materialet e tjera të thyeshme në tualetin.

Në këto stacione policore me kompetencë të përgjithshme, ku vendet e mbajtjes janë të reja, në përbërje të pjesës së rinovuar të stacionit policor ekzistojnë edhe tualete të posaçme të cilat përdoren vetëm nga personat e mbajtur. Vlerësim i përgjithshëm është se të njëjtat janë të reja, të ndërtuara në kornizat e projektit për rinovimin

e vendeve për mbajtjen e personave, ndërkaq në to higjiena mbahet në një nivel të kënaqshëm. Megjithatë, si edhe në raportin e vitit të kaluar, MPN-ja konstatoi se të njëjtat përmbajnë materiale që mund të thyhen lehtë, qelq, mbajtëse metalike për letrën higjienike, ndërsa në njërin prej tyre edhe zorrë dushi, që lehtë mund të keqpërdoren në drejtim të vetëlëndimit ose për të shkaktuar një lëndim personit të mbajtur. MPN-ja arriti në përfundim se gjatë projektimit dhe kryerjes së ndërtimit të tualeteve në vendet e reja për mbajtje nuk janë marrë parasysh rreziqet e sigurisë që mund të shfaqen në një objekt për mbajtjen e personave të privuar nga liria. MPN-ja, gjithashtu, gjatë secilës vizite sugjeronte të drejtën e privatësisë dhe intimitetit, në përputhje me atë që personat e privuar nga liria të pashoqëruar duhet të hyjnë në tualet.

Hapësira për bisedë dhe marrje në pyetje

Në vitin raportues MPN-ja realizoi vizitë në hapësirat e reja dhe të vjetra për mbajtje, ku sikurse në vitin 2011, ashtu edhe tani u konstatua se ekzistojnë dallime në pjesën e hapësirave për bisedë dhe marrje në pyetje dhe kushtet në to. Një pjesë e stacioneve policore nuk ka hapësira të posaçme për bisedë dhe marrje në pyetje të personave të privuar nga liria, ndërsa bisedat realizohen në varësi të parakushteve materialo-teknike të stacionit, si edhe në përputhje me koordinimin e inspektorëve të cilët e zhvillojnë bisedë me personat për të cilët ekzistojnë dyshime se kanë kryer vepër penale (hapësira të posaçme për bisedë dhe marrje në pyetje nuk ka në SP Kratovë, SP Shën Nikollë, SP Dellçevë, SP Dibër). Edhe pse në hapësirat e reja për mbajtjen e personave të privuar nga liria janë përcaktuar hapësira të posaçme për bisedë dhe marrje në pyetje, megjithatë në një stacion policor (SP Gazi Babë), MPN-ja hasi një situatë ku të njëjtat nuk ishin në funksion, ndërkaq biseda dhe marrja në pyetje e personave edhe më tej të zhvillohej në zyrat e inspektorëve. Në këtë drejtim, MPN-ja dha rekomandim që të vihen në përdorim dy zyrat për zhvillimin e bisedës me personat e privuar nga liria dhe biseda të zhvillohet vetëm në to e jo në zyrat zyrtare të inspektorëve, sepse të njëjtat janë të pajisura siç duhet dhe me materiale të cilat sigurojnë siguri si për personat e privuar nga liria ashtu edhe për personat zyrtarë të cilët e zhvillojnë bisedën dhe marrjen në pyetje të personave të arrestuar dhe të mbajtur. Sikurse edhe në vitin 2011 edhe në këtë vit raportues, MPN-ja konsideron se është e nevojshme që personat e privuar nga liria të merren në pyetje në hapësirat e caktuara në stacionet policore dhe sidomos një gjë e tillë të praktikohet aty ku janë ndërtuar hapësira të reja për marrje në pyetje, të cilat janë me video-mbikëqyrje të instaluar, si dhe me masa shtesë mbrojtëse me të cilat ulen rreziqet nga lëndimi ose vetëlëndimi. Në SP Karposh u konstatua se hapësirat e dedikuara për marrje në pyetje dhe bisedë me personat e privuar nga liria nuk janë të pajisura plotësisht nga aspekti teknik, përkatësisht me kompjuter dhe me mjete të tjera ndihmëse, me ç'rast biseda dhe marrja në pyetje e personave të mbajtur bëhet vetëm në njërin prej tyre. Gjithashtu, edhe në SP Qendër dhe SP Gjevgjeli jo gjithmonë biseda me personat e mbajtur realizohet në hapësirën e projektuar për atë qëllim, më saktë personat e privuar nga liria merren në bisedë edhe në zyrat zyrtare të inspektorëve policorë.

Makinat transportuese

MPN-ja, gjatë kontrollit të makinave transportuese, sikurse edhe në vitin 2011, konstatoi gjendjen me përdorimin e makinave të vjetra dhe të reja për transportin e personave të privuar nga liria. Edhe pse një pjesë të stacioneve policore kanë në dispozicion makina transportuese, në përputhje me standardet e përcaktuara sa i përket mbrojtjes, sigurisë dhe ventilimit, megjithatë, stacionet më të vogla policore nuk kanë

në dispozicion makina përkatëse për transport. Pra, SP Kratovë ka në dispozicion një furgon "Citroen, që është i vjetër dhe në gjendje defekti dhe për këtë shkak transporti bëhet me makina të tjera zyrtare, të cilat nuk janë të pajisura me masa të posaçme të sigurisë-mbrojtjes si për personat e privuar nga liria, ashtu edhe për nëpunësit policorë. Gjendje e ngjashme u has edhe në SP Shën Nikollë ku MPN-ja konstatoi se makina është e vjetër dhe e shkatërruar, nuk i përmbush as kushtet minimale të mbrojtjes-sigurisë për transportin dhe dërgimin e personave të privuar ose të mbajtur, më saktë në të nuk ka ventilim përkatës, as ngrohje dhe ftohje përkatëse. MPN-ja u informua se për shkak të kushteve të pakënaqshme, duke pasur parasysh aspekti human gjatë trajtimit të personave të privuar nga liria, ata ndonjëherë dërgohen në atë mënyrë që vendosen në pjesën e përparme të furgonit. Makina të vjetra transportuese për bartjen e personave të privuar nga liria kanë në dispozicion SP Dellçevë, SP Kavadarë dhe SP Dibër. Me makina të reja për transport janë pajisur SP Karposh, SP Gazi Babë, SP Qendër dhe SP Radovish. Në këto makina, personat e arrestuar dhe të mbajtur ndahen fizikisht nga nëpunësit policorë, të cilët i shoqërojnë personat gjatë transferimit, me çka shmangen rreziqet e mundshme për trajtim mizor apo çnjerëzor gjatë transportit. MPN-ja konsideron se të gjitha stacionet policore me kompetencë të përgjithshme, të cilat janë caktuar si vende për mbajtjen e personave të privuar, në mënyrë përkatëse duhet të pajisen me makina të reja transportuese të cilat i plotësojnë kushtet e sigurisë-mbrojtjes për transferimin e personave të privuar nga liria.

Realizimi i të drejtave të personave të mbajtur:

Informimi dhe udhëzimi për të drejtat

Në përputhje me Rregulloren për mënyrën e kryerjes së punëve policore dhe në përputhje me Procedurat Standarde Operative për mbajtjen dhe trajtimin e personave të mbajtur, udhëheqësi i turnit (nëpunësi policor për praninë) është përgjegjës për praninë e personit, këshillimin dhe zbatimin e të drejtave të personit, si edhe mbikëqyrjen e vazhdueshme mbi personin derisa i njëjti është i mbajtur, me qëllim të sigurimit të sigurisë së tij në stacionin policor. Në bazë të vizitave të realizuara MPN-ja konstatoi se udhëheqësit e turneve i informojnë personat e privuar nga liria për të drejtat në procedurën policore, ndërsa në një pjesë të tyre u konstatua se janë vendosur edhe informacione për të drejtat në vende të dukshme. Në bazë të kësaj përdoren dy lloje posterësh për të drejtat e personave të privuar nga liria dhe atë – njëri është në tre gjuhë, dhe i dyti është në shtatë gjuhë – në praktikë nuk ka asnjë rregull se cili poster në të cilin stacion policor me kompetencë të përgjithshme të vendoset, por para së gjithash kjo varet nga mënyra në të cilën realizohet shpërndarja e posterëve dhe cilët posterë i ka në dispozicion vet stacioni policor.

MPN-ja bëri kontroll në hapësirat zyrtare të stacioneve policore, me ç'rast konstatoi se udhëzimi për të drejtat ishte vendosur në një vend të dukshëm, i qasshëm për personat e privuar edhe atë në më shumë vende të stacioneve policore. Në pjesën më të madhe, të drejtat e personave të privuar janë vendosur në mënyrë përkatëse në vet hyrjen e stacionit, ndërsa në një numër më të vogël të stacioneve policore të njëjtët janë vendosur në hapësirën e pranimit ose në vetë hapësirën e mbajtjes. SP Dibër nuk ka një hapësirë të posaçme për zhvillimin e bisedës me personat e privuar nga liria, më saktë me personat e privuar nga liria biseda zhvillohet edhe në zyrat zyrtare të inspektorëve policorë, prandaj ky stacion në mënyrë preventive i ka vendosur informacionet për të drejtat e personave të privuar nga liria para hyrjes së hapësirës së mbajtjes.

Në pjesën më të madhe të stacioneve të vizituara policore nuk ishin theksuar të drejtat e personave të privuar nga liria në zyrën e udhëheqësit të turnit apo në

hapësirat e mbajtjes. Me qëllim informimit të plotë të qytetarëve me të drejtat e tyre, nëse të njëjtët janë arrestuar ose mbajtur në stacion policor, ndërkaq duke pasur parasysh se pranimiti i këtyre personave dhe udhëzimi/mësimi i tyre realizohet në zyrën e udhëheqësit të turnit, MPN-ja dha sugjerimin që në mënyrë shtesë të theksohen të drejtat edhe në këto hapësira.

Kodeksi i etikës policore ishte vendosur në vende të cilat janë hapësira të përbashkëta dhe sipas kësaj është në dispozicion për të gjithë nëpunësit me uniformë policore të punësuar në stacionin policor.

E drejta e ushqimit dhe ujit

Realizimi i të drejtës për ushqim dhe ujë paraqesin tregues thelbësor për trajtimin human me personat e privuar nga liria dhe në këtë drejtim Procedurat Standarde Operative, për mbajtjen dhe trajtimin e personave të mbajtur, përcaktojnë se secilit person të mbajtur i takon minimum një vakt, nëse mbajtja zgjat më shumë se 6 orë. Sipas këtyre procedurave, sipas së cilave veprojnë stacionet policore, ushqimi sigurohet nga mjetet personale të personit të mbajtur, nga mjetet e familjes së tij dhe/ose nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Brendshme duke dorëzuar llogarinë fiskale.

Në përputhje me informacionet e marra gjatë vizitave të realizuara, kjo e drejtë realizohet në mënyrë të ndryshme, përkatësisht, në praktikë u konstatua se një pjesë e stacioneve policore me kompetencë të përgjithshme kanë në dispozicion buxhetin e vetë për ushqim, si dhe një pjesë e stacioneve policore me kompetencë të përgjithshme, të cilat nuk kanë në dispozicion mjete për ushqim, këtë të drejtë e lidhin me gjendjen financiare të vet personit që është i privuar nga liria.

MPN-ja konsideron se çdo stacion policor me kompetencë të përgjithshme duhet të ketë buxhet të vetë për ushqim për personat e mbajtur dhe çdo stacion duhet të mbajë shënime të posaçme zyrtare për realizimin e të drejtës për ushqim, si dhe ta dorëzojë llogarinë fiskale me të cilën do të vërtetohet realizimi i së drejtës së vaktit në periudhën e mbajtjes. Si shembull pozitiv duhet të theksohet SP Kratovë, i cili u siguron ushqim personave të mbajtur, ndërkaq llogaria fiskale i dërgohet SPB Kumanovë për refundimin e saj. Njëkohësisht, praktika e këtyre realizohet edhe në SP Dellçevë dhe SP Karposh.

Të drejtën e ushqimit, personat e privuar nga liria, e realizojnë nga mjetet personale në SP Kavadar, SP Dibër⁵, SP Radovish, SP Strugë, SP Qendër, SP Gjevgjeli dhe SP Gazi Babë. Nga ana e nëpunësve policorë në këto stacione policore ishte theksuar se nuk kanë në dispozicion buxhet të posaçëm për ushqim, prandaj dhe parashtrohet pyetja, çka në qoftë se personi i mbajtur nuk ka mjete të veta financiare për ta siguruar të njëjtin ose familja e tij nuk do ose nuk ka mundësi t'i sigurojë ushqim, në ç'mënyrë stacioni policor do t'ia mundësojë të drejtën e vaktit gjatë mbajtjes më gjatë se 6 orë, duke pasur parasysh se me këto të drejta realizohen nevojat themelore të personave dhe paraqesin një qasje humane në pjesën e privimit nga liria.

Në Stacionin Policor Qendër, nga ana e udhëheqësit të turnit, u konfirmua se e drejta e ushqimit realizohet në atë mënyrë që i njëjti sigurohet nëse personi ka mjete financiare me vete. Informacioni u dha edhe nga personi i mbajtur që ishte hasur aty gjatë vizitës së MPN-së në SP Qendër, i cili ka thënë se nuk i ishte mundësuar e drejta e vaktit, si dhe nuk i ishte dhënë ujë kur ai kishte kërkuar.

⁵ Sipas informacioneve të marra për realizimin e kësaj së drejte në SP Dibër nuk ka buxhet të posaçëm, ndërsa ushqimi sigurohet nga mjetet personale të personit të mbajtur, ndërkaq në rastet kur personi i mbajtur nuk ka mjete të veta atij ushqimi i sigurohet nga mjetet personale të nëpunësve policorë.

Në këtë drejtim MPN-ja konsideron se e drejta e ushqimit dhe ujit në mënyrë të detyrueshme duhet të realizohen nga mjetet buxhetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke e pasur parasysh se personat janë të privuar nga liria dhe nuk duhet që këto të drejta të varen nga gjendja financiare e personit derisa i njëjti mbahet në stacionin policor. Në mënyrë shtesë, MPN-ja ka dhënë mendime për ndryshimin e Procedurave Standarde Operative, sipas së cilave ushqimi duhet të sigurohet vetëm nga Buxheti i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe për këtë qëllim duhet të përcaktohet zë i posaçëm buxhetor. MPN-ja rekomandoi, që e drejta e ushqimit dhe ujit të rregullohet me ligj së bashku me të drejtat e tjera të cilat u garantohen personave të privuar nga liria dhe jo të rregullohet vetëm me akt të brendshëm nënligjor, ndërkaq realizimi i së drejtës të evidentohet duke plotësuar shënimin zyrtar.

E drejta e mbrojtësit dhe njoftimi i familjes

Personat e mbajtur në stacionet policore shumë rrallë e realizojnë të drejtën e mbrojtësit. Edhe pse në shumicën e rasteve personat e arrestuar dhe të mbajtur udhëzohen në mënyrë përkatëse, në një numër shumë të vogël të rasteve të njëjtët vendosin për ta shfrytëzuar këtë të drejtë të tyre. MPN-ja konstatoi se në shumicën e stacioneve policore me kompetencë të përgjithshme ekzistojnë lista me emra të mbrojtësve (avokatëve), megjithatë është evidente se edhe në ato raste të rralla kur personi kërkon praninë e avokatit, të njëjtin e angazhon sipas zgjedhjes së vetë. Në SP Kavadar biseda me avokatin zhvillohet në mënyrë private në zyrën e udhëheqësit të turnit, duke pasur parasysh se në këtë stacion policor nuk ka një hapësirë të posaçme për bisedë dhe për marrje me pyetje të personave të mbajtur. Pjesa më e madhe të stacioneve policore ballafaqohen me problemin e sigurimit të avokatit për person të mitur.

Personi i mbajtur udhëzohet për të drejtën e tij, përkatësisht për ta informuar një anëtarë të familjes – MPN-ja konstatoi se për dallim nga e drejta e mbrojtësit, personat e mbajtur më shpesh e përdorin këtë të drejtë të tyre dhe konform kësaj të drejte kërkojnë të njoftohet bashkëshorti ose prindi, ndërkaq tek të miturit ekziston obligim ligjor, në përputhje me Ligjin mbi të drejtën e të miturve, për informim të detyrueshëm të prindërit ose kujdestarit ligjor.

E drejta e mjekut

Udhëheqësi i turnit e ka për detyrë që, gjatë pranimit, në mënyrë përkatëse ta përcaktojë gjendjen shëndetësore të personit të mbajtur dhe të njëjtën ta evidentojë në procesverbalin e mbajtjes. Udhëheqësi i turnit i regjistron lëndimet e dukshme, shenjat e dukshme të sëmundjes, alkoolizimit dhe veprimit të substancave psikotropike dhe në mënyrë përkatëse e përcakton nevojën për ndihmë mjekësore. Në rast të lëndimeve serioze ose nëse personi i mbajtur ankohet në dhimbje ose lëndime, e drejta e marrjes së ndihmës mjekësore është primare dhe ndërmerret para të gjitha veprimeve të tjera.

Edhe pse në pjesën më të madhe të stacioneve policore thirret mjeku, megjithatë nga kontrolli i dokumentacionit të personave të mbajtur u konstataua se në disa stacione policore me kompetencë të përgjithshme e drejta e mjekut realizohet në bazë të vlerësimit të nëpunësit policor. Pra, një person i mbajtur në stacionin policor ka pasur lëndime të dukshme (prerje, të marrë nga një ngjarje), ndërsa nëpunësi policor ka konsideruar se nuk ka nevojë për mjek. Mënyra e këtillë çon në konkluzion se nëpunësi policor, i cili ka bërë pranimin, ka bërë vlerësim të lirë për nevojën e kujdesit mjekësor, dhe në këtë pjesë MPN-ja ka theksuar se gjithmonë kur personi ka lëndime të dukshme duhet t'i jepet ndihmë mjekësore.

Te një pjesë e stacioneve policore u konstatua se në rastet ku është konstatuar një shkallë më të lartë e alkoolizimit të personave të mbajtur nuk ishte thirrur mjeku nga ana e udhëheqësit të turnit prandaj, në këtë drejtim, MPN-ja ka dhënë rekomandim që në mënyrë të detyrueshme të thirret një mjek në raste të këtilla, pa dallim nëse personi kërkon ose jo ndihmë mjekësore, me qëllim të veprimit parandalues në kontekst të mbrojtjes me kohë të shëndetit të personit që është i privuar nga liria.

MPN-ja gjatë vizitave parandaluese ka hasur në shembuj pozitiv, kështu në SP Karposh u konstatua se nëse personi ka lëndime të dukshme i njëjti menjëherë njoftohet për të drejtën e mjekut dhe thirret ndihma e shpejtë. Për gjendjen e konstatuar përgatitet një shënim zyrtar, derisa udhëheqësi i turnit lëndimet e dukshme i evidenton në procesverbalin e mbajtjes. Gjithashtu, edhe në SP Radovish thirret mjeku kur mbahen kategori të personave të rrezikuar, me qëllim që në mënyrë parandaluese të veprohet në drejtim të uljes së rreziqeve nga lëndimeve/vetëlëndimeve. Një pjesë e stacioneve policore me vetiniciativë udhëheqin një procesverbal të posaçëm për të drejtën e mjekut, e që nga ana e MPN-së është përshëndetur si një praktikë pozitive.

Evidenca dhe regjistrat për personat e mbajtur

Gjatë vizitave të stacioneve policore, MPN-ja realizoi kontroll në evidencën dhe regjistrat e personave të mbajtur. U konstatua se në shumicën e stacioneve policore Regjistrat e ngjarjeve të ditës dhe Regjistri i personave për të cilët mbi çfarë do lloj baze u është kufizuar liria e lëvizjes regjistrohen me rregull dhe në mënyrë përkatëse plotësohen të gjitha kolonat e kësaj evidence. Në një pjesë të stacioneve policore u vërejt se nuk udhëhiqet përmbledhja mujore për numrin e personave të thirrur, të arrestuar ose të mbajtur, siç është parashikuar me Procedurat Standarde Operative për mbajtje dhe trajtim të personave të privuar (SP Kratovë, SP Kavadar, SP Dibër dhe SP Gazi Babë). Si një shembull pozitiv duhet të theksohet SP Shën Nikollë që udhëheq një formular të veçantë (Formular nr. 1) për mënyrën e udhëheqjes së përmbledhjes mujore dhe periodike të personave të thirrur, të arrestuar dhe të mbajtur. Në një pjesë të stacioneve policore u konstatua se në Regjistrin e personave të thirrur, të arrestuar dhe të mbajtur nuk është shënuar qartë se për cilën kategori personash bëhet fjalë (nuk është shënuar nëse është person i thirrur, i arrestuar ose i mbajtur), ndërsa në kolona të caktuara të dhënat e shënuara gabimisht fshihen me korrektor (SP Karposh dhe SP Qendër).

Gjatë kontrollit të Regjistrit për përdorimin e mjeteve për detyrim, në një numër më të madh të stacioneve policore, MPN-ja konstatoi se i njëjti plotësohet dhe udhëhiqet në mënyrë të duhur, gjithashtu konstatoi se në shumicën e dosjeve të kontrolluara në mënyrë të rregullt janë plotësuar faqja e dytë dhe e tretë e dosjes, me çka kihet një kontroll i qartë për dokumentacionin, i cili gjendet në përbërje të dosjes. Udhëheqje jo në kohë dhe jo me rregull e Regjistrit për përdorimin e mjeteve të detyrimit u konstatua në SP Dibër, përkatësisht, në të nuk ishin evidentuar rastet nga viti 2009 deri në vitin 2012, ndërsa gjatë kontrollit të dosjeve individuale të personave të mbajtur, MPN-ja ka hasur në dy lëndë të viti 2012 në të cilat ishte përdorur forca dhe mjetet e detyrimit. Njëkohësisht, në regjistrin e njëjtë të SP Dibër nuk ishte shënuar se a ka vlerësim për arsyen e përdorimit të mjeteve të detyrimit, që tregon mosefikasitetin e strukturave udhëheqëse gjatë procedimit sipas lëndëve ku janë përdorur mjete të detyrimi. MPN-ja konstatoi mos-azhurnitet nga ana e strukturave udhëheqëse në veprimin sipas lëndëve për vlerësimin se a ka pasur bazë dhe arsye për përdorimin e mjeteve të detyrimit edhe në SP Qendër.

Shembull pozitiv paraqesin SP Gjorçe Petrov, SP Karposh dhe SP Strugë ku në mënyrë të rregullt dhe efikase udhëhiqet Regjistri për përdorimin e mjeteve të

detyrimin dhe gjatë dhënies së vlerësimit shënohet nëse lëndimet kanë ndodhur nga përdorimi i tyre, si dhe merren parasysh të dhënat dhe materialet shtesë. Regjistri për përdorimin e mjeteve të detyrimit, si edhe Regjistri për parashpresa të qytetarëve kundër nëpunësve policorë udhëhiqen në mënyrë të rregullt dhe efikase edhe në SP Gazi Babë.

Gjatë kontrollit të dosjeve individuale u konstatua se në SP Gazi Babë nuk ka numër të mjaftueshëm të dosjeve të cilat duhet të udhëhiqen për çdo rast individual, në përputhje me procedurat standarde. Në një pjesë të stacioneve policore u konstatua se dosjet e personave të mbajtur udhëhiqen në mënyrë të rregullt, më saktë plotësohet faqja e dytë dhe e tretë e dosjes, dhe të njëjtat në përbërje të tyre i përmbanin të gjitha procesverbalet relevante, shënimet zyrtare dhe dokumentet e tjera. Por, në një pjesë të stacioneve policore u konstatua se disa të dhëna të evidentuara në mënyrë të gabuar në evidencën policore për personat e mbajtur fshihen me korrektor, si dhe në mënyrë të parregullt udhëhiqen dosjet e personave të mbajtur.

Ajo që sidomos u vërejtur në mbajtjen e evidencës është që në të njëjtën, në shumicën e stacioneve policore, nuk mund të përcaktohej rrjedhja logjike e ngjarjeve nga koha e privimit nga liria deri në mbajtjen në stacionin policor. Parregullsitë e tilla u regjistruan në SP Kratovë, SP Shën Nikollë, SP Gjorçe Petrov dhe SP Karposh, ndërsa në SP Strugë dhe SP Gazi Babë, në pjesën më të madhe të dosjeve të kontrolluara, mund të konstatohej se ka një rrjedhje logjike të ngjarjeve nga koha e privimit deri te ndërprerja e mbajtjes në stacionin policor. MPN-ja konstatoi parregullsi në regjistrimet e kohës së privimit nga liria, kohës së mbajtjes dhe kohës së dhënies së udhëzimit personit për të drejtën e mbrojtësit dhe për të drejtat e tjera në stacionin policor, që çon në dyshim në lidhje me përcaktimin e rregullt të kohës së privimit nga liria. Njëkohësisht, në disa stacione policore MPN-ja konstatoi se në një numër të caktuar të regjistrave nuk ishin regjistruar siç duhet koha e përfundimit të privimit nga liria, përkatësisht, koha kur personi ishte lëshuar në liri (SP Dibër, SP Gjorçe Petrov, SP Strugë dhe SP Gjevgjeli), ndërsa në SP Qendër është vërejtur se ekzistojnë parregullsi të caktuara në regjistrimin e kohës së privimit nga liria dhe kohës së mbajtjes së personit.

Në përgjithësi, u konstatua se stacionet policore në mënyrë të rregullt i plotësojnë procesverbalet e mbajtjes, me gabime të caktuara në disa stacione policore me kompetencë të përgjithshme. Pra, në SP Dibër, MPN-ja konstatoi se në disa raste procesverbalet e mbajtjes së personave nuk ishin plotësuar në mënyrë të rregullt dhe tërësisht, sidomos mungonin të dhëna në pjesën e përcaktimit të lëndimeve evidente dhe nevojës për mjek. Në SP Karposh dhe SP Qendër u konstatua se jo kudo ishte plotësuar pjesa për ekzistimin/mosekzistimin e lëndimeve të dukshme te personi i privuar nga liria dhe nevoja për mjek.

Në disa stacione policore në mënyrë të rregullt evidentohet edhe nëpunësi policor që e ka zhvilluar bisedën me personin e privuar nga liria, ndërsa në këtë drejtim si shembull pozitiv mund të jepet evidenca e SP Kratovë, ku në procesverbalin e mbajtjes regjistrohen këto të dhënat dhe udhëhiqet edhe një fletë-kontrolli për mbikëqyrje në të cilën regjistrohet ora kur është realizuar mbikëqyrja mbi personin e mbajtur, duke pasur parasysh se hapësira nuk ka video-mbikëqyrje, ndërsa sistemi për thirrje nuk funksionon. Edhe në SP Kavadar dhe SP Dellçevë përgatitet një fletë e posaçme kontrolli për kontrollin e zbatuar të personit të mbajtur nga ana e nëpunësit policor.

Në drejtim të parandalimit të lëndimeve të mundshme ose vetëlëndimeve, si dhe reduktimit të rreziqeve nga tortura dhe llojet e tjera të trajtimit çnjerëzor nga ana e nëpunësve policorë, u konstatua se disa stacione policore me kompetencë të përgjithshme me vetiniciativë kanë formuar edhe një dokumentacion shtesë, e që mund të theksohet si një shembull pozitiv. Në SP Kratovë udhëhiqet një procesverbal për të drejtën e mjekut dhe një shënim me nënshkrim dhe vulë të mjekut, me çka vërtetohet ngjarja, në SP Kavadar dhe SP Dellçevë përgatitet një shënim zyrtar për dhënien e ndihmës mjekësore, një shënim i posaçëm zyrtar për njoftimin e gjyqtarit hetues, si dhe nën-

shkrimi i gjyqtarit në procesverbalin e mbajtjes gjatë dorëzimit të personit në gjykatë, gjithashtu edhe në SP Kavadar përgatitet një shënim zyrtar për dhënien e ndihmës mjekësore, duke bashkëngjitur edhe një shënim të posaçëm mjekësor me nënshkrimin dhe vulën e mjekut.

E drejta për ushqim dhe ujë, përmes së cilës realizohet një qasje humane për personat e privuar nga liria, vërtetohet me hartimin e një shënimi zyrtar në SP Dellçevë, ndërsa praktika e këtillë pozitive do të duhej të inkorporohej edhe në stacionet e tjera policore, me qëllim të evidentimit të realizimit të këtyre të drejtave me të cilat kënaqen nevojat themelore të personave, gjatë kohës derisa janë të privuar nga liria.

Përgjigje nga stacionet policore dhe Ministria e Punëve të Brendshme të RM-së

Me Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Avokatin e Popullit, në nenin 3 përcaktohet se "personat zyrtarë në organet, organizatat dhe institucionet në të cilat liria e lëvizjes është e kufizuar, janë të obliguar për të vepruar sipas udhëzimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe për veprimin ta njoftojnë jo më vonë se afati prej 30 ditësh, llogaritur nga dita e marrjes së raportit të posaçëm".

Nga përgjigjet e marra të stacioneve policore Avokati i Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional u njoftua se është vepruar sipas rekomandimeve të dhëna të cilat janë në kompetencë të stacioneve, ndërsa ato rekomandime të cilat nuk janë nën kompetencë ridërgohen deri te shërbimet përkatëse⁶. Në një pjesë të përgjigjeve të dërguara, MPN-ja u njoftua se për gjendjet dhe rekomandimet e përmbytura në raportet e posaçme janë mbajtur takime pune në përbërje të disa stacioneve policore, me qëllim të tejkalimit të gjendjeve negative dhe përmirësimit të kushteve ku mbahen personat e privuar nga liria.

Në pjesën e deklaratave për maltretim fizik të personit të mbajtur, MPN-ja ka marrë njoftim nga stacioni policor se Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale e ka shqyrtuar këtë rast, me qëllim përcaktimit të përgjegjësisë së nëpunësve policorë. Në përgjigjet e stacioneve policore ishte vepruar edhe sipas rekomandimit të MPN-it për realizimin e së drejtës së ushqimit dhe ujit, me çka stacionet policore u ngarkuan me një shumë të caktuar të financave nga ana e zyrtarëve – Sektori Punëve të Brendshme.

Në një pjesë të stacioneve policore, ku është konstatuar mosefikasitet në fushën e hartimit të vlerësimit në kuptimin se a ka bazë dhe arsye përdorimi i mjeteve për detyrim, MPN-ja është informuar se sipas sugjerimeve të dhëna do të vepronet me urgjencë⁷. Stacionet policore, me qëllim që të veprojnë në mënyrë parandaluese, ranë dakord që mjeku të thirret edhe në rastet ku personat e mbajtur janë me nivel të lartë të alkoolizimit, pavarësisht nëse të njëjtit kanë kërkuar ose jo ndihmë mjekësore.

Në stacionet ku ka hapësira të reja të mbajtjes, u pranua rekomandimi që personat të futen nga hyrja e pasme e cila është e dedikuar për futjen e personave të privuar nga liria, ekzaminimi mjekësor dhe kontrolli të bëhet në hapësirën e dedikuar për bisedë me palët, ndërsa biseda me personat e privuar nga liria të realizohet vetëm në hapësirat që janë të dedikuara për atë qëllim me video-mbikëqyrje, dhe jo në zyrat e inspektorëve.

⁶ Për rekomandime të caktuara njoftohet udhëheqësi i zyrës për punë kriminalistike me qëllim që të nëpunësuari t'u përbahen rekomandimeve të dhëna nga MPN-ja, ndërsa në një pjesë të caktuar rekomandime të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin dhe adaptimin e hapësirave për mbajtje, në përputhje me standardet e parapara, stacioni/stacionet policor/e ka/kanë dorëzuar njoftim pranë ministrisë kompetente.

⁷ Njoftim i pranuar nga SP Qendër.

Në stacionet policore, ku përdoren hapësira të vjetra të mbajtjes, u pranua rekomandimi që në periudhën e ardhshme të njëjtat të përdoren për afat të shkurtër dhe jo më gjatë se 4 orë dhe kjo derisa të ndërtohen hapësira të reja të mbajtjes.

Duke e pasur parasysh se në SP Strugë nuk ka kushte për mbajtjen e personave, përkatësisht, të njëjtët mbahen në zyrën zyrtare të udhëheqësve, MPN-ja ka dhënë një rekomandim për ri-adaptimin e një hapësire të caktuar, e cila do të përdorej vetëm për mbajtjen e personave, dhe jo edhe për nevoja të tjera. Nga ana e SP Strugë u dërgua përgjigjja se nuk ka mundësi për adaptimin e ndonjë zyre tjetër dhe se mbajtja edhe më tej do të kryhet në zyrën e zyrtarëve⁸. Sipas përgjigjes së marrë, Stacionet Policor me kompetencë të përgjithshme Strugë nuk ka vepruar as sipas rekomandëve të dhëna, në pjesën që kontrolli i personave të privuar nga liria të realizohet në një hapësirë të posaçme, dhe jo në zyrën e zyrtarëve e cila, në të njëjtën kohë, përdoret edhe si zyrë për pranimin e palëve. Për rekomandimin të zbatohet monitorim plotësues mbi personat e privuar nga liria kur të njëjtët i përdorin tualetet zyrtare, por duke e pasur parasysh privatësinë dhe integritetin personal të personave të mbajtur, MPN-ja nuk mori njoftim se si SP Strugë do të veprojë sipas këtij rekomandimi, por vetëm u informua se përdoret tualeti i njëjtë, si për të punësuarit ashtu edhe për personat e mbajtur.

Gjithashtu, u pranuan rekomandimet në pjesën e përmirësimit të udhëheqjes së evidencave, si dhe evidentimit të rrjedhjes logjike të ngjarjeve nga momenti i privimit nga liria, duke pasur parasysh afatin e paraparë ligjor prej 24 orësh.

Nga Ministria e Punëve të Brendshme, MPN-ja u informua se është formuar një grup pune i cili ka hartuar Rregulloren e normativave dhe standardeve të përgjithshme, të cilat duhet t'i përmbushin hapësirat e mbajtjes së personave në stacionet policore me kompetencë të përgjithshme. Rregullorja e njëjtë është në fazë të ndryshimit dhe plotësimit, me ç'rast MPN-ja ka dhënë mendimin e vetë dhe pritet që kjo Rregullore të finalizohet në periudhën e ardhshme. Përveç kësaj, është formuar një grup pune i cili ka hartuar një raport për gjendjet në stacionet policore dhe nevojat për intervenim, me qëllim që të arrihen standardet e përcaktuara, si dhe është miratuar edhe një Plan Veprimi i cili, me kërkesë të MPN-së, iu dërgua në mënyrë shtesë. I njëjti Plan i Veprimit është shumëvjeçar dhe përfshin rinovimin e disa stacioneve policore në bazë vjetore.

Për shkak të mosplotësimit të standardeve në hapësirat e mbajtjes në SP Gjorçe Petrov dhe SP Çair⁹ nga ana e MPB-së, u dërgua njoftimi se të njëjtat nuk përdoren për mbajtjen e personave¹⁰.

Sipas MPB-së edhe më tej mbetet problem sigurimi i avokatit për të miturit, sipas nenit 109 të Ligjit për të drejtën e të miturve. Njëkohësisht, MPB-ja shprehu mospajtim për vendosjen e tabelave me të drejtat e personave të privuar nga liria në hapësirat e mbajtjes dhe kjo për arsye sigurie, edhe pse MPN-ja dha rekomandim që: "Të drejtat e personave të privuar të vendosen në vende të dukshme, në pjesën e vendeve të mbajtjes dhe hapësirat për bisedë me personat e privuar nga liria" e që vetvetiu nuk do të thotë të vendosen tabela ose objekte të rrezikshme, por të drejtat të vendosen, gjë që mund të zbatohet edhe përmes vendosjes së posterëve ose të shtypura në letër në formatin A4¹¹.

⁸ Sipas përgjigjes së pranuar nga MBP-ja, MPN-ja u informua se SPKP Strugë nuk ka hapësira për mbajtjen e personave të cilat i plotësojnë kushtet përkatëse, ndërsa deri në ndërtimin e hapësirave të reja do të përdoren zyrat e zyrtarëve dhe udhëheqësve të turnit, ndërsa në rastet kur bëhet fjalë për më shumë persona ose për të cilët nevojitet trajtim i posaçëm ata dërgohen në SP Ohër.

⁹ Është realizuar një vizitë për ri-kontroll në SP Çair.

¹⁰ Në mënyrë shtesë, MPN-ja është njoftuar nga SPB Shkup se në katër stacione policore është konstatuar se nuk i plotësojnë standardet për mbajtje dhe të njëjtat nuk përdoren (SP Gjorçe Petrov, SP Çair, SP Aerodrom dhe SP Draçevë).

¹¹ Nga ana e SP Kratovë është dërguar përgjigje se të drejtat e personave të mbajtur janë vendosur nga ana e brendshme e dyerve të hapësirave për mbajtjen e personave, ndërsa edhe SP Kavadar dhe SP Dellçevë i kanë vendosur të drejtat e personave të mbajtur në anën e brendshme të hapësirave për mbajtje.

Ministria e Punëve të Brendshme i potencoi si raste të izoluar kontrollet të cilat bëhen në hapësirën e kujdestarisë, si dhe vuri në pah se të njëjtat zbatohen në hapësirë të posaçme, në përputhje me Procedurat Standarde Operative. Me shkresën, MPN-ja u informua se me mbikëqyrjet profesionale të Sektorit të Policisë dhe Punëve Kriminallistike në BSP bëhet mbikëqyrje mbi evidencën e personave të privuar nga liria dhe jepen udhëzime për evitimin e mangësive të konstatuara dhe njëkohësisht Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale bën kontroll edhe mbi veprimin e nëpunësve policorë me personat të cilëve u është kufizuar e drejta e lirisë së lëvizjes, në përputhje me Procedurat Standarde Operative për personat e thirrur, të arrestuar dhe të mbajtur.

Në përgjigjet e dërguara nga Ministria e Punëve të Brendshme u vu në pah se kjo Ministri punon në krijimin e kushteve përkatëse materialo-teknike, në varësi të mundësive financiare, si dhe në përforcimin e resurseve njerëzore në funksion të sigurimit të një shkalle më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave që janë të thirrur, arrestuar ose mbajtur në stacionin policor. Njëkohësisht, për mangësitë e konstatuara, në një pjesë të stacioneve policore, të cilat kanë të bëjnë me funksionalitetin e hapësirave të reja për mbajtje (mirëmbajtjen e rregullt të hapësirave të reja për marrjen në pyetje ku duhet të realizohen bisedat me personat e privuar nga liria, duke pasur parasysh se të njëjtat janë të pajisura në mënyrë përkatëse dhe gjenden nën video-mbikëqyrje, duke vënë në funksionim kamerat të cilat nuk punojnë dhe duke e korrigjuar sistemin e thirrjes) në mënyrë shtesë janë informuar sektorët kompetentë për punë të brendshme, me qëllim që të veprojnë sipas rekomandimeve të dhëna.

B. INSTITUCIONET NDËSHKUESE – KORREKTUESE

Gjatë vitit 2012, Mekanizmi Parandalues Nacional ka realizuar gjithsej nëntë vizita parandaluese në institucionet ndëshkuese-korrektuese (INK) dhe Entin Edukues-Korrektues (EEK), nga të cilat shtatë vizita ishin të rregullta, ndërsa dy ishin vizita për ri-kontroll, me ç'rast u vizituan rregullisht: Enti Ndëshkues-Korrektues (ENK) Strugë, Burgu Strumicë, Burgu Tetovë, Enti Ndëshkues-Korrektues (ENK) Shtip, Burgu Prilep, Burgu Manastir dhe Enti Ndëshkues-Korrektues (ENK) "Idrizovë", ndërsa vizitat për ri-kontroll u realizuan në Burgun Shkup dhe Entin Edukues-Korrektues Tetovë (më shumë për vizitat me qëllim të kontrollit – shih Kapitullin C).

Të gjitha vizitat u realizuan pa paralajmërim, pjesa më e madhe e tyre ishin vizita njëditore, ndërsa vizita në ENK Shtip zgjati dy ditë, ndërkaq vizita e ENK "Idrizovë" u realizua në një periudhë kohore prej tri ditësh. Me kontrollin në institucionet ndëshkuese-korrektuese u përfshinë reparatet e burgimit dhe paraburgimit, si edhe hapësirat ndihmëse, hapësirat për rekreacion dhe objektet komerciale-ekonomike të institucioneve. Gjatë secilës vizitë u realizuan biseda të besueshme dhe individuale me personat e privuar nga liria, si edhe biseda me strukturat udhëheqëse, përfaqësuesit e Sektorit për Risocializimit dhe mbrojtjes shëndetësore, si dhe të punësuarit në Sektorin e Sigurimit. Gjatë secilës vizitë Avokati i Popullit - MPN-ja, sipas zgjedhjes së rastësishme, bëri këqyrje në më shumë kartonë shëndetësorë të personave të dënuar dhe/ose të paraburgosur, dosje profesionale të personave të dënuar dhe evidenca e regjistra të tjerë që udhëhiqen në këto institucione.

Avokati i Popullit – MPN hasi në bashkëpunim të plotë nga ana e udhëheqësve të institucioneve dhe realizoi këqyrje pa pengesë në të gjitha ambientet sipas zgjedhjes personale, si he zhvilloi biseda të besueshme me personat e dënuar, të paraburgosur dhe të mitur në Entin Edukues-Korrektues.

Nga vizitat e realizuara të INK dhe EEK, gjatë vitit 2012, MPN-ja konstatoi se kushtet materiale në institucione nuk i plotësojnë ose i plotësojnë vetëm pjesërisht standardet vendase dhe ndërkombëtare, ndërsa Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, aktet nënligjore dhe protokollat nuk zbatohet tërësisht dhe në përputhje me praktikën. MPN-ja, gjithashtu, konstatoi se Programi vjetor i Qeverisë së RM-së për rikonstrukcionin e INK dhe EEK¹² nuk është realizuar konform planifikimit, më saktë një pjesë të aktiviteteve barten për realizim në vitin 2013.

Për çdo vizitë individuale Avokati i Popullit si MPN hartonte raporte të veçanta, në të cilët i konstatonte gjendjet pozitive dhe negative, si dhe jepte rekomandime përkatëse të cilat ua adresonte Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së INK me qëllim të eliminimit të mangësive të identifikuara.

¹² Programi për financimin e ndërtimit, rikonstrukcionit, mirëmbajtjes së objekteve dhe pajisjeve të institucioneve ndëshkuese-korrektuese dhe edukuese-korrektuese për vitin 2012, i miratuar nga Qeveria e RM-së në mbledhjen e mbajtur më 09.01.2012.

B.1. Kushtet materiale

1. Reparti i pranimit

Gjendja me kushtet materiale në repartet e pranimit të institucioneve ndëshkuese-korrektuese është e ndryshme dhe varet nga madhësia e institucionit dhe kapacitetet hapësimore. Në praktikë, ekzistojnë raste kur reparti i pranimit nuk është i ndarë fizikisht nga repartet e tjerë të të dënuarve, ndërsa në disa INK ky repart paraqet vetëm një hapësirë për vendosje, zakonisht në përbërje të Repartit gjysmë të hapur dhe/ose Repartit të hapur, në pjesën ku të dënuarit e vuajnë burgun. MPN-ja konsideron se zgjidhjet e këtilla në praktikë nuk respektojnë në tërësi detyrimet e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve dhe Rendit të shtëpisë për personat e dënuar të cilët e vuajnë dënimin me burgim në institucionin ndëshkues-korrektues, ku qartë dhe pa mëdyshje ceket se personat e dënuar drejtohen dhe vendosen në repartin e pranimit ku mbeten më së paku 30 ditë. Dispozitat ligjore përcaktojnë detyrimin për krijimin e një reparti të veçantë të pranimit, i cili do të jetë edhe fizikisht i ndarë, më saktë një repart për kontrollin e personit dhe për përcaktimin e trajtimit të personave të dënuar, e që në asnjë rast nuk do të duhej të jetë një repart në përbërje të reparteve të tjera në INK dhe aq më pak i njëjti të jetë në një hapësirë (dhomë).

Burgu Strumicë nuk ka një repart të veçantë të pranimit, e as një dhomë të veçantë të pranimit – personat e dënuar të ri-vendosen ose në Repartin gjysmë të hapur ose në pjesën e izolimit, me çka çrregullohet procesi i pranimit dhe adaptimit.

Në ENK i llojit të hapur Strugë dhe Burgun Manastir **reparti i pranimit (dhoma e pranimit) nuk është i ndarë fizikisht nga reparti i hapur/gjysmë i hapur i institucionit**. Kapacitetet e vendosjes në repartin e pranimit në **ENK të llojit të hapur Strugë** i plotësojnë standardet për vendosjen e personave të privuar nga liria, sa i përket aspektit të madhësisë, ngrohjes dhe dritës ditore. Hapësira, gjatë vizitës, nuk kishte ndriçim artificial elektrik, ndërsa dollapët metalik për ruajtjen e sendeve personale ishin të thyer. Në **burgun Manastir**, në përbërje të repartit gjysmë të hapur, ka dhomë të veçantë pranimi (reparti i pranimit gjysmë i hapur) në të cilën në mënyrë të rregullt ishte theksuar Rendi i shtëpisë për personat e dënuar. Kjo dhomë ka në dispozicion tualet të veçantë, i cili, sipas këqyrjes dhe sipas informacioneve të marra nga punonjësit, nuk përdoret, nga i njëjti ndihej erë e keqe, ndërsa dera e tualetit nuk ishte i mbyllur. MPN-ja konsideron se ky tualet duhet ose të rinovohet ose të përshtatet për përdorim pa pengesë të përditshëm ose të mbyllet, me çka do të pengohej keqpërdorimi i mundshëm i të njëjtit.

Në INK Burgu Tetovë, INK Burgu Prilep, INK Shtip dhe INK "Idrizovë" – Shkup, **reparti i pranimit është i gjerë dhe fizikisht i ndarë nga repartet e tjerë**. Kapacitetet e vendosjes në repartin e pranimit në **burgun Tetovë** nuk i plotësojnë standardet minimale për vendosjen e personave të privuar nga liria në aspekt të madhësisë: hapësirat nuk janë të rinovuara, hapësira për lëvizje të lirë të personave të privuar është jashtëzakonisht e vogël dhe e ngushtë, një pjesë e personave nuk kanë dyshekë për të fjetur, por flenë në sfungjerë të improvizuar. Gjendja me nyjet sanitare është shqetësuese dhe nën çdo standard, sidomos në hapësirën e dytë të repartit të pranimit.

Gjatë vizitës së repartit të pranimit të **ENK Shtip** u konstatua se i njëjti përbëhet nga një dhomë fjetjeje, një dhomë dite, si edhe një tualet të veçantë me dush. Reparti i pranimit ka një dalje të veçantë për shëtitje gjatë ditës e cila shërben si shëtitore e veçantë për këtë repart, e që përdoret edhe për shëtitjen e personave të dënuar të cilët vuajnë dënim me izolim. Në momentin e vizitës MPN-ja konstato mbipopullim të ka-

paciteteve, ndërkohë që numri i personave të dënuar të vendosur ishte mbi kornizën e lejuar ligjore që përcaktohet me Ligjin për ekzekutimin e saksioneve¹³. Në dhomë ishte vendosur një trup ngrohës (radiator), ndërsa në dysheën laminat i ri, gjë që tregon se kjo pjesë e ENK Shtip është e re dhe duhet të mirëmbahet në mënyrë të rregullt, në mënyrë që të mos shkatërrohet. Dhoma për qëndrim ditor është e pajisur në mënyrë përkatëse me mobile dhe aparate (televizor dhe DVD) dhe e njëjta është nën video-mbikëqyrje të vazhdueshme. Tualeti është i ri, higjiena është në nivel të kënaqshëm, ndërsa janë të vendosur dy dushe me çka kënaqen në tërësi nevojat e popullsisë së dënuar të këtij reparti. Në repartin e pranimit nuk ka sistem për thirrje/zile, me të cilin personat e dënuar, në raste urgjente, do ta turrnin shërbimin për sigurim.

Reparti i pranimit në **Burgun Prilep** përbëhet nga dy dhoma të ndara me gjithsej 12 shtretër. Gjatë matjes së njërës dhomë, u konstatua se në qoftë se në dhomë vendosen gjithsej 6 persona (në përputhje me numrin e shtretërve të vendosur), e njëjta nuk do t'i plotësojë standardet minimale të dëshirueshme prej 4m² për person. Gjatë kontrollit u konstatua se dhoma ishte e pa rregulluar, nuk ishte e ngjyrosur, higjiena ishte në nivel të ulët, ndërsa në të njëjtën nuk kishte dollapë të veçantë në të cilët personat do të mund t'i ruanin gjërat e tyre personale. Në pjesën e repartit të pranimit nuk ishin theksuar të drejtat e personave të dënuar, me të cilat do të mund të njiheshin gjatë qëndrimit në këtë repart. Në pjesën e repartit të pranimit gjendet një dush i veçantë në të cilin ka ujë të ngrohtë dhe i cili dy herë gjatë javës përdoret nga personat e repartit të pranimit. Në tualet, i cili ishte i rinovuar, vëreheshin edhe dëmtime të caktuara, njëkohësisht MPN-ja vërejti edhe një prerës të improvizuar (i bërë nga pasqyra e thyer) për të cilin kërkoi të largohet menjëherë.

Në **ENK "Idrizovë"** reparti i pranimit përbëhet nga 6 dhoma për vendosje, ndërsa gjatë kontrollit në tre hapësira, MPN-ja konstatoi se kushtet në to janë të papranueshme, ekziston mbipopullim i madh¹⁴, janë të vendosur shtretër të vjetër dhe të shkatërruar dhe dyshekë e shtroje të parregulluara. Në dhomat e fjetjes në repartin e pranimit janë të instaluar trupa ngrohës (radiatorë) dhe dritare të mëdha me grila, përmes së cilave mjaftueshëm depërton drita e ditës, megjithatë dhomat nuk duken të rregulluara, ndërsa muret ishin të fëlliqura dhe të pa bojatisur. Në to nuk kishte dollapë të veçantë për ruajtjen e gjërave personale të personave të dënuar (gjërat personale të personave të dënuar i ruanin në paketa kartoni dhe valixhe të vendosura nën shtrat). Njytet sanitare dhe duset në repartin e pranimit janë në një gjendje jashtëzakonisht të keqe dhe të amortizuara.

Dritaret në tualetet ishin pa qelq, të njëjtat duhet në mënyrë përkatëse të zëvendësohen me të reja, ndërsa në to ndihej erë e keqe e urinës. Dhoma e ngrënies në repart nuk ishte e pajisur me mobile, me çka personat e dënuar vaktet e tyre i konsumojnë në dhomat e tyre të fjetjes. Në pjesën e repartit të pranimit nuk ishin theksuar të drejtat e personave të dënuar me të cilat ata do të mund të njiheshin gjatë qëndrimit në këtë repart.

2. Reparti i hapur dhe reparti gjysmë i hapur

Në pjesën më të madhe të institucioneve që MPN-ja i ka vizituar, gjatë vitit 2012, reparti i hapur dhe reparti gjysmë i hapur nuk janë fizikisht të ndarë, më saktë vendosja e personave të klasifikuar me trajtim të hapur dhe gjysmë të hapur realizohet në të njëjtat ndërtesa pa ndarje fizike dhe hapësina midis dy reparteve. Vetëm

¹³ Neni 104 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare" nr. 02/2006).

¹⁴ Në një nga hapësirat (me madhësi nga 31.31 m²) ishin të vendosur 15 persona të dënuar, me çka nga njëra anë nuk respektohet maksimumi ligjor për vendosjen e më së shumti 5 personave në një dhomë kolektive, ndërsa nga ana tjetër nuk respektohet standardi minimal prej 4m² për person i përcaktuar dhe i vendosur nga KPT14 si madhësi e dëshiruar për vendosje kolektive

në ENK "Idrizovë" – Shkup dhe INK Burgun Prilep ka ndarje të qartë fizike të këtyre reparteve në të cilët në mënyrë përkatëse vendosen personat e dënuar në përputhje me trajtimin e tyre.

Në **ENK i llojit të hapur Strugë** në repartin e hapur/gjysmë të hapur nuk ekziston mbipopullim, ndërsa dhomat, me disa përjashtime, janë të pajisura në mënyrë përkatëse dhe higjiena është e kënaqshme. Nyjet sanitare dhe dushtet janë në gjendje jashtëzakonisht e keqe dhe ka nevojë nga rinovimi i tyre i menjëhershëm.

Personat, të cilët në përputhje me Rregulloren për shpërndarjen, klasifikimin dhe zhvendosjen e personave të dënuar në INK¹⁵ në institucionin e llojit të hapur klasifikohen në repartin e hapur ose gjysmë të hapur, në **burgun Tetovë** vendosen në hapësirat e njëjta, pa ekzistuar një ndarje e qartë fizike të dy kategorive të personave. MPN-ja konstatoi, se në repartin e hapur/gjysmë të hapur të **burgut Tetovë** ekziston mbipopullim, megjithatë dhomat janë të pajisura në mënyrë përkatëse dhe higjiena është në një nivel të kënaqshëm. Ekziston lagështi e madhe në një pjesë të dhomave të fjetjes. Nyjet sanitare mbahen në nivel pjesërisht të kënaqshëm, megjithatë numri i dusheve nuk e plotëson kapacitetin e institucionit, ka rrjedhje të dobët të ujit, ndërsa vendi i dusheve është i papërshtatshëm.

Në **ENK Shtip** dhe në **Burgun Strumicë** MPN-ja hasi gjendje të ngjashme – dhomat në repartin e hapur/gjysmë të hapur ishin të mbipopulluara - nuk respektohej maksimumi ligjor i vendosjes, së më shumti 5 persona të privuar nga liria në një dhomë kolektive, ndërsa nga ana tjetër nuk respektohej standardi i KPT-ës për minimum 4 m² për person. Në Burgun Strumicë u konstatua se higjiena në dhomat e vendosjes ishte mjaft e ulët, ndërsa pjesa më e madhe e dhomave gjendeshin në gjendje të keqe, me mure të fëlliqura të pa bojatisur, ndërsa në ENK Shtip MPN-ja konstatoi se të gjitha dhomat ishin të pajisura siç duhet (tavolinë, dollapë etj.) dhe çdo person i dënuar kishte shtrat personal me dyshek. Depërtimi i dritës ditore dhe temperatura e dhomës ishin në nivel të kënaqshëm. Në dy INK u konstatua sasi e rritur e lagështisë dhe mykut nëpër mure. Nyjet sanitare, edhe pse pjesërisht të rinovuara, nuk ishin në gjendje të rregullt, përkatësisht ishin me nivel jo të kënaqshëm të higjienës. Në ENK Shtip jo të gjitha dushtet ishin në gjendje të rregullt, ndërsa numri i dusheve ekzistuese nuk i kënaqte kapacitetet e repartit.

Si një shembull pozitiv mund të theksohen INK Burgu Manastir dhe Burgu Prilep. Në **Burgun Manastir** nga kontrolli i repartit gjysmë të hapur, MPN-ja konstatoi se në mënyrë përkatëse respektohen rekomandimet ndërkombëtare dhe standardet vendase. Dhomat janë me nivel të kënaqshëm të higjienës, përveç shtretërve kanë edhe tavolinë, karrige, dollapë metalikë për ruajtjen e gjërave personale, ndërkohë që ishin instaluar edhe trupa ngrohës. Tualeti, në repartin gjysmë të hapur, është i rinovuar tërësisht para disa vitesh, i njëjti ishte në një gjendje përdorimi relativisht të kënaqshëm, ndërkaq higjiena ishte në nivel të kënaqshëm. Megjithatë, në momentin e vizitës së këtij reparti ishin vendosur edhe persona me trajtim të hapur.

Gatë bisedës me disa nga personat, MPN-ja mori informacion se reparti i hapur në Burgun Manastir ka qenë i mbyllur vetëm disa ditë para realizimit të vizitës së paparalajmëruar, dhe për këtë shkak nuk ekziston një dallim i qartë dhe ndarje gjatë vendosjes së personave të dënuar, të klasifikuar me trajtime të ndryshëm¹⁶.

Në **Burgun Prilep** ka një ndarje fizike të repartit gjysmë të hapur nga reparti i hapur. Gjatë kontrollit të dhomave në repartin gjysmë të hapur u vërejt se kushtet janë të mira dhe i plotësojnë standardet ndërkombëtare sa i përket madhësisë. Në të gjitha dhomat janë vendosur nga 5 persona me çka respektohet parashikimi ligjor i përcak-

¹⁵ Nr. 01-4692/1 më 06.12.2011 ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 173/2011).

¹⁶ Në përgjigjen e administratës së burgut, MPN u informua se bëhet fjalë për rreth 10 persona të dënuar të cilët për shkak të gabimeve teknike (nevoja e burgut për të punuar në mënyrë të burgut për shkak të mosekzistimit të kushteve, ndërtesa e veçantë e repartit të hapur të ngrohet gjatë muajve të dimrit) janë të transferuar në repartin gjysmë të hapur.

tuar me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve¹⁷. Në dhoma janë të vendosur shtretër dhe dyshekë të rinj, aty ka dollapë të veçantë për ruajtjen e gjërave personale, si dhe një tavolinë me karrige që mund ta përdorin personat e dënuar. Hapësirat kanë një depërtim të mjaftueshme të dritës ditore, janë të vendosura dritare të mëdha si dhe trupa ngrohës (radiatorë). Në përbërje të repartit gjysmë të hapur gjendet një tualet i veçantë, ndërsa në mënyrë të përshtatshme është theksuar edhe orari i kujdestarisë për mirëmbajtjen e higjienës në repart. Në tualet, edhe pse relativisht i ri dhe i rinovuar, u vërejt sasi e madhe e lagështisë në pjesën e tavanit, ndërsa gjendja higjienike në të njëjtin ishte pjesërisht e kënaqshme.

MPN-ja i thekson dhomat në repartin e hapur të burgut Prilep si një shembull veçanërisht pozitiv – të njëjtat i plotësojnë rekomandimet ndërkombëtare dhe i kënaqin standardet e përcaktuara, në to shtretërit dhe dollapët e gjërave personale të personave të dënuar janë të ri, ndërkohë që vërehej se higjiena ishte në një nivel të kënaqshëm. Personat e dënuar fisnikërojnë hapësirat sipas dëshirave personale. Dhomat janë të bollshme me depërtim të mjaftueshëm të dritës ditore dhe ventilim, ndërsa në të njëjtat ishin vendosur trupa ngrohës. Gjatë kontrollit të tualeteve u konstatua se të njëjtit ishin të pastër, mirëmbahen siç duhet dhe pa dëmtime më të mëdha.

Gjatë vizitës së repartit gjysmë të hapur në **ENK "Idrizovë"-Shkup**, MPN-ja konstatoi se gjatë vendosjes në hapësirat e këtij reparti jo gjithmonë respektohen rregullat ligjore¹⁸ dhe standardet ndërkombëtare, më saktë MPN-ja konstatoi se nuk respektohen standardet e dëshiruara minimale (rekomandimi i KPT-së). Rrjedhimisht me këtë, MPN-ja konstatoi se mënyra në të cilën kryhet vendosja në repartin gjysmë të hapur çon deri te mbipopullimi i kapaciteteve. Konstatim evident, si pasojë e pamohueshme për shkak të kapaciteteve të stërmbohura, ishte edhe niveli i dobët i higjienës dhe shkalla e pakënaqshme e mirëmbajtjes së hapësirave dhe inventarit të repartit. Edhe pse pjesërisht i rinovuar, para disa vitesh, ky repart gjatë vizitës ishte në gjendje mjaft të papëlqyeshme dhe pjesërisht të shkatërruar. Ngrohja në këtë repart realizohet nëpërmjet sobave me dru. Çdo person i dënuar kishte shtrat personal (krevat). MPN-ja me shqetësim e konstatoi edhe gjendjen e keqe në tualet, ku ndihej erë e fortë për shkak se gjatë rinovimit nuk ishin bërë në mënyrë të përshtatshme instalimet e tualetit, si dhe për shkak të shkallës së ulët të mirëmbajtjes së higjienës. MPN-ja, gjithashtu, konstatoi se vetëm një dush ishte në gjendje funksionale në banjë, ndërsa tre të tjerët ishin të papërdorshëm, ndërkaq u vërejt edhe një sasi e madhe e lagështisë dhe mykut në tavan.

MPN-ja e vlerëson vendosjen në repartin e hapur të ENK "Idrizovë" – Shkup si tejet poshtëruese dhe çnjerëzore (me përjashtim të të ashtuquajturit "reparti i gdhendjes"), duke pasur parasysh disa kritere dhe gjendje të caktuara: jo çdo person i dënuar kishte në dispozicion shtratin e vetë, dyshekun dhe/ose shtrojën, hapësirat nuk i plotësonin standardet minimale sa i përket madhësisë, mënyrës së vendosjes, higjienës, ngrohjes etj., ndërkaq ka një stigmatizim dhe ndarje të madhe të disa grupeve të caktuara të cenueshme (p.sh.: përdoruesit e drogës dhe substancave të tjera narkotike). MPN-ja shpreh shqetësim për gjendjet me kushtet materiale në repartin e hapur, me pamundësinë që personat në mënyrë përkatëse t'i realizojnë të drejtat e garantuara me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve dhe aktet e tjera vendase dhe ndërkombëtare, si dhe për shkak të ekzistimit të stigmatizimit dhe ndarjes së grupeve të caktuara të cenueshme nga ana e shumicës së personave të dënuar në këtë repart.

Më alarmuese ishte gjendja në dy hapësirat më të mëdha të vendosjes në përbërje të repartit të hapur të ENK "Idrizovë" – Shkup, në të cilat ishin vendosur 14, përkatësisht, 16 persona të dënuar gjatë vizitës së MPN-së. MPN-ja konstatoi se në këto dy hapësira ka një mbipopullim të madh, dysHEMEJA nëpër dhoma është nga betoni

¹⁷ Neni 104, paragrafi 3 të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve: "Vendosja e personave të dënuar në hapësira të përbashkëta nuk duhet ta tejkalojë numrin prej pesë personave në një dhomë të fjetjes".

¹⁸ supra 17

(nuk ka izolim dhe nuk është e mbuluar/e veshur me materiale të tjera), dhomat për një kohë të gjatë nuk ishin bojatisur, dritaret ishin të thyera ose të mbuluara, me çka vështirësohej depërtimi i dritës ditore dhe ajrimi i rregullt, nuk kishte të instaluar trupa të përshtatshëm ngrohës, ndërsa ekzistonte nivel i lartë i papastërtisë dhe pranisë së insekteve në dhomë, në shtroja dhe në dyshekë, me çka në mënyrë indirekte rrezikohesh shëndeti i personave të dënuar. MPN-ja për gjendjen e konstatuar në këto dy hapësira menjëherë e informoi Drejtorinë për Ekzekutimin e Sanksioneve, me rekomandimin që këto hapësira të mbyllën dhe të rinovohen. Më 03.12.2012, pas realizimit të mbikëqyrjes profesionale-inspektuese të jashtëzakonshme, drejtori i Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve ka dhënë urdhër që të njëjtat të mbyllën menjëherë dhe të përgatitet një plan për rinovimin dhe riparimin e tyre të menjëhershëm.

3. Reparti i mbyllur

Gjatë vizitave të MPN-së, në vitin 2012, u konstatua se kushtet materiale në repartet e mbyllura janë më të keqja në krahasim me vendosjen në repartet e hapura/gjysmë të hapura, me përjashtim të ENK-së "Idrizovë" – Shkup ku gjendet me kushtet materiale në repartet e tjera shkaktojnë shqetësim të njëjtë ose më të madh.

Gjatë kontrollit të repartit të mbyllur në përbërje të **Burgut Prilep** u konstatua se i njëjti përbëhet nga dy dhoma dhe një TV dhomë, me ç'rast u konstatua se muret janë të bojatisura freskët, dhomat ishin të pastra dhe në to kishte të vendosur trupa ngrohës (radiatorë). Hapësirat e njëjta kanë dritare të mëdha me grila, përmes së cilave hyn mjaftueshëm drita e ditës, MPN-ja ka vërejtur se dyshemeja nuk është e mbuluar, përkatësisht se përbëhet vetëm nga një pllakë betoni, pa qenë e mbuluar në mënyrë shtesë me material izolimi, me të cilin do të mbroheshin hapësirat në kushtet e ftohta kohore. Në përbërje të repartit të mbyllur gjendet edhe një shëtitore e vogël të cilën e përdorin personat e vendosur në këtë repart.

Reparti i mbyllur në **Burgun Manastir** përbëhet nga dy hapësira të ndara (dhoma) – reparti i pranimit i mbyllur dhe reparti i mbyllur. Avokati i Popullit – MPN konstatoi se këto hapësira janë nën video-mbikëqyrje të vazhdueshme, me çka ka një kontroll të drejtpërdrejtë mbi të gjitha hapësirat, duke përfshirë shtretërit ku personat flenë. Në repartin e pranimit të mbyllur (hapësirën) temperatura ishte në kornizat e kufirit të dëshiruar, ndërsa lagështia e ajrit ishte ndjeshëm e rritur. Megafoni (sistemi i thirrjes) nuk funksiononte, kështu që personat e kontaktojnë shërbimin e sigurimit në atë mënyrë që japin sinjale para kamerës, e cila është e vendosur në dhomën e fjetjes. Në mënyrë përkatëse ishte theksuar Rendi i shtëpisë, me çka personat e dënuar të vendosur këtu në mënyrë të vazhdueshme dhe të papenguar mund të njihen dhe të informohen me të drejtat e tyre, detyrat dhe favorët. Tualeti, në përbërje të këtij reparti, ishte funksional, kishte një dush të veçantë me ujë të ngrohtë, megjithatë i njëjti shpeshherë përmytjet për shkak të problemeve me kullimin e ujit (për çka edhe ekipi i MPN-së ishte dëshmitar gjatë vizitës), ndërsa për këtë shkak pllakat në dyshemenë e tualetit ishin pjesërisht të shkatërruara ose të larguara.

Gjatë vizitës së repartit të mbyllur (hapësirë) të Burgut Manastir, AP – MPN konstatoi se dhoma e fjetjes ka në dispozicion gjithsej 10 shtretër (të vendosur në kat), megjithatë jo të gjithë ishin në përdorim, më saktë një pjesë e tyre fare nuk kishin dyshekë. Pas kontrollit të kryer MPN-ja konstatoi se në këtë hapësirë, në përputhje me përcaktimet ligjore, nuk duhet të vendosen më shumë se 5 persona, ndërkaq nëse vendosen 5 persona të dënuar në të njëjtën kohë, në atë rast për çdo person do të jetë e nevojshme një hapësirë prej 6 m², me çka sigurohet minimumi prej 4 m² për person, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në këtë hapësirë kishte dollapë metalik për ruajtjen e gjërave personale, personave u ishte mundësuar të ndjekin televizion, ndërsa në mënyrë adekuate ishte theksuar edhe Rendi i shtëpisë për personat

e dënuar. Mobicilet dhe dyshekët në këtë hapësirë, njësoj si edhe në repartin e pranimit të mbyllur, janë të vjetër, ndërsa shtretërit metalik. MPN-ja konstatoi një nivel relativisht të kënaqshëm të higjienës në këtë hapësirë. Në përbërje të këtij reparti ka edhe një tualet të veçantë dhe dush.

Reparti i mbyllur në **ENK Shtip** përbëhet nga një repart përdhes dhe tre krahë, ndërsa kapaciteti i përgjithshëm i vendosjes është 32 dhoma, nga të cilat 24 janë me kapacitet për dy persona, dhe 8 me kapacitet për vendosjen e 4 personave. Pjesa përdhese e repartit të mbyllur përdoret për ndarjen e personave që janë nën rrezik, si edhe për zbatimin e dënimit disiplinor - izolim. Dhomat ishin të pa sistemuara, muret ishin të fëlliqura dhe të çngjyrosur, ndërsa në përbërje të hapësirave ishin vendosur tualetet, të cilët dukeshin tejet të pa rregulluar dhe të dëmtuar. Në repartin përdhes, pjesa më e madhe e dhomave janë me nga dy shtretër, ndërsa gjatë kontrollit të madhësisë u konstatua se të njëjtat janë me madhësi prej 6 m², me çka nuk plotësohen standardet e dëshiruara ndërkombëtare për 4 m² për person të privuar nga liria. Në të njëjtat hapësira temperatura ishte në një nivel të kënaqshëm, ndërsa lagështia e tejkalonte kufirin e lejuar të dëshiruar për lagështi relative në hapësirën e vendosjes. Në dhomat e vendosjes ishte vendosur një sistem thirrjeje, i cili gjatë kontrollit nga ana e MPN-së funksiononte siç duhet.

MPN-ja shprehu shqetësim për kufizimin e lirisë së lëvizjes së personave të vendosur në repartin e vendosur në pjesën përdhese, në përbërje të repartit të mbyllur në ENK Shtip. MPN-ja, në rastet kur nuk bëhet fjalë për persona të cilëve u është shqiptuar dënimi disiplinor - drejtim në qeli të izoluar, konsideron se të njëjtat janë vënë në një pozitë të pabarabartë në krahasim me personat e tjerë të vendosur në tre krahët e tjerë të repartit të mbyllur. Gjendja e këtillë mund të paraqes edhe bazë për diskriminim e tyre për shkak të ekzistimit të trajtimit faktikisht të pabarabartë me çka këta persona ekspozohen ndaj një trajtimi të padrejtë dhe poshtërues, në krahasim me personat e tjerë në një situatë të ngjashme. Dhomat në tre krahët e repartit të mbyllur (krahu 1, krahu 2 dhe krahu 3) janë nën standardet minimale sa i përket madhësisë, ka një depërtim të pamjaftueshme të ajrit dhe është evidente sasia e rritur e lagështisë nëpër mure. Të njëjtat kanë në dispozicion trup ngrohës, dhe çdo person i dënuar ka në dispozicion shtratin e vetë. Higjiena, në pjesën më të madhe të hapësirave, nuk është në nivelin e duhur.

Kushtet në krahun e dytë të repartit të mbyllur në ENK Shtip, MPN-ja i konstatoi si më kritike dhe të papërshtatshme, ku vendosja e personave të dënuar bëhet në hapësira të pa bojatisura me nivel të ulët të higjienës dhe sasi të madhe të lagështisë nëpër mure. Në këtë krah ndihej që dhomat nuk ishin ajrosur, ndërsa për shkak të qarkullimit më të mirë të ajrit në të njëjtat ishin hequr dyert e dhomave. MPN-ja konsideron se lagështia e rritur në dhomat e vendosjes është për shkak të mënyrë së vendosjes së dritareve, më saktë në këto dhoma dritarja është e vogël dhe e mbyllur në mënyrë hermetike pa mundësi për hapjen e saj me qëllim të qarkullimit të ajrit të pastër. Gjatë matjes, në disa nga dhomat u konstatua madhësia prej 6 m² që është nën standardin prej 4 m² për person të vendosur në hapësirën kolektive. Në repartin e mbyllur ka edhe dhoma me nga 4 shtretër për të cilët u konstatua se gjenden në një gjendje më të rregullt, por gjatë matjes së madhësisë u konstatua se këto hapësira ishin me sipërfaqe prej 10,30 m² me çka të njëjtat nuk i plotësojnë standardet e dëshiruara ndërkombëtare prej 4 m² për person në hapësirën kolektive.

Në repartin e mbyllur niveli i mirëmbajtjes dhe higjienës në tualetet dhe dushet është i ndryshëm, në varësi se për të cilin repart bëhet fjalë. Personat e vendosur në tre krahët e repartit të mbyllur, përveç tualeteve të veçantë në përbërje të dhomës së fjetjes, kanë edhe një tualet të përbashkët. Gjatë vizitës së këtyre krahëve, MPN-ja konstatoi se në një pjesë të tualeteve ndihej erë e pakëndshme e urinës, ndërsa në disa banja MPN-ja konstatoi se nuk kishe ujë të ngrohtë për të bërë dush, ndërkaq në një tualet nuk kishte ndriçim artificial.

Në të tre krahët ekzistojnë dhoma të ditës të pajisura me tavolina, karrige, shtrëtrë, të cilët personat e dënuar i përdorin për pushim dhe për ndjekjen e TV, si dhe si palestër për ushtrim (sallë për ushtrim) që është e pajisur me mjete pothuajse të reja dhe funksionale për ushtrim, të cilat i përbushin standardet e mbrojtjes-sigurisë. MPN-ja konsideron se ushtrimet në palestër nuk duhet të zhvillohen pa praninë e personit profesionistë ose personit të dënuar me përvojë përkatëse.

Në repartin e mbyllur Rendi i shtëpisë ishte theksuar në vend përkatës, ndërsa ishte vendosur edhe një kuti për kërkesa për kontroll nga ana e mjekut. Në repartin e mbyllur nuk ka mensë të veçantë për konsumimin e vakteve, ndërsa personat e dënuar ushqimin e konsumojnë ose në dhomat e vendosjes ose në dhomat e qëndrimit ditor.

MPN-ja konstatoi se në përbërje të repartit të mbyllur në **ENK "Idrizovë"** – **Shkup** janë të vendosur sëndukë të vegjël metalikë të Avokatit të Popullit (për parashtrimin e parashtrësive) dhe Drejtorisë (për paraqitje të korrupsionit dhe parashtrësia nga personat e dënuar). Njëkohësisht, u konstatua se as në korridorin kryesor të repartit të mbyllur, as nëpër krahët e caktuar nuk ka të vendosur sëndukë për parashtrimin e kërkesave për kontroll mjekësor, dhe në këtë drejtim nuk respektohen obligimet të cilat dalin nga neni 42 i Rendit të shtëpisë për personat e dënuar të cilët vuajnë dënimin me burg.

Gjatë kontrollit në këtë ndërtesë MPN-ja i vizitoi krahët me nr. 5, 8, 9, si edhe pjesën e re përdhese të repartit të mbyllur. Gjatë kontrollit, në njërin nga hapësirat e krahut 5, MPN-ja konstatoi mbipopullim, më saktë 15 persona ishin vendosur në njërin nga dhomat e fjetjes ku për çdo person sigurohej një sipërfaqe prej 3 m². MPN-ja konsideron se vendosja e këtyllë nuk është në përputhje me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve¹⁹, e as me standardet e dëshiruara minimale ndërkombëtare. Për çdo person të dënuar ishte siguruar një shtrat i veçantë (krevat), ndërsa lagështia dhe temperatura në këtë hapësirë ishin në kornizat e standardeve të dëshiruara. MPN-ja konstatoi se në të gjitha hapësirat e fjetjes ka një depërtim të mjaftueshëm dhe të drejtpërdrejtë të dritës ditore, ndriçimi artificial është në nivel të kënaqshëm, megjithatë në njërin nga dhomat, edhe pse ky repart është i rinovuar para disa vitesh, rrjedh ujë nga tavani. Dyshemeja është e rinovuar dhe është vendosur laminat, shtrëtrërit janë metalikë në të cilët ishin vendosur dyshekë të vjetër, ndërsa në mungesë të dollapëve për ruajtjen e gjërave personale, personat e dënuar në pjesën më të madhe janë të detyruar që gjërat e tyre t'i ruajnë nën shtrëtrë. Institucioni jo gjithmonë e plotëson detyrën nga neni 107, paragrafi 1 të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, dhe pothuajse në të gjitha rastet shtroja është në pronësi të personave të dënuar, ndërsa sipas rrefimit të tyre, për shkak të mungesës së shtrojës së burgut, ata duhet të vetë të ndihmohen me njëri-tjetrin duke e huazuar shtrojen e tyre personale. Në këtë repart nuk ka as dhomë të veçantë ngrënie, ndërsa personat konsumojnë vaktet në dhomat e tyre të fjetjes duke përdorur tavolina dhe karrige më të vogla. Në korridorin kryesor të këtij reparti ka telefon por i njëjti, në momentin e vizitës së MPN-së, nuk ishte në funksion.

Gjatë kontrollit të nyjeve sanitare dhe banjave, MPN-ja konstatoi se, edhe pse tërësisht të rinovuara para disa vitesh, të njëjtat janë tërësisht ose pjesërisht të dëmtuara dhe të papërdorshme. Kështu, nga katër dushe, në funksion është vetëm një, ndërsa në përbërje të tualetit ka 4 nyje sanitare. Asnjë nga dushet ose nyjet sanitare nuk janë të mbuluara (fizikisht të mbuluara), me çka nuk mundësohet privatësia e personave të dënuar gjatë përdorimit të të njëjtave. Të njëjtat nuk mirëmbahen në rregull dhe pastër. MPN-ja sugjeron rekomandimin 19.3 të Rregullave Evropiane të Burgjeve, sipas së cilave të burgosurit duhet të kenë qasje deri te hapësirat sanitare, të cilat nga aspekti i higjienës duhet të jenë të pastra dhe në to të respektohet privatësia.

Gjatë kontrollit të krahut 8, MPN-ja vërejti një dallim të madh sa i përket mënyrës së vendosjes (numrit të personave të vendosur në hapësirat e fjetjes). Në dy hapësirat e këtij reparti ishin vendosur nga dy persona të dënuar, ndërsa gjatë

¹⁹ supra 17

kontrollit MPN-ja konstatoi se në këtë mënyrë atyre u sigurohen nga 5.5 m² sipërfaqe për person, ku u është lënë mjaft hapësirë dhe u është mundësuar fisnikërimi i hapësirave me gjëra të cilat janë në pronësi të tyre (LCD televizorë, frigoriferë, frigoriferë për ngrirje të thellë), ndërsa lagështia dhe temperatura në hapësirën ishin në kornizat e nivelit të dëshiruar. MPN-ja realizoi kontroll edhe në hapësira të tjera në përbërje të këtij reparti dhe konstatoi se në të njëjtat janë vendosur nga 6 persona, më saktë çdo personi mesatarisht i takonin nga 2,90 m² për person, që është nën standardet e dëshiruara të rekomanduara nga KPT. Në këtë mënyrë, MPN-ja konsideron se pjesa më e madhe e personave të dënuar janë vënë në një pozitë të pafavorshme, krahasuar me disa persona të vendosur në këto dy hapësira. Në këtë mënyrë, personave të privuar në këto dy dhoma u mundësohet një hapësirë e mjaftueshme për përdorimin e favoreve të caktuara (p.sh., rregullimi i hapësirës me gjëra personale), e që nuk është mundur në rastin e personave të tjerë, fillimisht për shkak të mosekzistimit të hapësirës së mjaftueshme fizike. MPN-ja konstatoi se në hapësirat e vendosjes kolektive në krahun 8 ekziston mbipopullim, higjiena nuk është në nivel të kënaqshëm, ndërsa dhomat janë të pajisura me shtrëtarë dhe mobile të vjetra dhe të amortizuara, hapësirat nuk ishin të ngjyrosura²⁰, disa prej tyre nuk ishin të ajrosura, ndërsa në pjesën më të madhe personat i ruajnë gjërat e tyre personale nëpër çanta nën krevat. Shtroja dhe jastëkët nuk sigurohen nga ana e burgut, por të njëjtat janë pronësi e tyre personale. Në të gjitha hapësira ishte instaluar nga një trup ngrohës, në pjesën më të madhe të dhomave kishte televizor, ndërsa sipas asaj që e detektoi ekipi i MPN-së, si dhe në bazë të bisedave të zhvilluara me personat e dënuar, nuk ekziston seleksionim gjatë vendosjes në bazë të kombësisë/përkatësisë të personave.

Nga kontrolli i kryer në krahun 9, MPN-ja konstatoi se në këtë repart vendosen persona të dënuar me dënime të gjata me burgim dhe respektohen rregullat vendase sa i përket vendosjes së personave të dënuar, si dhe standardet ndërkombëtare. Kushtet për vendosje në këtë krah, duke e pasur parasysh kategorinë e personave të dënuar që qëndrojnë këtu, janë në nivel më të mirë krahasuar me krahët e tjerë të repartit të mbyllur, megjithatë edhe në nivel pothuajse të barabartë që mundëson marrëdhënie të relaksuara në mes të të dënuarve të këtij reparti. Ky repart është i rinovuar, në korridorin kryesor është vendosur mobile për qëndrim ditor dhe inventar, si edhe dollapë të ri metalikë për gjërat personale të të dënuarve. Edhe në këtë repart, MPN-ja konstatoi se nuk ka seleksionim gjatë vendosjes në bazë të kombësisë/përkatësisë së personave. Lagështia e ajrit dhe temperatura në hapësirat e këtij reparti ishin në kornizat e kufijve të dëshiruar. MPN-ja konstatoi se personat e vendosur këtu, shumica në mënyrë të pavarur e sigurojnë shtrojën, ndërsa si problem u vu në pah presioni i vogël e ujit, e që si rrjedhojë ndonjëherë mungon uji për pije. Higjiena ishte në nivel të kënaqshëm, personave u mundësohet që me sende personale t'i rregullojnë hapësirat në të cilën jetojnë. Në përbërje të dhomave të fjetjes ka një nyje sanitare të veçantë, e cila është tërësisht e ndarë (me ndarje muri) nga pjesa tjetër e hapësirës, ndërsa të drejtën për të bërë dush këta persona, si edhe personat e tjerë të dënuar në repartin e mbyllur, e realizojnë në banjën e përbashkët të vendosur në katin përdhes të ndërtesës.

Në krahun e ri përdhes të repartit të mbyllur, në gjithsej 7 hapësira janë të vendosur persona të cilët për shkaqe të caktuara të sigurisë dhe shkaqe të tjera janë ndarë nga pjesa tjetër e të dënuarve, të cilët janë klasifikuar me trajtim të mbyllur. Vendosja në këto hapësira është kolektive me 2-4 persona në dhomë. AP – MPN konstatoi se në këtë repart ka një mbipopullim të pjesshëm – në hapësirat ku ishin vendosur 4 persona sipërfaqja ishte 13.31m² me çka nuk janë plotësuar standardet e dëshiruara ndërkombëtare për 4m² për person, ndërsa në hapësirat ku ishin vendosur nga dy persona të dënuar sipërfaqja ishte 8,95m² me çka në mënyrë përkatëse janë plotësuar standardet minimale ndërkombëtare për 4m² për person. Temperatura dhe

²⁰ Personat e dënuar në këtë krah të repartit u ankan se ata detyrohen që vetë të mbledhin mjete financiare për të blerë ngjyrë për ta ngjyrosur hapësirën, dhe se jo të gjithë mund të kontribuojnë për atë.

lagështia e ajrit ishin në kornizat e kufijve të pranueshëm. Nga kontrolli i realizuar, MPN-ja konstatoi se këta persona kanë në mënyrë të konsiderueshme një hapësirë më të vogël dhe liri të lëvizjes në përbërje të repartit në të cilin vuajnë dënimin me burg, krahasuar me personat e tjerë të klasifikuar me trajtim të mbyllur. Këtyre personave u është mundësuar t'i fisnikërojnë hapësirat me gjëra që janë në pronësi të tyre personale (televizorë, frigoriferë, shporet), ndërsa shtrojnë që e përdorin, gjithashtu, është në pronësinë e tyre personale. Në këtë repart nuk ka një dhomë të veçantë për qëndrim ditor, ndërsa personat janë të detyruar që pjesën më të madhe të ditës dhe natës ta kalojnë në dhomat e tyre dhe në korridorin e përbashkët, i cili është i ngushtë dhe nuk mundëson kushte përkatëse për qëndrim ditor. Këta persona qëndrojnë në ambient të hapur 2 orë në ditë (kjo e drejtë realizohet në përputhje me ligjin), megjithatë 22 orët e mbetura i kalojnë në një hapësirë shumë të vogël, me çka liria e lëvizjes është e kufizuar në mënyrë të konsiderueshme. Higjiena, në repartin e ri përdhes, ishte në nivelin e duhur, ndërsa çdo dhomë fjetjeje ka një nyje sanitare të veçantë e cila është fizikisht e ndarë nga kapacitetet e vendosjes në hapësirë. Të drejtën për dush (mbajtja e higjienës personale) këta persona, si edhe të dënuarit e tjerë nga reparti i mbyllur, e realizojnë në një banjë të përbashkët të vendosur në katin përdhes të ndërtesës. Në këtë repart nuk ka mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të menjëhershme nga ana e Sektorit të Sigurimit, por mbikëqyrja bëhet përmes zyrës së kujdestarisë që është shumë afër. Sistemi i alarmimit është i shkatërruar dhe nuk funksionon.

MPN-ja realizoi një kontroll në banjën e repartit të mbyllur të ENK "Idrizovë" – Shkup dhe konstatoi se e njëjta në përbërje ka 12 dushe, ndërsa ishte evidente se elementet e dëmtuara (çezma) zëvendësohen në mënyrë të rregullt²¹. Megjithatë, në banjë ekzistojnë edhe dëmtime të caktuara – muret dhe dyshemeja nuk janë të ngjyrosura me ngjyrë të freskët, ndërsa në disa pjesë të caktuara tavanit ishte i dëmtuar në mënyrë të konsiderueshme. Uji për dush ngrohet nëpërmjet ngrohjes qendrore. MPN-ja konsideron se banja duhet të mirëmbahet në mënyrë të rregullt, me çka nuk do të ndodhin dëmtime më të mëdha, të cilat do të kërkojnë intervenime më të mëdha në drejtim të rinovimit dhe/ose rikonstruksionit. MPN-ja konsideron se e drejta e privatësisë respektohet në mënyrë përkatëse në atë mënyrë që njësitë (kabinat) për të bërë dush janë fizikisht të ndara dhe të mbyllura me mur.

4. Reparte të tjera

Në ENK "Idrizovë" është një **repart i veçantë** për gra të dënuara nga i tërë teritori i RM-së, të cilat janë dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm me dënim me burg, i cili ndahet në repartin e mbyllur dhe të hapur, fizikisht të ndarë. Në repartin e mbyllur ka 11 dhoma fjetjeje, megjithatë nuk ka hapësirë të veçantë për qëndrim ditor. Në korridorin e repartit të mbyllur janë vendosur dollapë të lartë për ruajtjen e gjërave personale të personave të dënuar. MPN-ja konstatoi se hapësira që përdoret për vuajtjen e dënimit disiplinor – izolim, është me madhësi konform standardeve vendase dhe ndërkombëtare, megjithatë temperatura është më e ulët nga standardet e pranueshme të dëshirueshme për temperaturë në hapësirën e vendosjes. Në të njëjtën hapësirë nuk kishte trup ngrohës, e as sistem për thirrje, ndërsa në përbërje të hapësirës gjendet edhe një nyje sanitare funksionale. MPN-ja konstatoi se në këtë dhomë ka depërtim të drejtpërdrejtë të dritës ditore, megjithatë nuk ka tavolinë dhe karrige përkatëse për konsumimin e ushqimit.

Në dhomat e fjetjes të repartit të mbyllur janë të vendosura nga 3-5 persona të dënuar, me ç'rast MPN-ja konstatoi se çdo person i dënuar kishte krevat personal,

²¹ Gjatë vizitës që realizoi MPN-ja, duke pasur parasysh se e njëjta nuk ishte paparalajmëruar, mund të vërehet se 5 çezma të vjetra dhe të papërdorshme ose të dëmtuara të banjës ishin zëvendësuar në mënyrë përkatëse me të reja, me çka është mundësuar dushet të përdoren normalisht nga ana e personave të dënuar.

dhomat janë të pajisura me tavolinë, karrige dhe televizor, njëkohësisht të njëjtat ishin të fisnikëruara në mënyrë përkatëse (të dekoruara) nga ana e vetë të dënuarat. Sipërfaqja e hapësirave i plotëson standardet e dëshiruara ndërkombëtare dhe vendase, sa i përket madhësisë së dhomës për vendosje kolektive të personave të privuar nga liria, ndërkaq gjatë vizitës MPN-ja konstatoi se temperatura dhe lagështia e ajrit ishin në kornizat e kufijve të dëshiruar. Gjatë kontrollit të tualeteve të përbashkët, në repartin e mbyllur u vërejt lagështi e madhe, të njëjtat ishin pjesërisht të pastër, por është e nevojshme edhe mirëmbajtja e tyre e rregullt dhe e vazhdueshme, sepse ishin të dukshme dëmtimet në dysheme dhe dushet e banjës.

Krahas reparteve të mbyllur, dhoma për izolim dhe dhoma e pranimit²² në përbërje të pjesës femërore të institucionit ndëshkues-korrektues, ka edhe një repart të hapur i cili përbëhet nga katër dhoma për vendosje, njeje sanitare dhe një kuzhinë të vogël. Gjatë kontrollit u konstatua se hapësirat i plotësojnë standardet e dëshiruara minimale ndërkombëtare për madhësi, ndërsa temperatura dhe lagështia ishin në kornizat e kufijve të dëshiruar. Në dhoma ka depërtim të drejtpërdrejtë të dritës ditore, por muret janë të dëmtuar dhe të pa bojatisur, vërehet lagështia, ndërsa në to janë të vendosur trupa ngrohës (radiatorë). Dushi në repartin e hapur është i improvizuar, i vendosur mbi bazament druri dhe i njëjti nuk është i ndarë fizikisht nga pjesa tjetër e tualetit.

Reparti për persona të moshuar dhe persona të pamundur (reparti geriatrik) në ENK "Idrizovë" – Shkup përbëhet nga gjashtë hapësira për vendosje. Gjatë kontrollit u hasën dhoma me madje 13 dhe 14 shtretër. Gjendja e këtyre dhomave është e këqijë, ndërsa temperatura dhe lagështia janë të larta. Gjatë vizitës MPN-ja konstatoi se, edhe pse tërësisht të rinovuara, para disa vitesh, të njëjtat janë pjesërisht të dëmtuara. Kështu, nga tre dushet funksionon vetëm një, ndërsa tualeti nuk është i ndarë fizikisht nga dushi. As nyjet sanitare ("guaskat e WC") nuk janë të ndara fizikisht me derën, me çka mund të shkelet privatësia e personave të dënuar gjatë përdorimit të të njëjtave. Higjiena në to është në një nivel të kënaqshëm, të njëjtat mirëmbahen në mënyrë të rregullt dhe të pastër.

Higjiena, në dhomat e gjumit në të ashtuquajturin repart geriatrik, ishin në nivel relativisht të mirë, megjithatë jo në të gjitha hapësirat kishte dollapë të veçantë për ruajtjen e gjërave personale të personave të dënuar. Hapësirat ishin të pajisura në mënyrë përkatëse me tavolina, ndërsa në disa prej tyre kishte televizorë. Dritaret ishin të mbështjella me grila dhe të njëjtat sigurojnë depërtim të kënaqshme të dritës natyrore ditore. Në këtë repart nuk ka një dhomë të veçantë për qëndrim ditor, por personave të vendosur në këtë repart nuk u ishte kufizuar qëndrimi në ambient të hapur, përkatësisht në shëtitoren që është në përbërje të këtij reparti. Gjatë kontrollit të nyjeve sanitare dhe banjës, MPN-ja konstatoi se, edhe pse tërësisht të rinovuara, para disa vitesh, të njëjtat janë pjesërisht të dëmtuara. Kështu, nga tre dushet funksionon vetëm një, ndërsa tualeti nuk është i ndarë fizikisht nga dushi. As nyjet sanitare ("guaskat e WC") nuk janë të ndara fizikisht me derën, me çka mund të shkelet privatësia e personave të dënuar gjatë përdorimit të të njëjtave. Higjiena në to është në një nivel të kënaqshëm, të njëjtat mirëmbahen në mënyrë të rregullt dhe të pastër.

Në përbërje të ENK "Idrizovë" – Shkup ka edhe një **repart shkollor (i ashtuquajtur shkollor)**, në të cilin ka tetë hapësira për vendosje, fillimisht për persona të dënuar që nuk e kanë përfunduar arsimin fillor dhe ndjekin arsimin derisa vuajnë dënimin me burg. Nga kontrolli në kapacitetet e vendosjes, MPN-ja konstatoi se, edhe pse ky repart është i rinovuar në tërësi, para tre vitesh, i njëjti është në një gjendje shumë të keqe dhe të rrënuar. Për gjendjen e pafavorshme aktuale në të cilën gjendet ky repart përveç se duhet të merret parasysh mënyra e përdorimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave dhe tualeteve, duhet të kihet parasysh edhe mbipopullimi në këtë repart që në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në kushtet materiale.

Në pjesën më të madhe të hapësirave të "shkollarëve" ka mbipopullim kështu që nuk janë plotësuar standardet themelore minimale për vendosjen e personave të

²² Gjatë matjes së madhësisë së dhomës, MPN-ja konstatoi se e njëjta është me madhësi prej 21.9 m² me çka nuk është plotësuar standardi ndërkombëtar i përcaktuar nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës me të cilin kërkohet 4 m² për person për vendosje kolektive.

privuar nga liria. MPN-ja konstatoi një sasi të madhe të lagështisë, për të cilën konsideron se është rezultat i mënyrës së ndërtimit të objektit, por edhe për shkak të mbi-popullimit të kapaciteteve për vendosje. Në repartin shkollor nuk ka ndonjë hapësirë të veçantë që do të përdorej për qëndrim ditor, ndërkaq personat janë të detyruar që pjesën më të madhe të ditës dhe të natës ta kalojnë nëpër dhomat e tyre dhe korridorin e përbashkët që nuk mundëson kushte përkatëse për qëndrim ditor. Në hapësira janë vendosur trupa ngrohës (radiatorë), megjithatë ngrohja realizohet përmes sobave me drurë. Ventilimi është natyror, ndërsa gjatë vizitës ndihej se ka pa ajrosje të madhe. Në hapësira nuk kishte të instaluar sistem për thirrje (zile alarmi), dhe parashtrohet pyetja se në cilën mënyrë personat e dënuar do të mund në kohë dhe shpejtë ta thirrin ose alarmojnë sektorin e sigurimit, duke pasur parasysh se ky sektor nuk bën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të menjëhershme mbi këtë repart, por mbikëqyrja realizohet nëpërmjet zyrës së kujdestarisë nga reparti i mbyllur.

Nyjet sanitare dhe dushet në repartin shkollor, edhe pse janë tërësisht të rinovuara para disa vitesh, ishin në një gjendje jashtëzakonisht të keqe dhe të rrënuar. Tualeti duket i pa rregullt, i pa mirëmbajtur dhe shumë i dëmtuar. Në nyjet sanitare nuk kishte kazanë, lavamanët ishin tërësisht të shkatërruar, ndërsa nga katër dushet e vendosur vetëm një ishte në funksion.

5. Qelitë dhe izolimi

Nënçmuese dhe çnjerëzore u vlerësuan kushtet dhe vendosja në dhomat e izolimit në shumicën e INK-ve që u vizituan nga ana e Avokatit të Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional në vitin 2012.

Gjatë kontrollit të dhomës së izolimit (qeli) në **ENK të llojit të hapur Strugë**, MPN-ja konstatoi se hapësira është në një gjendje tejet të palakmueshme krahasuar me pjesën tjetër të kapaciteteve të vendosjes. MPN-ja konsideron se kushtet në dhomën e izolimit janë të papërshtatshme, më saktë në të njëjtën ka një prani të madhe të lagështisë, nuk ka trup ngrohës, nuk ka sistem për thirrje/alarm, dhe nyja sanitare është në një gjendje të keqe dhe të papëlqyeshme. MPN-ja shprehu shqetësimin për mënyrën me të cilën realizohet mbikëqyrja e drejtpërdrejtë dhe e menjëhershme mbi personat e vendosur në këtë hapësirë – përkatësisht, përmes një hapje të vogël të derës metalike, personat e punësuar në Sektorin e Sigurimit, kanë një pamje të drejtpërdrejtë të nyjes sanitare në hapësirë, me çka shkatërrohet integriteti personal dhe intimiteti i personit.

Në pjesën e izolimit në **Burgun Strumicë** gjenden tri dhoma në të cilat MPN-ja konstatoi se ekzistojnë kushte jashtëzakonisht johigjienike, me një shtrojë të pa rregulluar dhe të papastër. Në këto hapësira u vërejt një sasi e madhe e lagështisë, ndërsa gjatë kontrollit të temperaturës u konstatua se në njërin hapësirë e njëjta është relativisht e ulët (12°C). Trupat ngrohës nuk funksiononin, ndërsa tualeti ishte funksional vetëm në njërin dhomë. Duhet të merret parasysh se në kushte të tilla personave të vendosur në këto dhoma iu dërgohet ushqimi, më saktë personat i konsumojnë vaktet në dhomat e tyre, e që mund të paraqes rrezik për sëmundje të mundshme ose infeksione.

Personat që vuajnë dënim disiplinor – dërgim në dhomë izolimi në **Burgun Tetovë** vendosen në repartin e pranimit, sepse në këtë burg nuk kanë hapësira të veçanta për vuajtjen e kësaj mase disiplinore²³. Në **Burgun Prilep** katër hapësirat e repartit të paraburgimit përdoren për ekzekutimin e dënimit disiplinor – dërgim në dhomën e izolimit. Gjatë kontrollit të një dhome izolimi, MPN-ja konstatoi se tem-

²³ Për kushtet gjatë vuajtjes së dënimit në dhomën e izolimit në burgun Tetovë shih më parë në pjesën e përshkrimit të kushteve të repartit të pranimit në burgun Tetovë.

peratura dhe lagështia e ajrit ishin në kufijtë e dëshiruara, ndërsa qelia që përdorej për vuajtjen individuale të dënimit është me madhësi prej 4,7 m² me çka nuk i plotëson standardet e dëshiruara minimale për vendosje individuale të një personi të privuar nga liria (hapësirë me minimum 6 m²). MPN-ja konstatoi se qelia është e ngjyrosur siç duhet, mirëmbahet higjiëna, në të njëjtën ka sistem për thirrje që punon, ndërsa personit që ishte në qeli i ishte lejuar të marrë shtrojën nga dhoma e tij.

Në **Burgun Manastir**, ngjashëm si edhe në Burgun Prilep, dy nga hapësirat e repartit të paraburgimit përdoren për vuajtjen e dënimit disiplinor – dërgim në dhomën e izolimit. MPN-ja konstatoi se nuk respektohen standardet minimale ndërkombëtare dhe rekomandimet në lidhje me sipërfaqen e hapësirës për vendosje individuale prej më së paku 6 m² për person. Personat nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë deri te ndriçimi natyror ditor, ekziston lagështia në rritje, në vend të dyshekut ka një sfungjer të improvizuar, ndërsa në këto hapësira nuk ka të instaluar trupa ngrohës. Tualalet nuk është fizikisht i ndarë në tërësi nga kapaciteti i vendosjes, ndërsa sistemi i thirrjes (zile alarmi) është i dëmtuar. MPN-ja konstatoi sende (rreziqe) të caktuara të cilat mund të keqpërdoren ose të çojnë deri te një trajtim çnjerëzor ose degradues²⁴. Duke vepruar në mënyrë preventive, MPN-ja kërkoi nga Drejtoria e burgut t'i largojë sendet nga dhomat e izolimit që paraqesin rrezik dhe të cilat lehtë mund të keqpërdoren në drejtim të trajtimit çnjerëzor dhe degradues. Nëse ka nevojë për çmobilizim fizik të personit të caktuar, i njëjti duhet të realizohet me përdorimin e rregullt të mjeteve të lejuara për detyrim, në përputhje me protokollet e vendosura dhe rregullat dhe kjo të bëhet nga ana e personit të trajnuar.

Në përbërje të repartit të mbyllur të **ENK "Idrizovë"** gjenden edhe 12 hapësira të cilat përdoren për vuajtjen e dënimit disiplinor – dërgim në dhomën e izolimit. Të gjitha hapësirat janë për vendosje individuale (me një krevat), ndërsa në përbërje të secilës hapësirë ka edhe një njeje sanitare të veçantë dhe çezmë për ujë. Nga kontrolli në dhomat e izolimit, MPN-ja konstatoi se të njëjtat i plotësojnë standardet në lidhje me madhësinë (sipërfaqja e hapësirës), megjithatë ishte i dukshëm niveli i ulët i mirëmbajtjes së tyre, mos-ajrosja dhe higjiëna e pakënaqshme. Në një nga dhomat e izolimit, në të cilën ishte vendosur një person i dënuar për vuajtje të dënimit disiplinor, nyja sanitare nuk ishte në funksion, në të ndihej erë e pakëndshme e urinës dhe u vërejt prania e insekteve. Dyshekët, në dhomat e izolimit ishin të vjetër dhe me tri pjesë, ndërsa shtroja nuk ishte në rregull. Në hapësirat nuk ka depërtim të drejtpërdrejtë të dritës ditore, ndërkaq ndriçimi artificial vinte nga pjesa e jashtme nëpërmjet hapjes me grila metalike të vendosura drejt korridorit të brendshëm.

MPN-ja konstatoi se në qelitë e ENK "Idrizovë" nuk ka të instaluar ndonjë trup ngrohës përkatës, më saktë këta trupa janë të radhitur në korridorin kryesor të këtij reparti. Temperatura në dhomat e izolimit ishte nën standardin e dëshiruara, ndërsa lagështia e ajrit ishte në kornizat e standardeve të pranueshme. Në hapësirat nuk ka të instaluar sistem për thirrje (zile elektronike ose megafon) me çka parashtrohet pyetja për mënyrën e komunikimit dhe alarmimit të shërbimit të sigurimit në raste urgjente (nevoja nga intervenimi mjekësor etj.).

Përveç kësaj, në disa nga hapësirat është instaluar edhe një video-kamerë dhe të njëjtët janë nën video-mbikëqyrje të vazhdueshme (në kohën kur në to ka të vendosur person të dënuar). MPN-ja shprehu shqetësim për mënyrën e realizimit të video-mbikëqyrjes në këto hapësira, duke pasur parasysh se të njëjtat, përveç se përdoren për persona që janë të ndarë përkohësisht dhe afat të shkurtër për shkak të nevojës për mbikëqyrje të përforcuar (rrezik nga vetëlëndimi ose ngjashëm), në to vendosen edhe personat që vuajnë dënim – dhomë izolimi. Njëkohësisht, ENK "Idrizovë" nuk ka

²⁴ Në një nga dhomat e izolimit MPN-ja gjeti një zinxhir të vogël metalik me dry mbi krevatin, i cili sipas shpjegimit të shërbimit të sigurimit kishte mbetur aty që nga koha kur në hapësirë kishte dy krevate njëri mbi tjetrin, ndërsa zinxhiri dhe dryni përdoreshin për përforcimin e krevatit të sipërm për murin. Rreziku tjetër që e konstatoi MPN-ja ishte shtroja ose një pjesë e rrobave, të lidhura në njeje dhe e varur në grilat metalike të dritares mbi derë.

miratuar dhe përcaktuar një akt të veçantë nënligjor me të cilin rregullohet mënyra e kryerjes së video-mbikëqyrjes, që është në kundërshtim me detyrat që dalin nga Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.

6. Repartet e paraburgimit

Gjatë vitit 2012, MPN-ja realizoi vizitë edhe në disa reparte të paraburgimit në përbërje të institucioneve ndëshkuese-korrektuese gjysmë të hapura dhe atë: burgu Tetovë, burgu Prilep dhe burgu Manastir. Nga vizitat, Avokati i Popullit – MPN konstatoi se standardet ndërkombëtare dhe vendase në pjesën e kushteve materiale nuk respektohen dhe realizohen tërësisht në praktikë dhe identifikoi një numër të madh të mangësive dhe parregullsisve.

Në repartin e paraburgimit në **Burgun Tetovë** dhe **Burgun Prilep**, MPN-ja konstatoi ekzistimin e mbipopullimit, më saktë se në të gjitha dhomat nuk respektoheshin standardet minimale ndërkombëtare dhe rekomandimet në lidhje me sipërfaqen prej 4 m² për person. Personat nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë deri te ndriçimi natyror ditor, ndërsa tualeti nuk është fizikisht i ndarë në tërësi nga kapaciteti i vendosjes së hapësirës së paraburgimit. Në Burgun Tetovë ekziston lagështi në rritje dhe në të gjitha hapësirat nuk ka të instaluar sisteme për thirrje (zile alarmi), ndërsa në Burgun Prilep muret e ambienteve nuk ishin të ngjyrosura, megjithatë në mënyrë përkatëse ishin të vendosur trupa ngrohës dhe në mënyrë të rregullt ishte theksuar Rendi i shtëpisë.

Gjatë vizitës së Repartit për vuajtjen e masës së paraburgimit në **Burgun Manastir**, MPN-ja përsëri konstatoi se hapësirat e paraburgimit nuk i plotësojnë standardet minimale, sa i përket madhësisë, ndriçimit ditor, ngrohjes dhe ventilimit. Edhe pse këto hapësira i plotësojnë standardet vendase për 9m² (të përcaktuara me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve), në shumicën e hapësirave të këtij reparti sigurohen midis 2m² dhe 3m² hapësirë për çdo person të paraburgosur e që është nën standardet e dëshiruara minimale ndërkombëtare. Në kornizat e kësaj madhësie hyn edhe nyja sanitare (e pajisur me "guaskë banjoje" dhe çezmë për ujë me lavaman), që është në përbërje të hapësirës për vuajtjen e masës së paraburgimit. Higjiena në repartet e paraburgimit nuk ishte në nivel të kënaqshëm – MPN-ja konsideron se ky është rezultat i mbipopullimit të hapësirave të vogla dhe faktit se pjesën më të madhe të kohës (rreth 22 orë) personat e paraburgosur e kalojnë në dhomat e tyre, ndërkohë që në të njëjtat i konsumojnë edhe vaktet.

MPN-ja konstatoi se në hapësirat për vuajtjen e masës së paraburgimit, në përbërje të Burgut Manastir, nuk ka të instaluar trupa ngrohës, më saktë këta trupa janë të radhitur në korridorin kryesor të repartit të paraburgimit. Temperatura në hapësira ishte në kornizat e temperaturës së dëshiruar mesatare, ndërsa indeksi i lagështisë së ajrit ishte pothuajse i lartë²⁵. Çdo person i paraburgosur kishte krevat të vetë, megjithatë MPN edhe këtu konstatoi se një pjesë e dyshekëve ishin të vjetër dhe të grisur, ndërsa disa prej tyre në vend të dyshekëve kishin sfungjerë të vjetër të improvizuar.

MPN-ja përshëndet vendosjen e dollapëve prej druri në korridorin kryesor në repartin e paraburgimit të Burgut Manastir para hyrjes në çdo hapësirë dhe konsideron se ruajtja e gjërave personale (mjete për mbajtjen e higjienës personale, ilaçeve dhe këpucëve) jashtë hapësirave të veta të vendosjes, rrit mbrojtjen e personave të vendosur në repartin e paraburgimit dhe vepron në mënyrë parandaluese në drejtim të reduktimit të vetëlëndimeve të mundshme. Në korridor, në mënyrë përkatëse ishte theksuar edhe Rregullorja e rendit të shtëpisë për vuajtjen e masës së paraburgimit, me çka MPN-ja konstatoi se e njëjta është vënë në dispozicion të personave të

²⁵ Gjatë kohës së vizitës lagështia ishte rreth 60%, e që është në kufirin maksimal të standardit të dëshiruar prej 30-60%.

paraburgosur, megjithatë nuk e kanë në dispozicion në mënyrë të vazhdueshme dhe të papenguar. U konstatua se dushet punojnë, ndërsa personave të paraburgosur u mundësohet një dush një herë në javë (çdo të shtunë).

7. Hapësira të tjera

Gjatë vizitave të institucioneve ndëshkuese-korrektuese, MPN-ja u përkushtoi vëmendje të veçantë kushteve në dhomat e ambulancës, kuzhinave dhe dhomave të ngrënies, hapësirat e vizitës-vendet për vizitë, hapësirat për kontrollit, vendin për shëtitje të jashtme, si dhe hapësirat e tjera në të cilat qëndrojnë dhe nëpër të cilat lëvizin personat e privuar nga liria.

Hapësira për kontrollin e personit

MPN-ja konstatoi se në shumicën e institucioneve nuk ekzistojnë hapësira të veçanta (ose vende të ndara) të dedikuara ekskluzivisht për kontroll dhe marrje në pyetje të personit të dënuar ose të paraburgosur, ndërsa shpesh kontrolli bëhet në hapësira të improvizuara. Kështu, në Burgun Prilep kontrolli personal i personave të privuar nga liria realizohet në dhomën e vizitës dhe për bisedë me avokat. Kjo hapësirë nuk është e pajisur siç duhet, njëkohësisht në të ruhet edhe pajisja e shërbimit të sigurimit. MPN-ja në rastin konkret konstatoi se hapësira nuk i plotëson parakushtet themelore dhe se është e nevojshme të ketë një hapësirë të veçantë për kontroll, një hapësirë të veçantë për ruajtjen e pajisjes së shërbimit të sigurimit, ndërsa hapësira për vizitë të jetë e pajisur siç duhet me mobile shtesë.

Në disa INK kontrolli i personave realizohet në korridoret dhe zyrat e kujdestarisë, të vendosura në hyrjen e institucioneve. Në këtë mënyrë, shpeshherë personat, mbi të cilët realizohet kontrolli personal, janë të ekspozuar në shikimet e drejtpërdrejta të të punësuarve dhe personave të tjerë të privuar nga liria. Prandaj, në situata të caktuara, është e mundur të vijë edhe deri te cenimi i dinjitetit të personit të privuar nga liria, më saktë deri te trajtimi degradues i kësaj kategorie të personave.

Ambulanca / Hapësira për kontroll mjekësor

Kushtet materiale për kryerjen e kontrolleve mjekësore dhe intervenimeve ambulatorë janë të ndryshme dhe varen nga madhësia dhe kapaciteti i institucionit. Rrjedhimisht, ENK Shtip dhe ENK "Idrizovë" kanë reparte të veçanta ambulatorë, ordianca stomatologjike, ndërsa në rastin e ENK "Idrizovë" edhe një stacionar të veçantë. Në Burgun Manastir dhe Burgun Prilep ka dhoma të veçanta ambulatorë, ndërsa në ENK Strugë ka një hapësirë për kontroll mjekësor. Në Burgun Tetovë, hapësira për kontroll mjekësor është me më shumë dedikime dhe përdoret edhe për kontroll të personit edhe për bisedë me avokatët.

Vetëm në **Burgun Strumicë** nuk ka një hapësirë të veçantë për kryerjen e kontrolleve mjekësore dhe intervenimeve dhe e njëjta bëhet në zyrën e kujdestarisë. MPN-ja konstatoi se hapësira nuk është e përshtatshme për kryerjen e kontrolleve mjekësore, sepse ka dritare të mëdha prej qelqi, përmes së cilave personi që kontrollohet mund të ekspozohet ndaj shikimeve të drejtpërdrejta dhe në këtë mënyrë rrezikohet dinjiteti dhe integriteti personal i personave të dënuar. Në hapësirën e njëjtë ruhen edhe kartonët shëndetësorë, si dhe medikamentet e përshkruara të personave të dënuar, me çka nuk respektohet parimi i besueshmërisë midis pacientit dhe doktorit. Qasje deri te dosjet mjekësore duhet t'i ketë vetëm mjeku ose një person tjetër i shëndetësisë që është i angazhuar në burg, me qëllim për të krijuar një marrëdhënie

mirëbesimi midis mjekut dhe pacientit dhe në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të pacientit.

MPN-ja konstatoi se hapësira e kontrollit mjekësor në **ENK Strugë** është e pajisur në mënyrë përkatëse, megjithatë nuk ka në dispozicion mjete shtesë mjekësore dhe mjete ndihmëse teknike. Medikamentet ruhen në një barnatore të veçantë në zyrën e infermieres, ku ruhen edhe kartonët mjekësor të personave të dënuar, me çka sigurohet besueshmëria e të dhënave që përmbajnë të njëjtat, e që është në përputhje me standardet dhe praktikën ndërkombëtare^{26 27}. Është e ngjashme gjendja edhe me dhomën e kontrollit në Burgun Tetovë, me atë dallim që e njëjta nuk është e pajisur siç duhet me krevat ambulator (krevat për kontrolle).

Në **Burgun Prilep**, ekipi i MPN-së nga kontrolli në ambulancën e burgut konstatoi se hapësira është e pastër, e thatë dhe e mirëmbajtur mirë. Ambulanca është e vogël, me instrumentet themelore, megjithatë, nuk ka dollapë përkatës (ose kasa-fortë) për ruajtjen e kartonëve mjekësorë. Në këtë mënyrë, vihet në pikëpyetje besueshmëria e të dhënave që i përmbajnë të njëjtat, si dhe rrethi i personave, të cilëve u mundësohet qasje deri te kartonët. Ambulanca është e furnizuar me aparat për matjen e tensionit, aparat për matjen e sheqerit, stetoskop, ndërsa qasje deri te medikamentet ka vetëm mjeku dhe të njëjtat ruhen në një dollap të veçantë.

Mbrojtja shëndetësore në **Burgun Manastir** realizohet në dy hapësira: dhoma ambulatorie dhe hapësira e infermieres. Në këtë burg, në pjesën më të madhe, janë plotësuar standardet e nevojshme minimale, kështu që dhoma e kontrollit ambulator është e pajisur në nivel të kënaqshëm, në të është vendosur një krevat spitalor dhe mjete ndihmëse shtesë mjekësore, si dhe instrumente për kontrollin e personave të dënuar dhe të paraburgosur. E njëjta është e regjistruar dhe ka leje për të punojë si ambulancë. Në hapësirën e infermieres ruhen kartonët shëndetësor, me çelës në një dollap të veçantë metalik, për shkak të sigurimit të mbrojtjes të fshehtësisë së të dhënave. Në hapësirën e infermieres gjenden edhe medikamentet, të cilat ruhen me çelës në farmaci, duke siguruar një mbrojtje më të madhe nga keqpërdorimi i mundshëm.

Në përbërje të ambulancës në **ENK Shtip** ka dy dhoma spitalore dhe një dhomë për intervenim, si edhe ambulancë stomatologjike. Dhoma e kontrollit në ENK Shtip është e pajisur në mënyrë bashkëkohore, në të njëjtën është i vendosur një krevat spitalor, EKG aparat, si dhe mjete ndihmëse shtesë mjekësore dhe instrumente për kontrollin e personave të dënuar. Në ambulancat ruhen kartonët shëndetësorë, por gjatë vizitës së ekipit të MPN-së të njëjtët ishin lënë jashtë dollapit përkatës – MPN-ja rekomandoi që të njëjtët në mënyrë të vazhdueshme të ruhen nën çelës për shkak të sigurimit të një mbrojtje më të madhe të fshehtësisë së të dhënave. Nga ana tjetër, MPN-ja konstatoi se medikamentet ruhen në një dollap të veçantë me çka sigurohet një mbrojtje më e madhe nga keqpërdorimi i mundshëm. Në ambulancë ka një aparat për matjen e tensionit, ndërsa në ambulancën stomatologjike është e vendosur një pajisje bashkëkohore për mjekimin dhe rregullimin e dhëmbëve.

MPN-ja realizoi vizitë në repartin e ambulancës në **ENK "Idrizovë"**, i cili është i vendosur në rrethin e repartit të mbyllur. Kartonët shëndetësorë ruhen në mënyrë të besueshme në kartotekën metalike në ordinancën e udhëheqësit të sektorit për mbrojtje shëndetësore, ndërsa deri te të njëjtët qasje ka vetëm shërbimi mjekësor. Në pjesën e ambulancës gjendet një dhomë për terapi, në të cilën ruhen medikamentet, si dhe një ordinancë stomatologjike tërësisht e pajisur për kryerjen e shërbimeve stomatologjike. Ambulanca në mënyrë përkatëse disponon me licencë për punë. Në përbërje të repartit të ambulancës gjendet edhe një ordinancë për terapi të metadonit. Qendra e metadonit funksionon me një ekip të plotë profesional që është përgjegjës për

²⁶ Recommendation No R (98) 7 concerning the ethical and organizational aspects of health care in prison – Council of Europe – Committee of ministers adopted on 8 April 1998, at the 627 meeting of the Deputies.

²⁷ Pika 42.3 e Rregullave Evropiane të Burgjeve, të miratuara nga ana e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës më 11.01.2006

shpërndarjen e terapisë për 128 përdorues të terapisë së metadonit.

Gjatë vizitës së **stacionarit të ENK "Idrizovë"**, MPN-ja hasi një gjendje të kushteve të këqija higjienike dhe dhomave të shkatërruara, në të cilat janë vendosur persona përdorues të terapisë së metadonit. Stacionari është një ndërtesë e vjetër që është pjesërisht e shkatërruar, në pjesën e jashtme është evident rrënimi i mureve nga lagështia, ndërsa dritaret janë të vjetruara. Në ditën e vizitës në stacionar ishin të vendosur 130 persona të shpërndarë në 30 dhoma, ndërkaq u has edhe një person i cili ishte i vendosur në korridor. Në dhoma kishte lagështi, ndërsa personat e dënuar thanë se gjatë dimrit nuk ka ngrohje. Pjesa më e madhe e dhomave nuk ishin ngjyrosur dhe ishin të fëlliqura, në të njëjtat ishin vendosur dollapë të vjetër për ruajtjen e gjërave personale, ndërsa dritaret ishin të vogla dhe nuk sigurohej depërtim i mjaftueshëm i dritës ditore. Në dhoma gjendeshin edhe tualetet e rrethuar të cilët ishin në gjendje të keqe, të fëlliqur dhe të pa mirëmbajtur, higjiena e dusheve ishte në nivel të ulët, ndihej erë e pakëndshme e urinës dhe te të njëjtit vërehej dëmtim i konsiderueshëm i pllakave dhe lavamanëve, që i përdorin personat e dënuar.

MPN-ja konsideron se vendosja në kushte të tilla, siç janë ato në stacionarin e ENK "Idrizovë" – Shkup, është në kundërshtim me kërkesat e Rregullave Evropiane të Burgjeve në të cilat theksohet se: *"për kushtet e vendosjes së të burgosurve, veçanërisht të hapësirave për fjetje, duhet të kihet parasysh dinjiteti i njeriut dhe sa më shumë të jetë e mundur të respektohet privatësia dhe të plotësohet kërkesa për ruajtjen e shëndetit dhe higjienës, duke pasur parasysh kushtet klimatike dhe sidomos sipërfaqen e dyshemesë, sasinë e ajrit, ndriçimin, ngrohjen dhe ventilimin"*.

Edhe pse stacionari është i paraparë për shtrirje në spital (hospitalizim) të pacientëve, MPN-ja konstatoi se pjesa më e madhe e personave ishin të dënuar të cilët janë përdorues të terapisë së metadonit. Respektivisht, personat që janë të vendosur atje nuk janë persona të sëmurë, për të cilët është i nevojshëm një kujdes shtesë mjekësor, por përkundrazi, të njëjtët janë të ndarë dhe të vendosur në një ndërtesë të veçantë vetëm për shkak të gjendjes së tyre – përdorues të mjeteve narkotike.

Kuzhina dhe trapezaria

Në institucionet ndëshkuese-korrektuese është konstatuar një nivel i kënaqshëm i higjienës në pjesën më të madhe të kuzhinave, ku në mënyrë adekuate ishte theksuar lista e ushqimeve e miratuar nga mjeku dhe nga drejtori i burgut. Megjithatë, gjatë vizitës në Burgun Prilep, Burgun Strumicë dhe ENK Strugë mungonte një listë e përditësuar e vakteve, ndërsa dhe në Burgun Strumicë nuk kishte nënshkrim nga drejtori, i cili është i detyruar për ta miratuar. Në pjesën e institucioneve libri për kontroll të ushqimit nuk plotësohet në mënyrë të rregullt ose në mënyrë efikase, e që çon në përfundimin se kontrolli i vakteve nuk bëhet çdo ditë (ENK Shtip, Burgu Strumicë etj.).

Në pjesën më të madhe të ENK-ve, karriget në dhomat e ngrënies nuk janë të fiksuara për dysheme ose tavolinë, që paraqet një rrezik të mundshëm për sigurinë e personave të dënuar dhe të punësuar. Gjatë kontrollit, MPN-ja konstatoi se në dhomat e ngrënies zakonisht nuk ka karrige të mjaftueshme për çdo person të dënuar, prandaj dhe dreka dhe darka konsumohen në ndërrime.

Si një shembull pozitiv mund të potencohet kuzhina dhe trapezaria në ENK Shtip. Kjo kuzhinë është e pajisur në mënyrë bashkëkohore (në përputhje me standardet HACCP) me enët e nevojshme të kuzhinës dhe frigorifer për ruajtjen e ushqimit. Gjatë vizitës u konstatua se e njëjta është e pastër dhe në të është theksuar një meni dyjavore e vakteve. Trapezaria ka 88 vende për ulje, karriget janë të fiksuara për tavolina, ndërsa në të njëjtën është vendosur edhe video-mbikëqyrje. Përveç kësaj edhe trapezaria në Burgun Strumicë ka në dispozicion karrige të fiksuara për tavolinat.

Veçanërisht shqetësuese është situata me konsumimin e vakteve në repartet e paraburgimit të ENK-ve të cilët u vizituan në vitin 2012, si dhe me shpërndarjen dhe konsumimin e vakteve në ENK "Idrizovë". MPN-ja e konsideron si degraduese mënyrën e shpërndarjes dhe konsumimit të ushqimit nga ana e personave të paraburgosur – të njëjtit nuk kanë në dispozicion një trapezari të veçantë, por të gjitha vaktet e tyre i konsumojnë në hapësirat e vogla të paraburgimit, duke përdorur një tavolinë të vogël metalike. Gjatë vizitës së ENK "Idrizovë", MPN-ja konstatoi se në pjesën më të madhe të reparteve nuk ka trapezari të veçantë, ndërsa shumica e popullsisë së dënuar i konsumon vaktet në dhomat në të cilat qëndrojnë ose në korridoret e improvizuar. Personat e dënuar nuk marrin takëm për haje nga burgu, por përdorin takëme të vetë ose e konsumojnë ushqimin në një mënyrë tjetër. Në këtë drejtim, MPN-ja kërkoi nga Drejtoria e Entit që në mënyrë urgjente të ndërmerren masa në drejtim të përmirësimit të kushteve të vendosjes në ENK "Idrizovë" përmes përmirësimit të mënyrës së shërbimit, ruajtjes dhe konsumimit të vakteve.

Punëtoritë

Pas vizitave të realizuara në të gjitha institucionet ndëshkuese-korrektuese gjatë dy viteve, MPN-ja konstatoi se gjendja me punëtoritë dhe hapësirat e tjera për kryerjen e aktiviteteve komerciale-ekonomike është shqetësuese. Për shkak të gjendjeve të vështira financiare pjesa më e madhe e kapaciteteve ekonomike-prodhuese në institucione janë të mbyllura ose të shkatërruara dhe nuk përdoren. Gjendja e këtillë është më e theksuar në institucionin më të madh ndëshkues-korrektues në RM – **ENK "Idrizovë" – Shkup**, ku për shkak të një sërë faktorësh, siç janë parakushtet e pakënaqshme materiale, angazhimi dhe interesimi i pamjaftueshëm i personave të dënuar, por edhe planet për rikonstruim të këtij institucioni, pjesa më e madhe e kapaciteteve aktuale komerciale-ekonomike nuk përdoren²⁸. Në **ENK Shtip** numri i njërive komerciale (ekonomia dhe punëtoritë) është i vogël dhe nuk i plotëson nevojat në përputhje me kapacitetin e institucionit. MPN-ja konsideron se në këtë institucion nuk janë krijuar parakushtet e domosdoshme për realizimin e së drejtës së punës së personave të dënuar, e që padyshim ndikon në procesin e risocializimit të tyre. Gjatë vizitës, MPN-ja konstatoi se punëtorja nuk ka në dispozicion pajisje të mjaftueshme për mbrojtje gjatë punës së personave të dënuar.

Si një shembull pozitiv mund të potencohen përpjekjet e Drejtorisë së **Burgut Manastir** për mbajtjen e njërive ekzistuese komerciale dhe ekonomisë. MPN-ja ka bërë një kontroll në punëtorinë marangoze dhe fermën e kërpudhave, ku konstatoi se punëtorja është e pajisur në mënyrë solide me material pune dhe makina, megjithatë, tashmë një periudhë kohore e njëjta nuk është e furnizuar me pajisje për mbrojtje gjatë punës. Ferma e kërpudhave është shembulli i mirë për një kapacitet të vogël të suksesshëm prodhues dhe për profesionalizim të suksesshëm të personave të dënuar gjatë kryerjes së angazhimit të tyre të punës.

MPN-ja konstatoi se në praktikë nuk realizohen në tërësi detyrimet që dalin nga neni 121 dhe 122 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve. Pra, hapësirat dhe punëtoritë në të cilat punojnë personat e dënuar nuk pajisen në mënyrë bashkëkohore, ndërsa një pjesë e personave të dënuar gjatë punës në punëtori nuk përdorin kushte minimale teknike për mbrojtje gjatë punës në përputhje me rregullat e përgjithshme.

²⁸ MPN-ja konstatoi se pjesa më e madhe e objekteve në përbërje të njësisë ekonomike "Rigjallërim" nuk është në funksion, ndërsa një pjesë e tyre janë të shkatërruara. Sipas planeve aktuale dhe projektit për rikonstruim të INK dhe EEK është paraparë që kjo pjesë të rësisht të shembet.

Hapësira për sport dhe rekreacion

Në pjesën më të madhe të institucioneve ndëshkuese-korrektuese ekzistojnë hapësira për sport dhe rekreacion në formë të hapësirave për ushtrim dhe/ose sallë ping-pongu. Hapësirat për ushtrim, në shumicën e rasteve, janë të pajisura me vegla të improvizuara për ushtrim, të cilat mund të paraqesin rrezik shtesë për sigurinë e personave të dënuar që përdorin. Një pjesë e institucioneve, MPN-ja u rekomandoi se ushtrimi në ushtrimoren nuk duhet të zhvillohet pa prani të personit kompetent profesional ose personit me përvojë përkatëse.

Vetëm në ENK Shtip ushtrimoret janë të pajisura me vegla pothuajse të reja dhe funksionale për ushtrim, që i plotësojnë standardet e mbrojtjes-sigurisë. Në Burgun Strumicë, megjithatë, personat e dënuar, në mungesë të hapësirës funksionale për sport, vetë organizojnë aktivitete të lira, ndërkaq MPN-ja konstatoi ekzistimin e veglave të improvizuara për ushtrim në përbërje të oborrit të burgut.

Pjesa më e madhe e institucioneve kanë biblioteka të veta të cilat kanë në dispozicion një fond mjaft të vjetër të librave.

Hapësira për shëtitje në natyrë

Në pjesën më të madhe të INK-ve, ekzistojnë hapësira për shëtitje në natyrë të personave të dënuar, të cilat sigurojnë mundësi të kënaqshme për shëtitje në natyrë, në përputhje me rregullat aktuale ligjore. MPN-ja konstatoi se hapësira (oborri) e ENK Strugë dhe Burgut Strumicë është e rregulluar në mënyrë të kënaqshme dhe adekuate, janë të vendosura stola, pastrohet dhe mirëmbahet në mënyrë të rregullt. Hapësirat për shëtitje në natyrë pjesërisht ofrojnë mundësi edhe për aktivitete sportive, megjithatë pjesa më e madhe nuk kanë një pjesë të mbuluar që do t'u mundësonte shëtitje të papenguar personave jashtë ndërtesës gjatë kushteve të këqija të motit.

Hapësirat për shëtitje të personave të paraburgosur, personave të dënuar me trajtim të mbyllur dhe personave që vuajnë dënimin disiplinor – dërgim në dhomë izolimi janë me kapacitet më të vogël dhe mundësojnë liri më të vogël të lëvizjes. MPN-ja konstatoi se në një pjesë të INK-ve (Burgu Tetovë) kjo hapësirë mundëson realizim të papenguar të së drejtës së qëndrimit në të hapur, megjithatë në pjesën më të madhe të institucioneve këto hapësira janë dukshëm më të vogla. Prandaj, në Burgun Strumicë shëtitorja për personat e dënuar në izolim është e vogël, e fisnikëruar me sipërfaqe bari, megjithatë e njëjta nuk ka një pjesë të mbuluar në rast të motit të keq dhe në këtë mënyrë kufizohet përdorimi i saj. Edhe në Burgun Prilep, MPN-ja konstatoi se hapësira për shëtitje të personave të vendosur në repartin e mbyllur është shumë e kufizuar, ndërsa shëtitorja për personat e paraburgosur është me madhësi të kënaqshme, megjithatë, nuk ka në dispozicion mjete për pushim (stol, karrige ose etj.). Në Burgun Manastir, MPN-ja konstatoi se hapësira për shëtitjen e personave të burgosur është shumë e kufizuar, megjithatë shëtitorja u ofron personave të dënuar një liri më të madhe të lëvizjes së personave dhe mundëson realizim të aktiviteteve sportive-rekreative.

Si një shembull pozitiv, mund të theksohet hapësira e jashtme për shëtitje të personave nga reparti gjysmë i hapur i ENK Shtip, me ç'rast MPN-ja konsideron se madhësia dhe rregullimi i hapësirës i plotëson nevojat e kësaj popullsie të dënuar për qëndrim në ambient të hapur gjatë ditës.

Në ENK "Idrizovë", personat e vendosur në repartin e mbyllur, të drejtën e shëtitjes ditore në të hapur e realizojnë në oborrin kryesor/shëtitoren në rrethin e Entit, në përputhje me orarin e caktuar. Hapësira për shëtitje është e gjerë, e mbuluar me bar dhe në formë të fushës, që u mundëson personave të dënuar nga reparti i mbyllur të përfshihen në aktivitetet sportive-rekreative. Megjithatë, shëtitorja nuk ka një

pjesë të mbuluar me çka vështirësohet realizimi i papenguar i së drejtës për shëtitje të përditshme në kushte të këqija të motit.

Hapësira për shëtitje në natyrë e personave të dënuar të vendosur në repartin e pranimit dhe në repartin gjysmë të hapur të ENK "Idrizovë" është shumë e kufizuar dhe me një kapacitet të vogël. Në shëtitoren e repartit të pranimit nuk ka mjete për pushim (stola ose mjete të tjera për pushim), ndërsa hapësira për lëvizje në repartin gjysmë të hapur është më restriktive dhe është e kufizuar në një sipërfaqe më të vogël në krahasim me personat e dënuar, të cilët dënimin me burg e vuajnë në repartin e mbyllur.

Në repartin për femra të ENK "Idrizovë" hapësira për shëtitje në natyrë është e kufizuar në oborrin kur të dënuarat e kalojnë kohën e lejuar për shëtitje në natyrë. Oborri është i vogël dhe i rregulluar, me gjelbërim të mirëmbajtur dhe stola të vendosur për pushim, por në të njëjtin nuk ka një pjesë të mbuluar që të mund të përdoret edhe gjatë kushteve të këqija të motit.

B.2. Shkalla e realizimit të të drejtave të personave të privuar nga liria

1. Mbrojtja shëndetësore

Jo të gjitha institucione ndëshkuese-korrektuese kanë të punësuar mjek, edhe pse punësimi i mjekut në institucione është obligim i detyrueshëm, në përputhje me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve. Respektivisht, MPN-ja, gjatë realizimit të vizitave, konstatoi se në ENK Strugë, Burgun Tetovë dhe Burgun Strumicë nuk kanë të punësuar mjek, por mbrojtja shëndetësore realizohet përmes marrëveshjes për angazhim të mjekut të praktikës së përgjithshme (i punësuar në mënyrë të përhershme në institucionet lokale shëndetësore), që ndërmerr obligim të jetë i pranishëm në burgun një numër të caktuar të orëve gjatë javës, me qëllim për t'u mundësuar të dënuarve (dhe personave të paraburgosur) ta realizojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes shëndetësore. Më alarmuese ishte gjendja të cilën MPN-ja e konstatoi në Burgun Strumicë ku nuk kishte të punësuar asnjë infermiere.

Në INK-të jo kudo respektohet neni 42, paragrafi 3 i Rendit të shtëpisë për personat e dënuar, konform të cilit personi i dënuar paraqitet për kontroll mjekësor me kërkesë me shkrim përmes dorëzimit të së njëjtës, në një kuti të veçantë për këtë qëllim. Në asnjë institucion nuk ishte vendosur një kuti e veçantë për paraqitje, me përjashtim të repartit të mbyllur në ENK Shtip ku MPN-ja konstatoi se është vendosur një kuti për kërkesa për kontroll nga ana e mjekut. Paraqitja, edhe më tej, në shumicën e institucioneve bëhet përmes Sektorit të Sigurimit, e që MPN-ja konsideron se është e papërshtatshme, duke pasur parasysh besueshmërinë e të dhënave të gjendjes shëndetësore, si edhe faktin se shumica e ankesave të personave të dënuar kanë të bëjnë me qasjen deri te mjeku, përkatësisht konsiderojnë se në raste të caktuara kërkesat e tyre për kontroll nuk arrijnë deri te mjeku.

Në disa INK, MPN-ja i sugjeroi mjekut dhe/ose infermieres nevojën për përshkrimin e regjimit të veçantë të ushqimit (dietës) të personave të dënuar të sëmurë (zakonisht njerëz me diabet), me ç'rast iu referua neni 110, paragrafit 3 të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, sipas së cilit personat e dënuar të sëmurë marrin ushqim sipas llojit dhe sasisë që e përcakton mjekun.

MPN-ja, ka shprehur shqetësim të veçantë gjatë vizitës në Burgun Strumicë, sepse struktura aktuale e punës së sektorit shëndetësor nuk i kënaq standardet ndërkombëtare të përcaktuara nga ana e Këshillit të Evropës, si dhe rekomandimet e OBSH-së. Shërbimi i sigurimit në këtë burg ka qasje të drejtpërdrejtë dhe të papen-

guar deri te kartonët mjekësor, me çka nuk respektohet parimi i besueshmërisë midis mjekut dhe pacientit. MPN-ja ia rikujtoi Drejtorisë së burgut se Rekomandimi nr. 98, në pjesën e aspekteve etike dhe organizuese të mbrojtjes shëndetësore në burg të Këshillit të Evropës²⁹ parashikon besueshmërinë e të dhënave të pacientëve që janë të vendosur në burg. Në INK të tjera, dokumentet mjekësore dhe kartonët shëndetësor ishin vendosur në dollapë të veçantë të ambulancës ose në zyrën e infermieres, ku ruhen në mënyrë të besueshme dhe deri te të njëjtat qasje ka vetëm shërbimi i mbrojtjes shëndetësore. Përveç Burgut Strumicë, MPN-ja konstatoi se ky standard pjesërisht nuk respektohet edhe në Burgun Prilep, ku kartonët shëndetësorë ruhen në raft në dhomën e ambulancës, sepse nuk ka një dollap përkatës për ruajtjen e të njëjtëve. Në këtë mënyrë vihet në pikëpyetje besueshmëria e të dhënave që i përmbajnë të njëjtat, si dhe rrethi i personave të cilëve u mundësohet një qasje deri te kartonët.

Ekipi i MPN-së sugjeron nevojën për krijimin e një marrëdhënie mirëbesimi midis mjekut dhe pacientit, për shkak se veçanërisht është me rëndësi që gjatë kontrollit të mos jenë të pranishëm zyrtarë me uniformë. Në disa institucione u konstatua prania e zyrtarëve të tjerë gjatë kontrollit mjekësor (sidomos theksohet Burgu Strumicë, ENK Strugë dhe të tjerë), që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare. MPN-ja sidomos ia rikujtoi drejtorive të institucioneve detyrimet që dalin nga neni 10, paragrafi 3 i Rendit të shtëpisë për personat e dënuar dhe neni 10, paragrafi 2 i Rendit të shtëpisë për vuajtjen e masës së paraburgimit, sipas së cilave kontrolli mjekësor i personave të dënuar dhe të paraburgosur realizohet pa praninë e zyrtarëve me uniformë.

MPN-ja konstatoi një numër të madh të mangësive dhe parregullsive në punën e sektorit të mbrojtjes shëndetësore në pjesën e kontrollit dhe vizitës së personave që vuajnë dënimin disiplinor – izolim. Në Burgun Tetovë dhe ENK Shtip gjatë bisedës me personat që vuajnë ose kanë vuajtur dënimin me izolim³⁰, të njëjtët kanë thënë se para se të dërgohen në izolim nuk ishin kontrolluar nga mjeku, gjendje të cilën MPN-ja e konstatoi edhe me kontrollin e dosjes profesionale, kur draft-raporti për vuajtjen e dënimin disiplinor ose vendimi për shqiptimin e masës izolim jo gjithmonë e përmbajnë mendimin e mjekut siç e përcakton Ligji për ekzekutimin e sanksioneve. Njëkohësisht, MPN-ja nuk pajtohet me praktikën që mjeku të jep mendim me të cilin vërtetohet se gjendja shëndetësore e personit mundëson që i njëjti të dërgohet në vuajtjen e dënimin me izolim, por konsideron se duhet të respektohet në tërësi neni 179, paragrafi 4 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, ku ligjdhënësi pa mëdyshje ka parashikuar që mjeku të jep mendim për gjendjen shëndetësore të personit të dënuar, pa paragjykuar se ai është i aftë për ta dërguar në izolim.

Ndërkaq, në ENK Strugë, personat e dënuar u ankuan se nuk ishin vizituar çdo ditë nga ana e mjekut derisa e kanë vuajtur dënimin disiplinor – izolim. Nga kontrolli i dokumenteve mjekësore, MPN-ja konstatoi se ekzistojnë të dhëna, të cilat do të vërtetojnë se vizita e mjekut realizohet në mënyrë të përditshme derisa një person tjetër vuan dënimin me izolim, nga e cila mund të arrihet në përfundim se obligimi që del nga neni 184, paragrafi 4 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve nuk realizohet në tërësi në praktikë. MPN-ja pranoi ankesa të ngjashme në më shumë institucione, prandaj dhe në raportet e veçanta ua rikujtoi drejtorive të institucioneve se, në përputhje me detyrimet që dalin nga Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, personi i dënuar me dënim disiplinor – izolim duhet çdo ditë të vizitohet nga ana e mjekut – MPN-ja konsideron se obligimi i këtillë ligjor realizohet vështirë në ato INK që nuk kanë të punësuar mjek, por mbrojtjen shëndetësore e realizojnë duke nënshkruar një marrëveshje me mjekun nga institucioni i afërt publik shëndetësor.

Personat e dënuar, të vendosur në repartin e pranimit, u ankuan se u është ku-fizuar qasja deri te mjeku, më saktë të njëjtit ende nuk ishin kontrolluar nga mjeku,

²⁹ Recommendation No R (98) 7 concerning the ethical and organizational aspects of health care in prison – Council of Europe – Committee of ministers adopted on 8 April 1998, at the 627 meeting of the Deputies.

³⁰ Si dhe gjatë bisedës me një person tjetër, të vendosur në repartin gjysmë të hapur, i cili gjatë muajit të paraprak ka vuajtur dënimin disiplinor dërgim në dhomën e izolimit.

edhe pse obligimi për kontroll bëhet brenda 24 orëve, pas pranimit të personit në institucionin, ndërsa sipas nenit 10 të Rendit të shtëpisë për personat e dënuar. Gjatë veprimit sipas rastit të tillë në ENK Shtip, ku personi i dënuar ka qenë i pranuar dhe ka qëndruar tashmë një javë në këtë institucion, ekipi i MPN-së konstatoi se kartoni shëndetësor për atë person është bosh dhe se për të njëjtin person, që është transferuar në ENK Shtip nga një INK tjetër, atij nuk i është dorëzuar dokumentacioni mjekësor, ndërsa mjeku i burgut nga ENK Shtip nuk ka njohuri për sëmundjet e mëparshme ose terapitë që ka marrë personi i dënuar. Së këtejmi, ekipi i MPN-së kërkon të respektohet rekomandimi i Këshillit të Evropës në lidhje me aspektet etike dhe organizative të mbrojtjes shëndetësore në burgjet ku në pikën 18 është përcaktuar se: *"të gjitha transferimet, nga një burg në një tjetër, duhet të ndiqen me dokumentacionin e plotë mjekësor. Evidenca duhet të dërgohet në kushte që do ta sigurojnë besueshmërinë. Personat e dënuar duhet të informohen se dokumentacioni i tyre mjekësor do të jetë i transferuar"*³¹.

Në disa INK, MPN-ja konstatoi parregullsi gjatë plotësimit dhe udhëheqjes së evidencave mjekësore, si edhe kartonëve bosh shëndetësor të personave të dënuar. Kështu, në INK Strugë, MPN-ja konstatoi se të dhënat e regjistruara në librin e ambulancës nuk korrespondojnë në tërësi me të dhënat e shënuara në kartonët shëndetësor. Dy nga pesë kartonët shëndetësor që MPN-ja i ka kontrolluar sipas zgjidhjes së rastësishme ishin bosh, me ç'rast njëri, përveç të dhënave personale të personit të dënuar, nuk përmbante të dhëna të tjera për gjendjen e tij shëndetësore, ndërsa kartoni i dytë i përmbante vetëm të dhënat themelore në lidhje me kontrollin fillestar i bërë gjatë pranimit të personit. MPN-ja konsideron se çdo e dhënë për gjendjen shëndetësore të personit të dënuar duhet në mënyrë efikase, në tërësi dhe në vazhdimësi të regjistrohët në kartonin personal shëndetësor që udhëhiqet për atë person.

MPN-ja, gjithashtu, konstatoi se në disa institucione terapia e mbrëmjes u jepet personave të dënuar nga ana shërbimi i sigurimit. MPN-ja konsideron se në rastet kur terapia në mbrëmje jepet nga zyrtarët, sektori i mbrojtjes shëndetësore duhet të veprojë me vëmendje të madhe dhe të ndërmerr masa në drejtim të mbrojtjes së plotë të besueshmërisë, të cilat kanë të bëjnë me sëmundjen dhe terapinë që jepet. Në të kundërtën, do të lëkundet raporti mjek-pacient, ndërkohë që ekziston edhe rreziku të dhënat e besueshme për gjendjen shëndetësore të personit të dënuar të ndahen me persona të tjerë të paautorizuar ose të keqpërdoren.

Është specifike gjendja në ENK "Idrizovë" – Shkup me realizimin e së drejtës së mbrojtjes shëndetësore për shkak të madhësisë së kapaciteteve të këtij institucioni dhe numrit të madhe të personave të dënuar të vendosur këtu. Ekipi i MPN-së, në bashkëpunim me bashkëpunëtorin e jashtëm-psikiatër, realizoi një bisedë me psikiatrin (udhëheqësin e repartit për mbrojtje shëndetësore) dhe mjekun përgjegjës për qendrën e metadonit dhe ka bërë kontroll në më shumë dosje mjekësore. Në ENK "Idrizovë" zbatohet mbrojtje primare shëndetësore, ndërkaq funksionon edhe një qendër e veçantë e metadonit, në punën e së cilës është i përfshirë një mjek, një infermiere dhe një laborant. Në përbërje e ENK "Idrizovë" punojnë katër mjekë nga të cilët një është psikiatër, me çka personave të dënuar në këtë Ent u mundësohet një qasje e drejtpërdrejtë deri te shërbimet psikiatrike dhe shërimi.

Bashkëpunëtori i jashtëm-psikiatër për MPN në biseda me shërbimin shëndetësor dhe me persona të dënuar konstatoi se në Ent janë të vendosur persona me vështirësi psikologjike që kanë mendime paranoike. Tek një pjesë e tyre, përmes ekspertizës, është konstatuar parashikueshmëri parciaisë, ndërsa të njëjtët vendosen në më shumë reparte të institucionit. MPN-ja në raportin e veçantë ia përkujtoi Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve Rregullave Evropiane të burgjeve, në përputhje me të cilat *"për personat e dënuar që vuajnë nga çrregullime mendore ose anomalitë duhet të ekzistojnë ente të specializuara ose reparte nën kontroll mjekësor për vëzhgim dhe*

³¹ Recommendation No R (98) 7 concerning the ethical and organisational aspects of health care in prison.

mjekim, ndërkaq vëmendje e veçantë t'i përkushtohet parandalimit të vetëvrasjeve³²". Njëkohësisht, Rekomandimi Rec (98) 73 i Komitetit të Ministrave të Këshillimit të Evropës kërkon: "të burgosurit që vuajnë nga çrregullime të rënda mendore të vendosen dhe të mjekohen në repartin spitalor, që është i pajisur në mënyrë adekuate dhe ku është i punësuar personel përkatës i trajnuar". Në nenin 126 të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve qëndron se "personat e dënuar, tek të cilët do të konstatohen çrregullime trupore dhe mendore si edhe varësi të caktuara, u nënshtrohen trajtimit mjekësor në institucionin, ndërsa kur është e nevojshme me diagnozë nga mjeku drejtohen në institucionin përkatës shëndetësor".

Nga kontrolli në kartonët shëndetësor në ENK "Idrizovë", MPN-ja konstatoi se për personat tek të cilët sektori shëndetësor ka konstatuar prirje ndaj qëllimeve suicidiale dhe çrregullime disociale shqiptohet një dënim disiplinor – izolim, e që e konsideron si trajtim të papërshtatshëm.

Për përdoruesit e terapisë së metadonit, të cilët dënimin me burg e vuajnë në ENK "Idrizovë" – Shkup udhëhiqen kartonë të posaçëm, ndërsa personat lidhin kontratë me të cilën japin pëlqim për kontroll të urinës për shkak të përdorimit të mundshëm të narkotikëve, më saktë ata që janë përfshirë në terapinë e metadonit e kanë për detyrë që rregullisht ta kontrollojnë urinën. Personat që janë në terapi të metadonit në masë të madhe janë të vendosur në stacionar. Gjatë kontrollit të kartonëve mjekësor, të atyre personave që u ankuan në lidhje me mbrojtjen shëndetësore u konstatua se të njëjtët janë në rregull, në to janë përmbajtur dokumentet nga kontrollet e specialistëve, incizimet e rëntgenit dhe u konstatua se shërbimi mjekësor, gjithmonë kur ka nevojë, i dërgon personat në kontrole tek specialisti.

Shembulli pozitiv:

Si një shembull pozitiv MPN-ja dëshiron ta potencojë **punën e mjekut në Burgun Prilep**. Pjesa më e madhe e të burgosurve të dënuar me të cilët Avokati i Popullit – MPN ka realizuar bisedë nuk kishin ankesa sa i përket mbrojtjes shëndetësore që e realizojnë në burg. Personi që vuante dënimin disiplinor "dërgim në izolim" e ka informuar MPN se para dërgimit në izolim është kontrolluar nga mjeku dhe se i njëjti e viziton çdo ditë, me çka mund të konstatohet se mjeku i zbaton dispozitat për mbrojtjen shëndetësore të përcaktuara me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve. Personat në repartin e pranimit, gjithashtu, pohuan se gjatë pranimit ishin kontrolluar nga mjeku. Një person i cili ishte vetëlënduar ishte dërguar menjëherë te mjeku, ndërsa për të njëjtin u konstatua se në mënyrë të rregullt udhëhiqet kartoni i tij shëndetësor. Kontrollet bëhen pa prezencë të shërbimit të sigurimit, por nëse ka nevojë, në raste të pacientëve të rrezikshëm ose agresivë, një përfaqësues i shërbimit është i pranishëm gjatë realizimit të kontrollit. Mjekja përfshihet edhe në kontrollin e ushqimit, kontrollohet të njëjtin, ndërsa cilësinë e tij e evidenton në mënyrë përkatëse në librin për kontroll të ushqimit.

MPN-ja e përshëndet mënyrën e konstatimit të gjendjeve në ditarin e ambulancës dhe në kartonin shëndetësor – mjekja në mënyrë përkatëse i regjistron lëndimet e personave të dënuar, por edhe deklaratat/të dhënat e personave për mënyrën në të cilën ka ndodhur vet lëndimi (nga rrahja, me grushte), për të cilat në mënyrë përkatëse i informon shërbimet e tjera të burgut (Sektorin e Sigurimit dhe/ose Sektori për Risocializim). Në këtë mënyrë, theksohet roli parandalues i mjekut, i cili në përputhje me Rregullat Evropiane të Burgjeve "e ka për detyrë t'i evidentojë dhe njoftojë organet kompetente për secilën shenjë ose indikacion se të burgosurit trajtohet me dhunë"³³.

³² Pika 47.1 e Rregullave Evropiane të Burgjeve.

³³ Neni 42.3 (c) – Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 2 i Komitetit të Ministrave të vendeve anëtare në lidhje me Rregullat.

2. E drejta e arsimit

Në institucionet ndëshkuese-korrektuese e drejta e arsimit nuk realizohet në mënyrë siç parashihet me rregullat ligjore, duke pasur parasysh arsimin e obligueshëm fillor dhe të mesëm. MPN-ja përkujton se *"Çdo burg duhet të përpiqet që të gjithë të burgosurve t'u sigurojë qasje deri te programet arsimore, të cilat duhet të jenë sa të jetë e mundur më gjithëpërfshirëse dhe t'i plotësojnë nevojat e tyre individuale, njëkohësisht duke i marrë parasysh afinitetet e tyre"* në përputhje me Rekomandimin Rec (2006) 2 të Komitetit të Ministrave deri te vendet-anëtare për Rregullat. Së këtejmi, prioritet kanë personat e dënuar që janë analfabetë ose të cilët nuk kanë arsim fillor ose profesional (arsimor).

Vetëm ENK "Idrizovë" ka nënshkruar marrëveshje me shkollën fillore për të rritur "A.S. Makarenko"-Shkup", ndërsa për arsim janë paraqitur 48 persona të dënuar. MPN-ja, gjatë bisedës me një person të dënuar nga ky burg ka marrë informacion se edhe pse profesorët vijnë, personat e dënuar nuk paraqiten në mësim, për shkak se konsiderojnë se nuk ka kapacitete hapësinore për mbajtjen e procesit mësimor. Ekipi i MPN-së gjatë kontrollit konstatoi se në të njëjtën ka kushte për mbajtjen e mësimin, ndërsa personat e dënuar që janë të interesuar për mbajtjen e mësimin mund të ndahen në grupe, në mënyrë që papengesë të mund ta ndjekin këtë proces arsimor.

3. E drejta e punës

Shkalla e angazhimit me punë në institucionet ndëshkuese-korrektuese në Republikën e Maqedonisë është në një nivel pothuajse të ulët dhe të pakënaqshëm. Duke pasur parasysh qëllimin e risocializimit, MPN-ja konstatoi se vetëm personave të dënuar me një regjim më të butë të trajtimit (trajtim i hapur dhe gjysmë i hapur) u sigurohet që përmes punës të fitojnë dhe t'i zhvillojnë shprehjet për punë dhe të fitojnë njohuri profesionale për punë jashtë burgut. Megjithatë, MPN-ja konstatoi se këtë të drejtë e realizon një numër shumë i vogël i personave të dënuar edhe atë për shkaqe objektive dhe subjektive, ndërsa si shembull pozitiv mund të potencohet burgu Manastir (me punë janë të angazhuar rreth 45% të personave të dënuar) dhe ENK Strugë (me punë janë të angazhuar rreth 43% të numrit total të personave të dënuar), e që MPN-ja e konsideron si një faktor pozitiv, i cili ndikon në realizimin e një procesi të suksesshëm të risocializimit të personave të dënuar.

Në pjesën më të madhe të institucioneve ndëshkuese-korrektuese personat e dënuar nga repartet e mbyllur nuk janë të angazhuar me punë. Kështu, gatë vizitës së ENK Shtip, vetëm një person nga reparti i mbyllur, i cili numëronte gjithsej 90 persona të dënuar, ishte i angazhuar me punë (në furrë). Avokati i Popullit – MPN konsideron se pikërisht mospërfshirja me punë kontribuon për zhvillimin e "kulturës së dënueshme" dhe ndikon negativisht mbi procesin e risocializimit të tyre, ndërsa personat përshtaten vështirë në kushtet në burgje. Angazhimi me punë, si rezultat duhet ta ketë fitimin e shprehive të punës dhe shkathtësive për kryerjen e një lloji të detyrave të punës, mbajtjen e aftësive psiko-fizike, realizimin me sukses të procesit të risocializimit dhe persona të dënuar të aftësuar për kryerjen e një lloji të caktuar të profesioneve, të aftësuar për punësim dhe sigurim të pavarur të ekzistencës në liri³⁴.

Pasiviteti dhe joproduktiviteti, si edhe mungesa e aktiviteteve shtesë në repartin e mbyllur mund të ndikojnë në mënyrë kundër-produktive në procesin e risocializimit, ndërsa me këtë edhe në mosplotësimin e qëllimeve të vuajtjes së dënimit me burg, përmes së cilit duhet të vijë deri te përmirësimi i personit si dhe deri te fitimi i shprehive të punës, që do të ndihmojë në sistemin pas-penal të riintegritit.

Personat që vuajnë masën e paraburgimi dhe që janë vendosur në repartet e

³⁴ Nxjerrë nga dokumenti intern i INK Shtip: Procedura gjatë realizimit të angazhimit me punë të personave të dënuar në INK.

paraburgimit të institucioneve, për shkak të natyrës së privimit të tyre nga liria, nuk janë përfshirë në procesin e punës, i cili zbatohet përmes sektorit ekonomik-instruktur, e as në aktivitetet e rregullta të punës që realizohen në kuadër të burgut, për shkak se pjesën më të madhe të kohës e kalojnë të mbyllur në dhomën e paraburgimit në të cilën janë të vendosur. Rregullorja për Rendin e shtëpisë për vuajtjen e masës së paraburgimit në repartin e paraburgimit të burgjeve³⁵ në nenin 22 përcakton obligimin për drejtorinë e burgut, që personit të paraburgosur, me kërkesë të tij, t'i sigurojë kushte për punë, nëse i njëjti ka aprovim nga gjyqtari hetues ose kryetari i këshillit. MPN-ja konstatoi se në asnjë institucion ndëshkuese-korrektues ky përcaktim nuk zbatohet në praktikë, fillimisht për shkak se zgjidhjet aktuale sistematike dhe parakushtet materiale-teknike në burgje, si dhe ndarja fizike e reparteve të paraburgimit, të pjesës së të burgosurve në përbërjen e së cilës janë të vendosura njësitë ekonomike, nuk mundësojnë zbatimin në praktikë të këtij neni.

4. E drejta e qëndrimit në ambient të hapur dhe rekreacioni

MPN-ja si problem më të madh e thekson hapësirën e kufizuar dhe shumë restriktive të lëvizjes së personave që vuajnë masën e paraburgimit. Përkatësisht, këta persona pjesën më të madhe të ditës dhe natës e kalojnë në dhomat e tyre të gjumit (madje 22 orë në ditë), ndërsa vetëm një deri dy orë qëndrojnë jashtë hapësirave të tyre. Dalja jashtë, në ambient të hapur për më pak se 2 orë është në kundërshtim me përcaktimet ligjore, të cilat kërkojnë që personave të paraburgosur t'u sigurohet lëvizje në ambient të hapur më së paku dy orë në ditë. Këto sugjerime Avokati i Popullit – MPN i dërgoi deri te drejtoritë e disa institucioneve ndëshkuese-korrektuese (Burgun Tetovë, Burgun Prilep etj.) me çka i përkujtoi se e drejta e qëndrimit në ambient të hapur duhet të realizohet gjithmonë dhe kjo detyrimisht duhet të zbatohet, në përputhje me përcaktimet e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, ku kufizimi në një orë në ditë qëndrim dhe shëtitje në ambient të hapur është përcaktuar vetëm për dënimin disiplinor dërgim në izolim, por jo edhe për kategoritë e tjera të personave të privuar nga liria.

MPN-ja nga drejtoritë e disa INK-ve kërkoi respektim të plotë të përcaktimeve të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, ku në nenin 112 përcaktohet se "personave të dënuar duhet t'u sigurohet që jashtë hapësirave të *mbyllura të kalojnë më së paku dy orë në ditë*", ndërsa mbi këtë bazë duhet të përfshihen të gjithë personat e dënuar, me përjashtim të personave të cilët vuajnë dënimin – izolim.

Së këtejmi, MPN-ja e kërkoi këtë nga drejtoria e INK Shtip për personat që janë të vendosur në repartin e pranimit dhe personat që janë të ndarë në repartin e mbyllur³⁶, nga drejtoria e Burgut Prilep, ku personat në repartin e mbyllur kanë mundësi për ta përdorur shëtitoren kryesore të burgut vetëm një orë në ditë, nga drejtoria e Burgut Strumicë, ku problem është kohëzgjatja e qëndrimit në të hapur e personave të dënuar që qëndrojnë në izolim, si edhe nga drejtoria e Burgut Tetovë, ku personave të dënuar, të vendosur në repartin e pranimit, me përjashtim të personit që vuan izolimin, duhet t'u sigurohet jashtë hapësirave të mbyllura të kalojnë më së paku dy orë në ditë, në përputhje me nenin 112 të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve.

Personat nga reparti i hapur/gjysmë të hapur, zakonisht kanë të drejtën e qëndrimit më të gjatë në të hapur gjatë ditës, në krahasim me personat me trajtim të mbyllur.

³⁵ "Gazeta zyrtare e RM"-së nr. 101/2011 (publikuar më 26.07.2011)

³⁶ Ndarja e personit i privuar nga liria ndërmerr në rast të shkeljes serioze të Rendit të shtëpisë së institucionit ose kur kryhet një veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, ndërkaq e cila për shkak të veprimeve të tij paraqet rrezik serioz për sigurinë e nëpunësve dhe personave të tjerë në institucion, si edhe për shkak të sigurimit të vendit të ngjarjes dhe ndarjes së autorit të veprës nga dëshmitarët – Udhëzim për kushtet dhe mënyrën e përdorimit të mjeteve për detyrim nga ana e anëtarëve të sektorit të sigurimit në INK dhe ENK.

5. E drejta e ushqimit

Vërejtjet dhe ankesat më të mëdha që vijnë nga personat e privuar nga liria kishin të bënin me sasinë e vakteve dhe cilësinë e ushqimit që marrin. Në disa INK gjatë vizitës kishte mungesë serioze të produkteve ushqimore. Gjatë kontrollit në magazinën e Entit të INK "Idrizovë", MPN-ja konstatoi se ka mungesë të materialeve themelore ushqimore për përgatitjen e ushqimit.

Personat e arrestuar dhe personat e vendosur në izolim ushqimin e marrin dhe e konsumojnë në të njëjtat hapësira në të cilat janë të vendosur, ndërsa në të cilat higjiena shpeshherë është në nivel të ulët, e që mund të paraqes rrezik të mundshëm për shëndetin e tyre. MPN-ja konsideron se praktika e këtillë është degraduese, duke i pasur parasysh kushtet e dobëta dhe të pakënaqshme materiale në këto hapësira.

Në një pjesë të institucioneve ekziston mungesë serioze e pajisjeve për ngrënie, e që ishte më theksuar në INK "Idrizovë"-Shkup. MPN-ja e potencon obligimin që personat e dënuar të përdorin pajisje/takëme standarde për mëngjes, të bërë nga materiali që i plotëson standardet për siguri të ushqimit³⁷.

Në disa repartet të INK "Idrizovë" – Shkup, ankesat kishin të bënin edhe me kohën kur ndahet mëngjesi, përkatësisht pjesa më e madhe e personave të dënuar theksuan se mëngjesi u jepet në mbrëmje, ndërsa të njëjtit nuk kanë kushte përkatëse në dhomat për ruajtjen e vaktit. Në burgje gjatë përgatitjes së vakteve kihet kujdes për ndjenjat fetare dhe nevojat e personave të privuar nga liria.

Në disa institucione (ENK Shtip, Burgun Manastir etj.) MPN-ja konstatoi se libri për kontrollin e cilësisë së vakteve nuk plotësohet në mënyrë të rregullt, gjë që çon në konkluzion se kontrolli nuk bëhet çdo ditë. Në këtë drejtim, për shkak të mangësive të caktuara MPN-ja manifestoi shqetësim në pjesën e mbikëqyrjes së cilësisë së ushqimit dhe kërkoi nga drejtoria dhe mjeku t'u përkushtojnë vëmendje më të madhe procesit të përgatitjes së vakteve, vlerës së tyre energjetike, si edhe të sigurojnë kontroll të rregullt dhe të vazhdueshëm të cilësisë së ushqimit.

Në pjesën më të madhe të institucioneve nuk ka ndonjë ushqim të veçantë (dietë) për kategoritë e personave të sëmurë nga diabeti, hepatiti dhe sëmundje të tjera. MPN-ja përkujton INK (sidomos sektorin për mbrojtje shëndetësore) se obligimi për regjim të veçantë të ushqimit për personat e dënuar të sëmurë del nga neni 110, paragrafi 3 i Ligjit për ekzekutim të sanksioneve.

Në lidhje me ushqimin e burgut, pjesa më e madhe e personave, me të cilët MPN-ja zhvilloi bisedë në burgun Tetovë, shprehën fjalë lavdërimi për ushqimin që marrin, ishin të kënaqur dhe nuk kishin ankesa në lidhje me cilësinë e ushqimit, megjithatë nuk ishin të kënaqur me sasinë e mëngjesit dhe darkës. Gjendje të ngjashme MPN-ja hasi edhe në ENK Strugë.

6. Parashtrimi i parashtrësive dhe kontaktet me botën jashtë burgut

Në bisedën me personat e dënuar, ekipi i MPN-së konstatoi se, në pjesën më të madhe të institucioneve, personat kanë të drejtë të parashtrojnë parashtrësë ose kërkesë për takim me drejtorin e burgut. Zakonisht, mënyra e parashtrimit bëhet përmes paraqitjes së kërkesës me shkrim nëpërmjet Sektorit për Risocializim ose nëpërmjet Sektorit për Sigurim. Në disa institucione, si në ENK Shtip, personat e dënuar theksuan se bisedat me drejtorin nuk janë të natyrës së besueshme, sepse në to janë të pranishëm edhe persona të tjerë të punësuar. Personat e dënuar, në një pjesë

³⁷ Rregullorja e normativave për përgatitjen e ushqimit të personave të dënuar, e miratuar nga Ministria e Drejtësisë më 25.03.2009.

të institucioneve, theksuan se drejtori në mënyrë të rregullt i viziton edhe kapacitet e vendosjes së institucionit (ENK Idrizovë, Burgun Manastir), ndërsa në institucionet e tjera personat e privuar nga liria u ankuan se nuk vizitohen nga ana e drejtorit (p.sh., personat që vuajnë masën e paraburgimit në Burgun Prilep).

Në të gjitha INK ka të vendosura kuti postare të Avokatit të Popullit, përmes së cilave personat mund të parashtrajnë parashtrësë në rast se mendojnë se të drejtat e tyre janë shkelur ose të njëjtat nuk mund t'i realizojnë. Gjatë kontrollit në Burgun Strumicë, MPN-ja konstatoi se shërbimi i kujdestarisë ka një kontroll të drejtpërdrejtë mbi rutinën e AP-it, dhe mbi të njëjtën ishte ngjitur një fletë në të cilën shkruante "Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve", me çka mund të vihen në lajthitje personat e dënuar. Gjatë vizitës në Burgun Tetovë, MPN-ja konstatoi se kutia e Avokatit të Popullit nuk është siç duhet, e njëjta hapet lehtë dhe deri te ajo qasje kanë të gjithë personat e dënuar, si edhe të punësuarit në shërbimet e burgut. Gjithashtu, MPN-ja konstatoi se personalisht drejtori dhe shërbimi i sigurimit të Burgut Tetovë, nëpërmjet sistemit të video-mbikëqyrjes, kanë kontroll të drejtpërdrejtë mbi rutinën, më saktë e njëjta përfshihet me video-mbikëqyrjen përmes kamerës së instaluar në TV sallën.

Personat e dënuar dhe të paraburgosur shumë rrallë ose aspak nuk vizitohen nga ana e gjyqtarëve për ekzekutimin e sanksioneve, kryetarit të Gjykatës themelore ose nga ndonjë gjyqtar tjetër, e që është në përputhje me detyrimet që dalin nga Ligji për ekzekutimin e sanksioneve dhe nga Ligji për procedurë penale. Vetëm në Burgun Manastir vizitat e këtilla janë të rregullta, ndërsa në Burgun Prilep, sipas të dhënave të marra nga drejtoria, kryetari i Gjykatës Themelore Prilep një herë në javë e viziton institucionin.

Kontaktin me botën jashtë burgut personat e dënuar e realizojnë nëpërmjet vizitave me të afërmit e tyre (bashkëshortin, familjen) dhe nëpërmjet bisedave telefonike, në përputhje me rregullat pozitive-ligjore, Renden e shtëpisë dhe në kohën e caktuar nga ana e drejtorit të institucionit. MPN-ja gjatë realizimit të vizitave nuk mori ankesa më të mëdha nga ana e personave të dënuar, sa i përket realizimit të të drejtës së vizitës, megjithatë në praktikë paraqiten probleme gjatë realizimit të vizitës me të cilin i dënuari jeton në bashkësi jashtëmartesore, ndërsa në disa institucione ndëshkuese-korrektuese personat u ankuan në qasjen deri te telefoni dhe mosfunksionimin e kabinave telefonike publike, me çka u shkurtohet mundësia për të kontaktuar me botën jashtë burgut.

B.3. Trajtimi i personave të privuar nga liria

Në shumicën e institucioneve ndëshkuese-korrektuese të cilat Avokati i Popullit – MPN i vizitoi gjatë vitit 2012, personat e dënuar dhe personat që vuajnë masën e paraburgimit, me të cilët zhvilloi bisedë, nuk u ankuan për torturë ose trajtime tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese nga ana e shërbimeve të institucionit. Personat, kryesisht nuk kishin vërejtje në pjesën e veprimit dhe trajtimit të shërbimeve të burgut, ndërsa për të punësuarit në sektorin e sigurimit konsiderojnë se veprojnë në mënyrë korrekte.

MPN-ja, disa herë ka shprehur shqetësim për realizimin efikas të hetimit nga drejtoria e institucionit për dyshimin më të vogël rreth ndonjë sulmi fizik ose dhune midis personave të dënuar, si dhe dhunë të kryer nga ana e shërbimeve mbi të burgosurit dhe/ose personat e paraburgosur. Indikacionet e këtilla, për raste të mundshme, u identifikuan në Burgun Prilep, ENK "Idrizovë", ENK Shtip dhe Burgun Strumicë. Të dhëna për raste të lartpërmendura zakonisht shprehnin personat e dënuar që kanë vuajtur dënimin disiplinor – izolim ose personat e dënuar me trajtim të mbyllur, të vendosur në repartet e burgjeve të institucioneve, ndërsa rastet janë përshkruar në

mënyrë të detajuar në raportet e veçanta të dërguara deri te drejtoritë e INK dhe Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve pranë Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë. Një pjesë e të dhënave, me kërkesë dhe pëlqim të denoncuesit, ishin dorëzuar deri te zyrat rajonale e Avokatit të Popullit, për shkak të procedimit të mëtejshëm.

Edhe pse pjesa më e madhe e këtyre personave nuk kanë parashtruar ankesë zyrtare deri te drejtoria e burgut, e as parashtrësë deri te ndonjëri nga mekanizmat e jashtëm kontrollues, MPN-ja konsideron se ka qenë e nevojshme dhe e domosdoshme të analizohen të dhënat dhe të konstatohen faktet për rastet konkrete, për të cilat MPN-ja mori konfirmim edhe nga persona të tjerë të dënuar gjatë zhvillimit të bisedave konfidenciale. Gjatë vizitës së ENK "Idrizovë" – Shkup, disa të dënuarit (nga reparti i pranimit, i mbyllur, femëror), u ankuan se shërbimi i sigurimit ndaj tyre ka vepruar në mënyrë joadekuate, përkatësisht ishte përdorur forcë dhe ishin trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe/ose degraduese. Një pjesë e personave të dënuar u ankuan edhe për dhunën midis popullsisë së dënuar, si dhe për kërcënimet dhe ekzistimin e frikës për sigurinë personale.

Veçanërisht është karakteristik rasti në Burgun Prilep, ku drejtoria e burgut nuk ka ndërmarrë masa efikase dhe konkrete në drejtim të analizimit të të dhënave, edhe pse nga ana e mjekut të burgut ishte konstatuar se personi kishte lëndime, me ç'rast në ditarin e ambulancës ishte evidentuar edhe deklarata e personit të dënuar se ka qenë i rrahur, ndërsa në raportin e kirurgut-specialist ishte shkruar në mënyrë shtesë se personi ka qenë i rrahur me grushte.

Në këtë drejtim, MPN-ja i vuri në dukje drejtorisë së burgut obligimet që dalin nga Konventa Kundër Torturës dhe Llojeve tjera të Trajtit apo Ndëshkimit Mizor, Çnjerëzor ose Degradues të Kombeve të Bashkuara nga viti 1987³⁸, ku në nenin 12 theksohet se "çdo shtet anëtar kujdeset që organet kompetente menjëherë të zbatojnë hetim të paanshëm gjithmonë kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për dyshim të aktit të torturës..." si dhe përcaktimet e Deklaratës për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Tortura dhe format e tjera të trajtimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose degradues nga viti 1975³⁹, në të cilën në nenin 9 theksohet se "gjithmonë kur ka bazë për të besuar se është bërë një formë e torturës, organet kompetente duhet menjëherë të zbatojnë një hetim të paanshëm, edhe në rastet kur nuk ka pasur asnjë ankesë formale".

Në këtë drejtim duhet të merren parasysh edhe standardet e Komitetit për Parandalimin e Torturës pranë Këshillit të Evropës (KPT) në të cilat qëndron se "Nëse shfaqja e informacioneve që japin indikacione për trajtim të keq nuk ndiqet me përgjigje të shpejtë dhe efikase, ata që kanë për qëllim t'i trajtojnë keq personat e privuar nga liria së shpejti do të kuptojnë, dhe me arsye të mirë, se një gjë të tillë mund ta bëjnë pa mos u dënuar. Sipas pikëpamjes së Komitetit, madje edhe kur nuk ka pasur ankesë të parashtruar formale, organet e tilla duhet të kenë obligim ligjor të realizojnë hetim gjithmonë kur do të marrin informacione të besueshme nga cilido qoftë burim, se personat e privuar nga liria e tyre i janë ekspozuar keqtrajtimit"⁴⁰.

Gjatë realizimit të vizitës në Burgun Manastir, MPN-ja konstatoi trajtim degradues përmes realizimit të video-mbikëqyrjes në dy dhoma të fjetjes. Gjatë kontrollit të video-monitorimit në shërbimin e kujdestarisë, MPN-ja konstatoi se kamerat janë vendosur në dy mure të kundërta në dy dhoma individuale, me çka ka një shikim të drejtpërdrejtë mbi hapësirat, duke përfshirë edhe krevatet ku personat flenë. MPN-ja konsideron se realizimi i këtillë i mbikëqyrjes nëpërmjet kamerave që incizojnë në mënyrë të vazhdueshme gjatë ditës dhe natës personat në dhomat e fjetjes është në kundërshtim

³⁸ Convention against Torture and Other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment, entry into force 26 June 1987.

³⁹ Declaration on the Protection of all persons from being subject to torture and other cruel, inhuman or degrading treatment or punishment, 09.12.1975.

⁴⁰ Shkëputje nga Raporti i përgjithshëm i 14-të (CPT (2004)28).

me nenin 38, paragrafin 1 të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, në përputhje me të cilin gjatë vuajtjes së dënimit me burg duhet të respektohet personaliteti dhe dinjteti i njeriut, si dhe me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale⁴¹. Në përputhje me Doracakun për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë zbatimit të video-mbikëqyrjes⁴², kur kamera është e vendosur në hapësirat e brendshme e njëjta nuk duhet të drejtohet dhe të incizojë hapësira të cilat janë relevante për sigurimin e mbrojtjes, por jo edhe hapësira përreth të cilat konsiderohen si private (tualetet, kuzhinat, dhomat e pushimit, dhomat e zhveshjes etj.). Në këtë drejtim, MPN-ja kërkoi ndryshimin e disa neneve të caktuara të Rregullores për mënyrën e zbatimit të video-mbikëqyrjes në INK Burgun Manastir, sipas së cilave rekomandimeve drejtorja e burgut veproi në mënyrë përkatëse dhe të njëjtat i zbatoi⁴³.

Gjithashtu, MPN-ja zhvilloi bisedë me një grup personash të dënuar me përkatësi etnike romë në Burgun Strumicë, të cilët u ankuan për keqtrajtim dhe degradim nga persona konkret të punësuar në shërbimin e sigurimit. Në lidhje me këtë rast, MPN-ja e informoi drejtorinë e burgut, sa u përket ankesave për keqtrajtim fizik nga persona konkret të punësuar në shërbimin e sigurimit, me ç'rast drejtorja u dha përgjigje se kundër një zyrtari është në rrjedhë procedura disiplinore për shkak të akuzave për keqtrajtim fizik, ndërsa për personin tjetër deri më tani nuk kishte lloj të tillë të ankesave të parashtruara nga personat e dënuar.

B.4. Evidenca dhe regjistrat

Konkluzion i përgjithshëm, për institucionet ndëshkuese-korrektuese, të cilët u vizituan gjatë vitit 2012, është se udhëheqja e librave dhe regjistrave nuk është e unifikuar. Gjendja e këtyre, sipas MPN-së, është shqetësuese dhe konsideron se përmbytja dhe mënyra e udhëheqjes së librave, regjistrave dhe evidencave në institucionet ndëshkuese-korrektuese duhet së shpejti të rregullohen nga ana e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë.

Kryesisht, gjatë realizimit të vizitave MPN-ja ka bërë kontroll në disa regjistra të burgjeve, me zgjidhje personale edhe atë gjatë secilës vizite individuale më së paku në dy nga librat/regjistrat në vijim:

- Libër për dënimet e shqiptuara disiplinore,
- Libër për përdorimin e mjeteve të detyrimit mbi personat e dënuar ose të paraburgosur,
- Libër për dërgimin/referimin e personave të dënuar,
- Libër për evidencën e kontrolleve të kryera dhe
- Libër për ankesa dhe parashtresa nga personat e dënuar.

MPN-ja zbatoi kontroll në regjistrat për dënimet e shqiptuara disiplinore, me ç'rast konstatoi se në mënyrë përkatëse është evidentuar numri rendor, emri dhe mbiemri i personit të dënuar, lloji i masës së shqiptuar disiplinore dhe kohëzgjatja e masës. MPN-ja, gjithashtu, konsideron se gjithmonë në këtë regjistër duhet të regjistrohët edhe zyrtari, me emër dhe mbiemër, i cili e ka dhënë propozimin për ngritjen e procedurës disiplinore kundër personit të dënuar. MPN-ja konstatoi se gjatë evidentimit të të dhënave në këtë regjistër përdoret korrektori dhe konsideron se i njëjti mund lehtë të keqpërdoret (kjo u konstatua në Burgun Manastir). Në këtë drejtim, MPN-ja kërkoi që të dhënat e evidentuara në mënyrë të gabuar të fshihen me një vizë, me çka

⁴¹ „Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 07/2005, 103/2008, 124/2010 dhe 135/2011.

⁴² Ky doracak është i publikuar nga Drejtorja për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe projekti është i financuar nga BE-ja.

⁴³ Në përputhje me të dhënen e marrë në përgjigjen e drejtorisë së burgut Manastir.

nga njëra anë vihet në dukje pavlefshmëria e asaj të dhëne, ndërsa nga ana tjetër kjo e dhënë do të jetë qartë e lexueshme. Gjithashtu, në disa INK, MPN-ja konstatoi edhe udhëheqje jo efikase të këtij libri nga ana e zyrtarëve (p.sh., ENK Strugë). MPN-ja konsideron se shërbimet e burgjeve duhet me vëmendje më të madhe dhe në kohë ta udhëheqin dhe plotësojnë librin për dënimet e shqiptuara disiplinore.

MPN-ja gjatë disa vizitave sugjeroi se në librin për përdorimin e mjeteve të detyrimit duhet të shënohet çdo përdorim i tyre, duke përfshirë edhe lidhjet me pranga për kohë të shkurtër, si dhe shoqërimin me pranga. MPN-ja konstatoi se në këtë libër nuk regjistrohet përdorimi i mjetit të detyrimit "ndarje" – ndarja si një mjet detyrimi duhet gjithmonë të regjistrohet në mënyrë përkatëse në regjistrin përkatës, ndërkaq MPN-ja në mënyrë shtesë konsideron se kohëzgjatja e kësaj ndarjeje duhet të kufizohet në kohën domosdoshmërisht të nevojshme për realizimin e qëllimit të kësaj ndarjeje.

MPN-ja konstatoi se në Burgun Tetovë dhe ENK Strugë nuk udhëhiqet evidencë e veçantë (libër) për ankesa, të cilat personat e dënuar ia drejtojnë udhëheqjes së institucionit⁴⁴, por e njëjta regjistrohet si kërkesë deri në dosjet e tyre individuale dhe nëpërmjet sektorit për risocializim i dorëzohet ekipit udhëheqës. Përkundër praktikës së ENK Strugë, në shumicën e INK-ve udhëhiqet një regjistër i veçantë për parashtrësia dhe ankesa të parashtruara nga personat e dënuar.

MPN-ja u rekomandoi institucioneve ndëshkuese-korrektuese, që çdo faqe e regjistrave dhe evidencave të burgjeve ta përmbajnë vulën e INK-it dhe datën, që paraqet një masë shtesë për mbrojtje nga keqpërdorimet e mundshme e të dhënave që regjistrohen në këtë libër.

MPN-ja e përhëndet udhëheqjen e librit të veçantë të evidentimit të personave të paraburgosur mbi të cilët është përdorur forcë nga Ministria e Punëve të Brendshme gjatë arrestimit. MPN-ja hasi në një praktikë të këtillë gjatë vizitës së Burgut Tetovë dhe konsideron se e njëjta është në drejtim të identifikimit të rasteve të mundshme të veprimit të parregullt dhe joprofesional policor.

Konkluzion i përgjithshëm është se dosjet profesionale dhe fletët personale në INK kryesisht udhëhiqen në mënyrë të rregullt dhe në nivel të kënaqshëm nga ana e evidencës amë dhe sektorit për risocializim. Në të njëjtat janë regjistruar të gjitha të dhënat për personat e dënuar, për trajtimin dhe progresin e tyre, ndërsa ndaj fletëve bashkëngjiten dokumentet përkatëse (autobiografia dhe të dhënat për personin e dënuar, dokumentet për progresin/riprogresin, instrumenti për vlerësimin e rrezikut, anamneza kriminele, aktvendimi me klasifikim, aktvendimi për vuajtjen e masës së izolimit me mendimin e mjekut, raportet nga bisedat e zhvilluara individuale etj.).

MPN-ja konstatoi se vetëm një pjesë e INK-ve kanë përpiluar dhe miratuar një akt i veçantë (rregullore) për mënyrën e kryerjes së video-mbikëqyrjes, që si obligim del nga Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.

⁴⁴ Në përgjigjet, sipas raporteve të veçanta MPN-ja, u njoftua se në Burgun Tetovë është filluar me udhëheqjen e një libri ankësash, duke filluar nga muaji shkurt i vitit 2012, ndërsa në INK Strugë udhëhiqet një libër i veçantë nga ana e shërbimit amë, ndërsa në përputhje me Ligjin për procedimin sipas parashtrësive dhe propozimeve është formuar edhe një komision i veçantë për procedimin sipas parashtrësive të paraqitura nga personat e dënuar. Megjithatë, MPN-ja gjatë vizitës dhe kontrollit të kërkuar në këtë regjistër ishte lajmëruar edhe se librat e tilla nuk udhëhiqen në burgjet e treguara.

B.5. Përgjigjet nga institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve pranë Ministrisë së Drejtësisë së RM-së

Në përputhje me nenin 3 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Avokatin e Popullit, zyrtarët e organeve, organizatat dhe institucionet ku liria e lëvizjes është e kufizuar, janë të obliguar të veprojnë sipas sugjerimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ndërsa për veprimin ta njoftojnë më së voni brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së raportit të veçantë.

Drejtoritë e institucioneve, në pjesë më të madhe, pajtohen me gjendjet e konstatuara negative dhe rreziqet e identifikuar dhe e njoftojnë Avokatin e Popullit – Mekanizmin Parandalues Nacional, për masat që do të ndërmerren në drejtim të largimit të mangësive dhe përmirësimit të gjendjeve.

Avokati i Popullit për disa përgjigje të marra kërkoi edhe shpjegime ose informacione shtesë për çka pranoi përgjigje përkatëse. Shkallën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, Avokati i Popullit – MPN e mat përmes realizimit të vizitave të realizuara me qëllim të ri-kontrollit, të cilat fokusohen kryesisht në përcaktimin e masave të ndërmarra, në përputhje me përgjigjet e marra nga drejtoritë e institucioneve dhe Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve.

Në shumicën e përgjigjeve, MPN-ja u njoftua se në ato INK ku kishte pasur ankesa në lidhje me sjelljen e shërbimeve ndaj personave të dënuar dhe të paraburgosur, kryesisht nga të punësuarit në sektorin e sigurimit, drejtoritë e institucioneve kanë mbajtur takime pune me të punësuarit në këtë sektor, nëpërmjet të cilave ua kanë përkujtuar të punësuarve trajtimin profesional dhe korrekt me personat e dënuar, në përputhje me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve, kodeksin etik, si dhe ndalimin e torturës ose trajtimin tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues me personat e privuar nga liria, si dhe i kanë paralajmëruar për ndëshkim në rast të kryerjes së një vepre të tillë. MPN-ja konsideron se është i nevojshëm një trajnim shtesë i të punësuarve në Sektorin e Sigurimit për trajtimin me personat e privuar nga liria.

Personat e dënuar në disa institucione, në përputhje me përgjigjet e marra, janë inkurajuar nga ana e organeve kompetente që çdo dhunë dhe degradim ta paraqesin te personi përgjegjës për parashtrësia dhe ankesa në drejtim të ndërmarrjes së hetimit përkatës⁴⁵.

MPN-ja ka vërejtur edhe disa mospajtime të shprehura me rekomandimet e dhëna, për të cilat në mënyrë shtesë do të bisedohet me drejtoritë e INK-ve përkatëse në drejtim të gjetjes së një zgjidhje përkatëse, duke respektuar para se të gjithash sugjerimet dhe rekomandimet e dhëna nga ana e MPN-së. Megjithatë, në përgjigjet e pranuar, MPN-ja vërejtë edhe mospranim të rekomandimeve të caktuara të cilët ishin dhënë në drejtim të realizimit në praktikë të zgjidhjeve të caktuara ligjore dhe nënligjore. Kështu p.sh., drejtori i Burgut Manastir nuk pajtohet me vendosjen e kutisë, nëpërmjet së cilës personat e dënuar do të parashtrëjnë kërkesë për kontroll mjekësor, e që njëkohësisht paraqet detyrim që del nga neni 42, paragrafi 3 i Rendit të shtëpisë për personat e dënuar.

Në një shembull tjetër, MPN-ja, gjithashtu, hasi në mospajtime të caktuara në pjesën e përdorimit të "ndarjes" si një mjet detyrimi, për çka MPN-ja konsideron se duhet në mënyrë përkatëse të evidentohet në librin për përdorimin e mjeteve të detyrimit, e përcaktuar me një akt me shkrim, me çka do t'i mundësohet personit të dënuar e drejta për të parashtruar parashtrësia përkatëse ligjore. Drejtoria e INK Shtip nuk u pajtua me këtë rekomandim dhe në përgjigje ka cekur se vepron në përputhje me detyrimet që dalin nga Udhëzimi për kushtet dhe mënyrën e përdorimit të mjeteve

⁴⁵ Përgjigjen e këtillë MPN-ja e pranoi nga Burgu Strumicë.

të detyrimit nga ana e pjesëtarëve të Sektorit të Sigurimit në INK dhe IEK. Megjithatë, MPN-ja gjatë hartimit të rekomandimit thirret në obligimet që dalin nga Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, akti nënligjor dhe rekomandimet e KPT-it, duke pasur parasysh se “ndarja” mund të realizohet në kohëzgjatje prej tri ditësh.

Avokati i Popullit – MPN u njoftua nga ana e Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve pranë Ministrisë së Drejtësisë, për planet e rikonstruksionit dhe ndërtimit të reparteve të reja në Burgun Shkup dhe ENK “Idrizovë” – Shkup.

C. SPITALET PSIKIATRIKE

Avokati i Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional, në vitin raportues ka realizuar tri vizita të rregullta të paparalajmëruara në spitalet psikiatrike: Shkup, Demir Hisar dhe Negorcë, i shoqëruar nga bashkëpunëtori i jashtëm-psikiatri, në përputhje me Memorandumin për bashkëpunim të nënshkruar midis Avokatit të Popullit të RM-së dhe Shoqatës së Psikiatërve të RM-së. Qëllimi i vizitave, në përputhje me Protokollin Fakultativ ishte identifikimi i rreziqeve me qëllim të parandalimit të torturës ose një llojeve tjera të trajtimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose degradues, përmes kontrollit të kushteve materiale në institucionet publike shëndetësore, trajtimin e pacienteve, realizimin e të drejtave të garantuara me Ligjin për shëndetëtorë, Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të pacienteve dhe aktet e tjera ligjore, si edhe udhëheqjen e evidencave në lidhje me këtë kategori personash.

Gjatë vizitave u zhvilluan biseda me më shumë pacientë, të cilët qëndrojnë në këto institucione, ndërsa ekipi i MPN-së, i shoqëruar nga bashkëpunëtori i jashtëm, realizoi një takim dhe bisedë me më shumë të punësuar, të cilët në momentin e vizitës ishin në vendet e punës (mjekë-specialistë, infermiere, teknikë, ndihmësmjek etj.). Njëkohësisht, u kontrolluan edhe regjistrat për fiksimit, fletët e pranimit, fletët (planet) për trajtimin individual dhe më shumë dosje të personave të vendosur në institucionet psikiatrike. Vizitat në spitale u realizuan në bashkëpunim të plotë me institucionet dhe të punësuarit, me ç'rast ekipi i MPN-së pati kontroll pa pengesë në vendet e vendosjes, si dhe liri të plotë në zgjedhjen e personave me të cilët zhvilloi bisedë.

Trajtimi i pacienteve

Gjatë vizitës në **Spitalin Psikiatrik Shkup**, MPN-ja në bisedat me pacientët nuk morri ankesa për torturë dhe trajtim mizor, ndërsa sjellja e personelit u vlerësua si korrekte. Megjithatë, në bisedën me një prind të pacientit të vendosur, MPN-ja u informua për trajtim të mundshëm çnjerëzor dhe/ose degradues, kështu që gjatë pranimit në spitali pacienti është trajtuar në mënyrë të ashpër dhe degraduese nga ana e 2 personave (me supozim sanitar), ndërsa gjatë gjithë kohës ai ka qenë i lidhur me pranga mbrapa kurrit. Njëkohësisht, edhe gjatë natës ka qenë i vendosur në dhomën e fiksimit, ku ka qenë i çmobilizuar fizikisht duke përdorur rripa lëkure, megjithatë në të njëjtën dhomë njëkohësisht ishin të vendosur edhe dy persona të tjerë të cilët nuk kanë qenë të çmobilizuar (të fiksuar) për krevetet. Mënyra e këtillë e fiksimit ka shkaktuar shfaqjen e frikës tek prindërit për fëmijën e tyre, më saktë ka ekzistuar mundësia që ai të sulmohet nga dy personat e tjerë, të cilët gjithashtu kanë qenë nën mbikëqyrje të përforcuar për shkak të gjendjes së shqetësimit tek të njëjtët. Në lidhje me informacionet e marra MPN-ja kërkoi nga drejtori i spitalit psikiatrik të përpilojë një protokoll për mënyrën e referimit (transferimit) të personave nga njëri në repartin tjetër, me ç'rast do të kihet kujdes për integritetin e tyre personal dhe gjendjen e tyre shëndetësore, si dhe derisa një person është i çmobilizuar fizikisht në dhomën e fiksimit, në të njëjtën hapësirë në asnjë rast të mos vendosen, në të njëjtën kohë, edhe persona të tjerë që janë nën mbikëqyrje të përforcuar dhe të cilët nuk janë të fiksuar.

Në **Spitalin Psikiatrik Demir Hisar**, MPN-ja në bisedë me pacientët nuk mori ankesa për torturë dhe trajtim mizor, ndërsa sjellja e personelit u vlerësua si korrekte. U konstatua se në këtë spital nuk përdoret terapia elektrokonvulsive, e cila konsiderohet si një metodë e tejkaluar dhe çnjerëzore, e cila shkakton edhe dhimbje nëse nuk përdoret me anestezi.

MPN-ja edhe në **Spitalin Psikiatrik Negorcë** në bisedë me pacientët nuk mori ankesa për torturë dhe trajtim mizor, ndërsa sjellja e personelit në masë të madhe u vlerësua si korrekte, përveç në disa raste ku pacientët u ankuan ndaj sanitarëve, përkatësisht se të njëjtit u kërcënohen kur refuzojnë ta marrin terapinë e përshkruar. Në këtë spital, MPN-ja hasi gjendje të përdorimit të një shtrati nga më shumë persona, d.m.th., konstatoi se jo çdo pacient kishte shtrat të veçantë (krevat) në pavijonin kronik B, ndërsa vendosjen e tyre në spital e vlerëson si trajtim ndëshkues dhe çnjerëzor. Edhe pse gjendja e mbipopullimit është për shkak të procesit të rinovimit, i cili zhvillohet në spitalin psikiatrik, megjithatë për MPN është e palejueshme që më shumë persona të vendosen në një krevat. Në këtë mënyrë shkelet edhe Ligji për shëndet mendor, i cili parashikon se "personi, dinjiteti dhe privatësia e secilit person me sëmundje mendore duhet të respektohet"⁴⁶, si dhe se "personi me sëmundje mendore ka të drejtë për një trajtim të njëjtë gjatë kujdesit, mjekimit dhe rehabilitimit sikurse edhe personat e sëmurë nga sëmundjet e tjera"⁴⁷.

Hospitalizimi i detyruar dhe vullnetar

Mënyra e hospitalizimit mund të realizohet në bazë të detyruar dhe vullnetare. Në përputhje me Ligjin për procedurë jashtëgjyqësore kur pranohet një person me pëlqim duhet të jepet një deklaratë me shkrim para dy dëshmitarë të rritur që dinë shkrim-lexim, të cilët nuk janë të punësuar në institucionin publik shëndetësor dhe nuk janë të afërm sipas gjakut me personin që pranohet. Në **Spitalin Psikiatrik Negorcë** personat që janë të hospitalizuar në mënyrë të detyruar, vendosen në departamentin urgjent akut. Spitali bashkëpunon me Gjykatën Themelore Gjevgjeli për vendosjen për hospitalizim të detyruar. Ligji për procedurë jashtëgjyqësore, neni 59 përcakton se "Kur organizata shëndetësore do të pranojë një person me sëmundje mendore pa pëlqimin e tij ose pa vendimin e gjykatës, personi i autorizuar i institucionit publik shëndetësor është i detyruar brenda 48 orëve të paraqes raport deri te gjykata". Më tej, neni 65 përcakton se "Gjykata është e detyruar t'i shqyrtojë të gjitha rrethanat me rëndësi për miratimin e vendimit dhe ta dëgjojë personin mbi të cilin bëhet kontrolli, nëse kjo është e mundur dhe nëse nuk ndikon negativisht në shëndetin e tij". Gjatë vizitës në spitalin psikiatrik ishin të vendosur gjithsej 217 pacientë, ndërsa në përputhje me informacionet e marra të gjithë ishin hospitalizuar në mënyrë vullnetare, përveç personave të cilëve u është shqiptuar masa e sigurisë.

Gjatë vizitës në repartin kronik MPN-ja mori ankesë nga një person se nuk i lejohet ta lëshojë spitalin. Me kërkesë të ekipit të MPN-së, personeli mjekësor informoi se personi është hospitalizuar në mënyrë vullnetare dhe se i njëjti është vendosur në repartin kronik, por vet personi ka treguar se atë e ka sjellë policia dhe se nuk ka nënshkruar pëlqim për praninë në spital. Gjatë kontrollit në dokumentacionin, MPN-ja konstatoi se për të njëjtin person nuk ka pëlqim me çka parashtrrohet pyetja nëse i njëjti është hospitalizuar në mënyrë vullnetare, por njëkohësisht në dosje nuk kishte asnjë dokument përkatës gjyqësor për hospitalizimin e tij të detyruar. Prandaj, gjatë kontrollit të dosjes, MPN-ja nuk mundi të përcaktojë se në cilën mënyrë është hospitalizuar personi, ndërsa sipas informacioneve të dorëzuara, personit nuk i ishte caktuar kujdestar, kështu që është e nevojshme që Qendra për punë sociale në mënyrë shtesë ta përcaktojë. MPN-ja konstatoi një dosje të e cila nuk ishte në rregull, gjë që hap mundësinë nga keqpërdorimi i hospitalizimit të pacientëve – nëse të njëjtët refuzojnë të nënshkruajnë pëlqimin, institucioni është i detyruar për këtë ta njoftojë gjykatën dhe sipas vlerësimit të kërkojë hospitalizim të detyruar. Çdo ndalim në spital, për të cilin nuk ka pëlqim nga ana e pacientit, duhet në mënyrë të detyrueshme të bazohet në vendim gjyqësor, ndërsa gjatë mjekimit vullnetar spitali është i detyruar ta respektojë parimin e vullnetarizimit dhe t'i mundësojë personit të largohet nga institucioni sipas

⁴⁶ Neni 7 i Ligjit për shëndet mendor.

⁴⁷ Neni 8 i Ligjit për shëndetin mendor.

vullnetit të tij.

Njëkohësisht, edhe në **Spitalin Psikiatrik Demir Hisar**, MPN-ja konstatoi një rast të një pacienti i cili ka qenë i hospitalizuar në mënyrë vullnetare dhe të cilit krahas mendimit pozitiv të mjekut, nuk i lejohej të largohet në mënyrë vullnetare nga spitali⁴⁸, me çka në mënyrë të drejtpërdrejtë shkelet parimi i vullnetarizmit, si edhe zbatimi i dispozitave të Ligjit për shëndet mendor.

Në **Spitalin Psikiatrik Shkup** u konstatua se nuk zbatohet në praktikë dispozita e nenit 59, paragrafit 2 të Ligjit për procedurë jashtëgjyqësore, më saktë për shkak të zbatimit të vështirë (ose moszbatimit) të kësaj dispozite nuk sigurohen (ose sigurohen vetëm në raste të rralla) dy dëshmitarë të rritur të cilët nuk janë të punësuar në institucionin publik shëndetësor dhe nuk janë të afërm të gjakut me personin që pranohet. Nuk realizohen në praktikë dispozitat e Ligjit për procedurë jashtëgjyqësore në pjesën e hospitalizimit të detyruar, më saktë edhe më tej vazhdon problemi me sigurimin e aktvendimit nga gjykata në afatin e paraparë ligjor prej 3 ditë.

MPN-ja në këtë domen, tek **Institucioni Psikiatrik Shkup** shprehu edhe shqetësimin për të ashtuquajturit "raste të mëparshme gjyqësore", të cilët, duke pasur parasysh momentin social, stigmën dhe mospranimin nga ana e familjes dhe mjedisit, si edhe hospitalizimin e tyre afatgjatë, vazhdojnë të jetojnë në repartin e spitalit si persona të sëmurë kronik të cilët vendosen në bazë vullnetare.

Fiksimi (çmobilizimi fizik)

Në **Spitalin Psikiatrik Shkup** zbatohet një protokoll i veçantë me të cilin është e përpunuar politika dhe rregullat për ndërmarrjen e masave për kufizimin (fiksimin) e pacientëve dhe mjeteve që duhet të përdoren gjatë fiksimit.

Në librin e fiksimit në repartin urgjent mashkullor nuk regjistrohet kohëzgjatja e çmobilizimit fizik, por vetëm fillimi i fiksimit, ndërsa për kohëzgjatjen e fiksimit nuk ka prani të vazhdueshme të personit mjekësor në vet hapësirën, por mbikëqyrja bëhet përmes dritares së dhomës së infermiereve dhe teknikëve. MPN-ja konstatoi se një listë e veçantë për dekompenzimin akut psikik nuk ishte plotësuar për pacientin e ri, i cili ka qenë i çmobilizuar fizikisht gjatë natës. Në repartin urgjent mashkullor ka një praktikë derisa një person është i çmobilizuar fizikisht në dhomën e fiksimit, në të njëjtën hapësirë të vendosen njëkohësisht edhe persona të tjerë që janë nën mbikëqyrje të përforcuar, ndërkaq të cilët nuk janë të fiksuar, gjë që paraqet rrezik për sigurinë personale të personit.

Në **Spitalin Psikiatrik Negorcë** zbatohet një protokoll i veçantë për kufizim fizik (fiksimit) të pacientëve dhe mjeteve që duhet të përdoren gjatë fiksimit fizik. Në librin e evidencave të fiksimit fizik në disa raste nuk kishte nënshkrim nga mjeku, i cili ka qenë përgjegjës për fiksimin. Për fiksimi përdoren lenta pëlhure që nuk janë standarde dhe janë të përpunuara me dorë nga vet spitali, dhe në këtë pjesë MPN theksoi shqetësim për sigurinë e pacientit dhe potencoi se është nevojshme të përdoren mjete të cilat i plotësojnë standardet ndërkombëtare.

Në **Spitalin Demir Hisar** zbatohet, gjithashtu, një protokoll i veçantë për kufizimin (fiksimin) e pacientëve dhe mjeteve që duhet të përdoren gjatë fiksimit. MPN-ja gjatë vizitës konstatoi se në asnjë nga repartet nuk ka hapësirë të veçantë për fiksimit fizik. Njëkohësisht, ekipi i MPN-së mori informacion se gjatë kohëzgjatjes së fiksimit nuk ka prani të vazhdueshme të ndonjë anëtari të personelit në vet hapësirën. Trajtimi i tillë nuk është në përputhje me protokollin e caktuar, ku parashihet që një anëtar i personelit të jetë i pranishëm në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim për t'i siguruar

⁴⁸ Gjatë kontrollit në dosjen mjekësore, ekipi i MPN-së konstatoi se mjeku, në përputhje me nenin 24, paragrafin 1 të Ligjit për shëndet mendor, ka dhënë mendim se gjendja me shëndetin mendor të personit është përmirësuar, se personi i njëjtë të mund të drejtohet në një trajtim dhe kujdes të mëtejshëm në bashkësi, por njëkohësisht nga ana e personelit mjekësor u konfirmua se i njëjti pritet t'i dorëzohet një anëtar i familjes së tij.

mbikëqyrje mjekësore personit që është i fiksuar. Në fletët për evidentimin e fiksimit fizik në disa raste nuk ishte e regjistruar ora, më saktë koha e fiksimit.

Vendosja dhe hapësira të tjera në institucionet psikiatrike

Në **Spitalin Psikiatrik Shkup** u konstatua se kushtet materiale dhe gjendjet nuk i plotësojnë standardet e dëshiruara: pjesa më e madhe e objekteve janë të vjetra dhe të pa rinovuara, nyjet sanitare dhe banjat janë pjesërisht të shkatërruara, të papastra dhe nuk janë të përshtatura për këtë kategori personash, krevatet dhe dyshekët e fjetjes në masë të madhe janë të vjetra dhe të shkatërruara. Veçanërisht është shqetësuese gjendja me të ashtuquajturin "ish repartin e pestë" dhe i njëjti kërkon një reagim të menjëhershëm. Në këtë spital ka filluar procesi i rinovimit, por përparimi në ndërtimin e objekteve të reja nuk është në nivelin e duhur dhe zhvillohet shumë ngadalë. Për shkak të punimeve të vazhdueshme të ndërtimit u konstatua mbipopullim i kapaciteteve në disa nga repartet, sidomos në repartin për mjekim të zgjatur, reabilitim dhe risocializim dhe repartin për mjekim të zgjatur dhe përkujdes. Në repartin e psikiatrisë urgjente ishin vendosur kategori të ndryshme personash: pacientë të shqetësuar dhe të dhunshëm, nga njëra anë edhe persona me gjendje kronike afatgjate, nga ana tjetër me gjendje më stabile. Pacientët me gjini të ndryshme në spital vendosen në hapësira të ndara që është pozitive në lidhje me mënyrën e vendosjes së personave me sëmundje mendore.

Në **Spitalin Psikiatrik Negorcë**, në masë më të madhe, kushtet në repart i plotësojnë standardet e përcaktuara ndërkombëtare. Temperatura dhe lagështia ishin brenda parametrave të lejuar, ndërsa në shumicën e dhomave në repartin akut, kronik dhe repartin për trajtim të keqpërdorimit dhe varësive nga alkooli nuk u vërejt mbipopullim. Në dhoma janë të vendosur trupa ngrohës, ndërsa shtretërit kishin shtroje. Në repartet e rinovuara janë të vendosur dollapë për gjëra personale në dhoma, ndërkaq është pajisur edhe nga një dhomë dite në të gjitha repartet ku zbatohet komuniteti terapeutik. Në repartin gjyqësor gjendet një dhomë e gjerë dite me tavolina dhe karige të reja, TV aparat, si edhe një trup për ftohje (ventilator) për periudhën e verës. Në përbërje të secilit repart gjendet një oborr i vogël, por njëkohësisht të drejtën qëndrimit në ambient të hapur pacientët mund ta përdorin edhe në oborrin e madh, në të cilin vërehej një gjendje e relaksuar dhe mundësi për disa aktivitete sportive të pacientëve. Gjithashtu, u konstatua se kushtet në repartin B kronik nuk i plotësojnë standardet minimale, nuk posedon numër të mjaftueshëm të krevateve për pacientët e pranuar, ndërsa tualetet u gjetën të parregulluara dhe dobët të mirëmbajtura.

Kushtet në repartin gjyqësor të **Spitalit Psikiatrik Negorcë**, janë më të këqija në krahasim me repartet e tjerë, në dysheme është i vendosur një laminat i vjetër, dollapë të vjetër për ruajtjen e gjërave personale, ndërsa dhomat ishin të ngjyrosura me ngjyrë hiri, me çka fitohet një përshtypje për hapësira të errësuara dhe pa dritë të mjaftueshme. Në këto hapësira nuk janë të plotësuara në tërësi standardet ndërkombëtare, përkatësisht u konstatua se ka mbipopullim në një pjesë të dhomave në repartin gjyqësor.

Në **Spitalin Psikiatrik Demir Hisar** pjesërisht është bërë rinovimi i kapaciteteve të vendosjes, më saktë një pjesë e reparteve i plotësojnë standardet për vendosjen e pacientëve, në përputhje me madhësinë, depërtimin e dritës ditore, ventilimin si edhe pajisjen me materiale shtesë (reparti për tretman të abuzimit dhe varësive nga alkooli, reparti akut). Gjatë kontrollit të dhomave të repartit akut femëror, MPN-ja konstatoi se dhomat janë të pajisura me krevate me shtroje përkatëse ndërsa shumica e krevateve ishin me dyshekë të rinj. Dhomat kanë një dritë të mjaftueshme ditore, në to janë të vendosur trupa ngrohës (radiatorë), ndërsa dyshemeja në këto dhoma është shtruar me shtresë gome. Megjithatë, në një pjesë të reparteve u konstatua se nuk i plotësojnë standardet e përcaktuara, një pjesë e objekteve janë të vjetra dhe të pa rinovuara, nyjet sanitare dhe banjat janë pjesërisht të shkatërruara, të papastra

dhe të papërshtatshme për këtë kategori personash. Në këtë spital reparti gjyqësor nuk është në përdorim, për shkak se i njëjti ka qenë i kapluar nga zjarri dhe ende nuk është rinovuar. Personat, përkohësisht janë vendosur në repartin e mëparshëm kronik për meshkuj për të cilin Komiteti Evropian ka dhënë rekomandim të mbyllet dhe të mos përdoret, ndërsa disa personave të cilëve u është dhënë kjo masë sigurie, si edhe personave që u është dhënë masa e burgimit, vendosen edhe në repartet e tjerë të institucionit. Po ashtu, në shumicën e reparteve vërehet edhe gjendje e keqe e nyjave sanitare. Tualetet në repartin kronik për meshkuj nuk janë të rinovuara dhe të njëjtët janë në një gjendje të palakmueshme, me nyje sanitare të pa rinovuara që nuk janë të përshtatura sipas nevojave të kësaj kategorie të personave.

Në **Spitalin Psikiatrik Shkup**, u konstatua se pacientëve u mundësohet të ndjekin programe televizive në hapësirat e qëndrimit ditor në përbërje të reparteve spitalore.

Në të gjitha institucionet psikiatrike ekzistojnë reparte të veçanta për terapi pune ku pacientët përfshihen sipas dëshirës së tyre. Por, MPN-ja konstatoi se vetëm një pjesë e vogël e personave të vendosur dhe të hospitalizuar në spital janë të përfshirë në terapinë e punës. Pikë së pari, gjendja e këtyre është rezultat i natyrës dhe shkallës së zhvillimit të sëmundjes, megjithatë, MPN-ja konsideron se e njëjta në masë të madhe varet edhe nga shkalla e motivimit të personave nga ana e personelit. Në përbërje të këtij reparti në Shkup dhe Demir Hisar gjendet një palestër (fitnes), ping-pong dhe dhoma për terapi pune.

MPN-ja ka bërë kontroll në repartin e terapisë së punës dhe në **Spitalin Psikiatrik Negorcë**, që është i vendosur në një ndërtesë të veçantë. Në të njëjtën ndërtesë janë vendosur 3 punëtorë social, të cilët u ndihmojnë pacientëve në dërgimin e kërkesave për ndihmë sociale deri te qendrat e punës sociale. Një nga hapësirat përdoret për terapi pune në të cilën pacientët kalojnë kohën e tyre të lirë, por u vërejt se në këtë spital nuk ka një palestër të veçantë për aktivitete sportive të personave të vendosur në institucionin psikiatrik.

Në **Institucionin Psikiatrik Shkup** kuzhina nuk është e rinovuar, megjithatë është në një gjendje të mirë higjienike, ndërsa në përbërje të së njëjtës ka edhe furrë. Në **Institucionin Psikiatrik Demir Hisar** kuzhina është e re, e pajisur me veglat e nevojshme të kuzhinës dhe gjatë vizitës së MPN-ja konstatoi se e njëjta është e pastër dhe e rregulluar.

Dhoma e ngrënies dhe kuzhina janë të rinovuara në tërësi në **Negorcë** dhe janë në përbërje të repartit për alkoolizëm dhe sëmundje të varësive. Në dhomën e ngrënies janë të vendosura tavolina dhe karrige të reja, pllaka në dyshemenë dhe në muret dhe e njëjta u has e rregulluar dhe e pastër. Në dhomën e ngrënies ka një numër të mjaftueshëm të veglërisë për haje, si edhe mjete për mbajtjen e higjienës. Kuzhina është e pajisur në mënyrë bashkëkohore me makinat e nevojshme për punë, por MPN-ja nuk kishte mundësi të merr informacion nga të punësuarit për rezervat e ushqimit të cilat i ka në dispozicion.

Trajtimi dhe terapia e pacientëve

Gjatë vizitave të realizuara, MPN-ja konstatoi se në **Spitalin Psikiatrik Shkup** për secilin pacient në mënyrë përkatëse përgatitet një plan individual për trajtim dhe rehabilitim. Në **Spitalin Psikiatrik Demir Hisar** në mënyrë të rregullt regjistrohen historitë e pacientëve, në lidhje me ndjekjen e gjendjes psikike dhe gjendjes së përgjithshme, mjeku këtë e bën një herë në muaj, nëpërmjet rrjedhjes së ngjarjeve, regjistrimeve në dosje për gjendjen momentale, me ç'rast vihet në pah kronologjia e vet pacientit, ndërkaq sipas nevojës dhe në kuadër të spitalit ka laborator në të cilin mund të bëhen testime laboratorike rutine.

Nga kontrolli në hapësirat e **Spitalit Psikiatrik Negorcë** u konstatua se çdo

pacient ka planin e vetë për trajtim. Udhëhiqet një listë për sjelljen e pacientit në 10 ditët e para nga pranimi dhe në të regjistrohet sjellja, ushqimi, terapia, fjetja. Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit është 1-1,5 muaj, ndërsa më pas nëse gjendja përmirësohet pacientët shkojnë në shtëpi ose transferohen në një repart tjetër. Në momentin e kontrollit në historitë e sëmundjes, me zgjedhje të rastësishme, MPN-ja konstatoi se te disa ishte e pranishme vetëm historia e sëmundjes nga pranimi i fundit, dhe jo edhe historitë nga pranimet e mëparshme të personit të njëjtë. Historitë e pacientëve janë gjithëpërfshirëse, të kuptueshme, të besueshme, gjatë pranimit pacienti kontrollohet në mënyrë të rregullt, ndërsa gjatë përcaktimit të terapisë kihet kujdes për moshën e pacientit. Për personin që ishte i sëmurë nga tuberkuloza në IPP Negorcë u konstatua se janë ndërmarr të gjitha masat për kujdes dhe trajtim nëpërmjet institucioneve përkatëse kompetente për llojin e këtyre të sëmundjeve. Medikamentet ruhen në mënyrë përkatëse dhe njëkohësisht ka edhe një dëshmi me shkrim për trajtimin e pacientëve dhe dozave të ilaçeve.

E drejta e pacientëve

Në favor të të drejtave të pacientëve në institucionet psikiatrike MPN vëmendje e veçantë iu përkushtua të drejtës së informimit, të drejtës së personit, dinjitetit dhe privatësisë së personave me sëmundje mendore, mbrojtjes nga çdo formë keqtrajtimi, degradimit dhe keqtrajtimit, sigurimit të mjedisit jetësor human dhe të sigurt, të drejtës së punës, të drejtës së vendosjes në hapësira të ndara nga personi i gjinisë së kundërt, të drejtës së kontaktit me botën e jashtme (telefon dhe postë), të drejtës për të pasur gjëra për përdorim personal dhe të drejtës për shfrytëzimin e mungesës gjatë vikendit.

Gjatë përcaktimit të këtyre të drejtave u konstatua se në pjesën më të madhe të reparteve të **Institucionin Psikiatrik Shkup** ishte theksuar Rendi i shtëpisë së aktiviteteve, ndërkaq në mënyrë përkatëse ishte vendosur edhe një kuti për ankesa dhe lavdërime, ndërsa gjendje e ngjashme u has edhe në **Spitalin Psikiatrik Negorcë** ku ishte theksuar Rendi i shtëpisë së aktiviteteve, si dhe ishte vendosur një kuti për ankesa dhe lavdërime. U konstatua se e drejta e sigurimit të mjedisit të sigurt dhe human realizohet në këtë institucion, ndërkaq ishte vendosur edhe një platformë hyrëse para hyrjes së repartit të psikogjeriatriisë. Pacientët posedojnë veshje të tyre dhe të njëjtit nuk mbajnë pizhame derisa janë të vendosur atë institucionin psikiatrik. Edhe në **Institucionin Psikiatrik Demir Hisar** në shumicën e reparteve ishte theksuar Rendi i shtëpisë, ndërkaq në mënyrë adekuate ishte vendosur edhe një kuti për ankesa dhe lavdërime.

E drejta e kontaktit me botën e jashtme realizohet në atë mënyrë që personave të vendosur në **Institucionin Psikiatrik Shkup** u lejohet ta përdorin kabinën publike të telefonit të vendosur në portën hyrëse të spitalit. MPN-ja konstatoi se pacientët në mënyrë të papenguar e realizojnë të drejtën e vizitës nga ana e anëtarëve të familjes dhe të afërmve. Në këtë spital u konstatua se e drejta për të poseduar gjëra për përdorim personal nuk realizohet në nivelin e duhur dhe spitali, në përputhje me buxhetin, siguron dhe furnizon vetëm pizhame spitalore dhe veshje të brendshme, ndërsa veshja tjetër dhe këpucët sigurohet nëpërmjet donacioneve.

E drejta e personit, dinjiteti dhe privatësia e personave me sëmundje mendore nuk realizohet në nivelin e kënaqshëm në **Institucionin Psikiatrik Shkup**. D.m.th., në shumicën e reparteve u mor informacioni se personat lahen në banja të pa rinovuara, megjithatë jo gjithmonë respektohet privatësia e tyre, më saktë ndonjëherë lahen së bashku edhe me personat e gjinisë tjetër, me çka shkelet e drejta e privatësisë së pacientëve gjatë përdorimit të të njëjtave. Njëkohësisht, një pjesë e madhe e personave të vendosur në repartet me çrregullim kronik psikotik nuk posedojnë gjëra personale, ndërsa një pjesë e tyre ishin veshur në pizhame spitalore.

Në **Spitalin Psikiatrik Demir Hisar**, MPN-ja konstatoi se pacientëve u

mundësohet të ndjekin programin televiziv në hapësirat e qëndrimit ditor, në përbërje të reparteve spitalore. Njëkohësisht, e drejta e kontaktit me botën e jashtme realizohet në mënyrë që personave të vendosur në institucion u lejohet përdorimi i kabinës publike të telefonit, dhe njëkohësisht në disa reparte pacientët kanë të drejtën e përdorimit të celulareve të tyre. MPN-ja u informua se pacientët në mënyrë të papënguar e realizojnë të drejtën e vizitës nga anëtarët e familjeve dhe të afërmit

Në lidhje me të drejtat që realizohen në **Spitalin Psikiatrik Demir Hisar** u konstatua se pacientëve u lejohen shëtitje në rrethin e spitalit, por edhe jashtë tij, por një pjesë e tyre tregoi se kjo e drejtë u kufizohet gjatë periudhës së dimrit. Në këtë spital u konstatua se shumica e personave të vendosur në repartet për çrregullim kronik psikotik nuk posedojnë gjëra personale dhe një pjesë e tyre ishin të veshur me pizhame spitalore.

Në **Spitalin Psikiatrik Negorcë** u konstatua se e drejta e kontaktit me botën e jashtme realizohet në mënyrë në të cilën personave të vendosur në institucion u lejohet ta përdorin kabinën publike të telefonit të vendosur para kantinës së spitalit. Në përbërje të secilit repart gjendet një hapje e vogël, por njëkohësisht të drejtën e qëndrimit në ambient të hapur pacientët mund ta përdorin edhe në oborrin e madh në të cilin u vërejt gjendje e relaksuar dhe mundësi për aktivitete të caktuara sportive të pacientëve. Njëkohësisht, vërehej se pacientët posedojnë veshjen e tyre personale dhe të njëjtët nuk mbajnë pizhame derisa janë të vendosur në institucionin psikiatrik. Sa i përket të drejtës së personit, dinjitetit dhe privatësisë së personave me sëmundje mendore, MPN-ja u informua se pacientët, në raste të caktuara, lahen së bashku dhe ky informacion u mor nga personeli mjekësor që kujdeset për këtë kategori personash.

Sipas Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës "Ushqimi i pacientëve është një aspekt tjetër sa u përket kushteve të tyre për jetë, të cilave KPT-ja u përkushton një vëmendje të veçantë. Ushqimi duhet të jetë jo vetëm përkatës, nga pikëpamja e sasisë dhe cilësisë, por edhe për pacientët duhet të sigurohet në kushte të kënaqshme. Duhet të ekzistojnë pajisje e domosdoshme që do të mundësojnë ushqimi të jetë i përgatitur në temperaturë përkatëse. Përveç kësaj, aranzhimet për ngrënie duhet të jenë të përshtatshme. Në këtë kontekst duhet të theksohet se mundësia që pacientët t'i realizojnë aktivitetet e përditshme, si ngrënia me pajisje përkatëse dhe ulja në tavolinë, paraqet pjesë integrale nga programet për rehabilitim psiko-social të pacientëve. Sipas kësaj, dukja e ushqimit është një faktor që nuk duhet të neglizhohet. Duhet të merren parasysh edhe nevojat e veçanta të personave me aftësi të kufizuara në lidhje me ushqimin".

Gjatë kontrollit, MPN-ja konstatoi se ekzistojnë kushte përkatëse për servim dhe shërbim të ushqimit në **Spitalin Psikiatrik Negorcë**, ndërsa një pjesë e pacientëve u ankuan për sasinë e vakteve që marrin. MPN-ja, njëkohësisht, ka marrë ankesa nga pacientët për cilësinë e ushqimit, ndërsa nga ana e personelit u vërtetua se jo çdo ditë marrin sallatë ose desert, si pjesë të vaktit. Në kuzhinë nuk ishte theksuar lista e ushqimeve, në nivelin javor.

Në **Spitalin Psikiatrik Shkup** u konstatua se cilësia dhe sasia e ushqimit që u ofrohet pacientëve nuk i plotëson kërkesat energjetike, ndërkaq shqetëson fakti që ka mungesë të produkteve ushqimore për shkak të shpërndarjes në kohë nga ana e furnizuesve.

Si një shembull pozitiv mund të theksohet **Spitali Psikiatrik Demir Hisar** ku u konstatua se në mënyrë efikase përpilohet lista e ushqimeve për muajin aktual dhe në mënyrë përkatëse ishte theksuar edhe lista ditore e vakteve, si dhe lista e veçantë në të cilën është regjistruar numri i personave për të cilët është i nevojshëm ushqimi i përfurcuar.

Personeli

Në përgjithësi, gjatë vizitave të spitaleve psikiatrike, MPN-ja konstatoi se ka mungesë të resurseve njerëzore, të cilët do të mund t'u ofronin vëmendjen dhe kujdesin e duhur pacientëve me sëmundje mendore. Në **Spitalin Psikiatrik Shkup** u konstatua se ky spital nuk është i plotësuar në tërësi me personelin e nevojshëm i cili do t'i plotësonte nevojat për mjekim, rehabilitim dhe/ose kujdes të pacientëve. Gjendje e ngjashme u konstatua në **Spitalin Psikiatrik Demir Hisar**, në të cilin ka mungesë të stafit njerëzor, sidomos ka mungesë të personelit të lartë, d.m.th., mjekë-specialistë nga fusha e psikiatrisë, psikologë dhe farmaceutik të diplomuar. Njëkohësisht, u konstatua se në spital ka edukim të pamjaftueshëm të stafit të ndërmjetëm mjekësor dhe jo-mjekësor. Veçanërisht është i rëndësishëm edhe trajnimi i personelit jo-mjekësor të ndihmësmjekëve dhe mbikëqyrësve të personave të sëmurë, sepse ata, bashk me stafin e ndërmjetëm, zakonisht janë në kontakt me njerëzit që trajtohen në kushte spitalore dhe ambulatorie dhe nuk kanë edukim paraprak mjekësor.

Në **Spitalin Psikiatrik Negorcë** ka mungesë të stafit njerëzor, sidomos të stafit me shkollim të mesëm mjekësor dhe të sanitarëve, kështu që në këtë drejtim në repartin kronik B, në të cilin janë të vendosur edhe persona me anormalitet mendor, në turn janë vetëm një infermierja dhe sanitari. Mungesa e stafit çon deri te kufizimi i lirisë së lëvizjes së pacientëve të cilët mbahen të mbyllur dhe në këtë mënyrë të njëjtit vihen në një pozitë më të pavolitshme krahasuar me pacientët e tjerë. Në spital nuk ka të farmacist të punësuar, ndërsa si problem mbetet edhe mungesa e institucionit përkatës arsimor për trajnimin e kadrove për terapi angazhimi.

Përgjigje nga spitalet psikiatrike

Mekanizmi parandaluese nacional në raportet e dorëzuara nga vizitat parandaluese në spitalet psikiatrike Shkup, Demir Hisar dhe Negorcë, mori përgjigje nga institucionet e vizituara, në të cilat ishte i njoftuar për shkallën dhe mënyrën e veprimit sipas rekomandimeve dhe sugjerimeve të dhëna.

Drejtoritë e spitaleve në masë të madhe ranë dakord me gjendjet e konstatuara negative dhe rreziqe të identifikuara dhe e njoftuan Avokatin e Popullit – Mekanizëm parandaluese nacional për masat që do të ndërmarrin në drejtim të largimit të mungesave dhe përmirësimit të gjendjeve.

Në atë pjesë ishte dhënë një përgjigje nga spitali psikiatrik Shkup se do të rrespektohet Ligji për mbrojtjen e pacientëve, si edhe se është kërkuar nga udhëheqësit e departamenteve për të rritur kontrollin e përdorimit konsekuent të Rregullores për fiksion, me vëmendje të veçantë mbi saktësinë e udhëheqjes së evidentimit të paraparë me Protokollin. Nga ana e spitalit psikiatrik Negorcë, MPN ishte i lajmëruar për përdorimin e rregullt të Protokollit për fiksion, si dhe se në të ardhmen spitali do të bëjë përpjekje për furnizim të mjeteve konvencionale për fiksion, të cilat me pamjen dhe formën e tyre do të kënaqin normat e kërkuara.

Nga spitali i njëjtë është i miratuar Udhëzimi për mënyrën e pranimit, trajtimit dhe largimit të pacientëve, në përputhje me rekomandimin e dhënë të MPN-së. Gjithashtu, është i zbatuar edhe një riorganizim i stafit spitalor me qëllim prani më të madhe të personave të punësuar në departamentin kronik B, në të cilin janë të vendosur edhe persona me anormalitet mendor. Njëkohësisht, ishte i theksuar edhe qëndrimi pozitiv në lidhje me nevojën e programit për edukim të të punësuarve në spitalin psikiatrik dhe nga spitali psikiatrik Demir Hisar është i përpiluar edhe një plan vjetor për edukim të të punësuarve në këtë institucion. Për shkak se institucioni psikiatrik Negorcë nuk ka një hapësirë të veçantë – karantinë për persona me sëmundje infektuese, drejtorja ka dorëzuar një njoftim me shtim se është i përpiluar Programi i masave mbrojtëse për parandalimin e infeksioneve intrahospitale, në përputhje me Ligjin për mbrojtje shëndetësore dhe Ligjin për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet

infektuese.

Nga spitali psikiatrik Demir Hisar, në përgjigjen, MPN ishte i informuar se ndërkohë është i punësuar një mjek-specialist psikiatër, si dhe se është hapur një shpallje për punësim të një farmacisti, fizioterapeut dhe shtatë infermiere. Nga spitali psikiatrik Shkup në lidhje me nevojën nga përfshirja më e madhe në terapinë me punë, MPN ishte i lajmëruar se spitali ka dorëzuar kërkesë deri te Ministria e shëndetësisë për marrjen e pëlqimit për punësime të reja të terapeutikëve të angazhimit.

Shumica e rekomandimeve ishin të pranuar në drejtim të përmirësimit të kushteve dhe trajtimit me personat e vendosur në spitalet psikiatrike dhe kushtet materiale do të përmirësohen me masat e ndërmarra për rinovimin e kapaciteteve të akomodimit.

Në afatin e paraparë ligjor, MPN nuk mori përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë, as në periudhë e mëvonshme të përgatitjes së raportit, me çka nuk është i respektuar përcaktimi ligjor me të cilin organet, organizatat dhe institucionet në të cilat liria e lëvizjes është e kufizuar janë të detyruara brenda 30 ditëve pas marrjes së raportit ta lajmërojnë Avokatin e Popullit për trajtimin me sugjerimet dhe rekomandimet e dhëna.

Ç. VENDE TË TJERA TË VIZITUARA

Në vitin 2012, MPN-ja realizoi vizita të rregullta të paparalajmëruara në Institucionin Publik për Përkujdesjen e Fëmijëve me Probleme Edukative dhe Sociale – Shkup, Qendrën për Pranimin e të Huajve të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Entin Special në Demir Kapi. Edhe pse këto institucione nuk paraqesin vende klasike për privim nga liria, Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional vendosi t'i vizitoj këto institucione në përputhje me kompetencat që dalin nga neni 4 dhe neni 20 i Protokollit Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Trajtitimit apo Ndëshkimit tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Degradues.

Vizitat në këto institucione u realizuan në bashkëpunim me drejtoritë dhe me të punësuarit në institucione, ndërsa ekipi i MPN-së realizoi vizitë pa pengesë në vendet e vendosjes, si dhe pati liri të plotë në zgjedhjen e personave me të cilët bisedoi.

Ç.1. Institucioni Publik për Përkujdesjen e Fëmijëve me Probleme Edukative-Sociale – Shkup

Në përputhje me rregullat e vlefshme ligjore, Institucioni për vendosjen e fëmijëve dhe të rinjve me probleme edukative-sociale, bën pranimin dhe përkujdesin afatshkurtër të personave të mitur, vëzhgimin e tyre dhe diagnozën, vendosjen, edukimin, arsimimin dhe trajtimin korrigjues në varësi të nevojave të tyre në kohëzgjatje deri tre vite⁴⁹. Në të njëjtin institucion është i vendosur edhe Qendra për të Mitur, e cila në përputhje me rregullat ligjore paraqet një masë të cilën e shqipton gjykata, kur është e nevojshme, me masa afatshkurtra përkatëse për të ndikuar në personalitetin dhe sjelljen e të miturit.

Institucioni publik bën vendosjen e fëmijëve dhe të rinjve me probleme edukative-sociale. Në Ligjin për mbrojtje sociale nuk ka ndonjë përcaktim konkret për fëmijët dhe të rinjtë me probleme edukative-sociale, ndërsa vetëm në nenin 32 të Ligjit, në pjesën e fëmijës me probleme edukative-sociale janë të shënuara "fëmijë i keqtrajtuar, i neglizhuar dhe i pasiguruar social". MPN-ja konsideron se është e nevojshme që edhe në Ligjin për mbrojtje sociale, në përputhje me të cilin përcaktohet mbrojtja institucionale, të jepet një përcaktim i qartë për kategorinë e fëmijëve dhe të rinjve me probleme edukative-sociale dhe në këtë mënyrë saktë të përcaktohet se cila kategori e personave do të vendoset në këtë institucion, sepse me vendosjen aktuale në të qëndrojnë edhe të mitur autorë të veprave penale, që paraqet një rrezik për përhapjen e infeksionit kriminogjen midis personave të cilët vihen nën përkujdesje.

Fëmijët që qëndrojnë në institucion u shprehën të kënaqur nga drejtoria e institucionit dhe vunë në dukje se drejtori është në dispozicion për mendimet e tyre, propozimet dhe ankesat. Ata janë të kënaqur edhe nga trajtimi nga ana e të punësuarve në institucion dhe konsiderojnë se raporti i tyre është korrekt, me përjashtime të caktuara. Nuk shprehën ankesa në lidhje me keqtrajtimin fizik nga ana e stafit, por për dhunën ndërmjet vetë personave nën përkujdesje. Ankesat, kryesisht, kanë të bëjnë me cilësinë dhe sasinë e ushqimit, si dhe ngrohjen e objekteve për vendosje dhe qëndrim.

Megjithatë, vetëm një fëmijë u intervistua në mënyrë të veçantë për shkak të

⁴⁹ Neni 118 i Ligjit për mbrojtje sociale ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 79/09, 36/11 dhe 51/11).

akuzave të shprehura serioze që kishin të bënin me keqtrajtimin fizik dhe seksual të këtij të përkujdesuri nga ana e një të përkujdesuri tjetër, një ngjarje e cila ka ndodhur para 3 vitesh para vizitës së ekipit të MPN-së në këtë institucion. MPN-ja realizoi një kontroll në dosjen amzë të fëmijës, me ç'rast konstatoi se në evidencën kronologjike ishte vërejtur një ngjarje e përshkruar nga ana e fëmijës, i cili ka paraqitur deri te personat e punësuar në institucionin, se ka qenë i keqtrajtuar fizikisht dhe seksualisht nga ana e një të përkujdesuri tjetër. MPN-ja konstatoi se sipas këtij kallëzimi, nga institucioni nuk ishin ndërmarrë masa dhe aktivitete konkrete, prandaj zhvilloi një bisedë me infermierën dhe punëtorin social dhe vendosi të dorëzojë informacion deri te Avokati i Popullit, me qëllim të informimit dhe ndërmarrjes së masave të mëtejshme në drejtim të mbrojtjes së të drejtave⁵⁰. Në këtë drejtim, MPN-ja kërkoi nga drejtoria e institucionit që detyrimisht t'i ndërmarr të gjitha masat ligjore në rastet e kryerjes së veprimeve me elemente të veprës penale dhe analizimin në detaje dhe kallëzimin e çdo ankese nga personat e mitur për dhunë fizike dhe keqtrajtim seksual, me qëllim të zbatimit të procedurës përkatëse dhe përcaktimit të përgjegjësisë.

Gjithashtu, MPN-ja kërkoi të ndërmarrë aktivitete përkatëse nga ana e drejtorisë me të cilat do të analizohen ankesat e personave të cilët janë nën përkujdesje për sjelljen e pahijshme dhe jokorrekte të një pjese të edukatorëve të natës dhe të ndërmerren masa për vendosjen e një raportit profesional dhe korrekt nga ana e të gjithë të punësuarve, me respektim të plotë të personit dhe dinjitetit të të miturve të vendosur në këtë institucion.

Ekipi i MPN-së ka bërë një kontroll në hapësirat e vendosjes, ku u konstatua se kapacitetet e vendosjes kryesisht i plotësojnë standardet e dëshiruara dhe janë të pajisura në mënyrë përkatëse për vendosjen e personave të mitur, me mundësi për një rregullim shtesë nga vetë personat që janë nën përkujdesje. Një pjesë e inventarit në dhomat për vëzhgim është i dëmtuar dhe duhet të rinovohet në mënyrë shtesë me qëllim të plotësisht të kushteve për vendosjen e personave të rinj nën përkujdesje në Institutin. Kushtet në klasa janë në nivelin e duhur, janë të ngrohura në mënyrë përkatëse dhe të pajisura për realizimin e programit arsimor. Në kuadër të Institutin është vendosur dhe pajisur Qendra për të mitur, që është e përcaktuar me Ligjin për të drejtën e të miturve, por edhe pse është e re ka dëmtime të pjesshme prandaj nevojitet mirëmbajtje e rregullt.

MPN-ja kërkoi nga institucioni rinovimin në kohë dhe mirëmbajtjen e hapësirave për vendosje dhe qëndrim me qëllim të mbrojtjes nga dëmtimi i përhershëm i hapësirës, inventarit dhe mobileve. Është i nevojshëm realizimi i një mbikëqyrje të forcuar dhe vendosje e rregullave më të rrepta në rast të futjes së materieve të rrezikshme dhe të palejueshme, si edhe konsumimi i alkoolit dhe cigareve nga ana e personave të mitur.

MPN-ja konsideron se institucioni duhet të vendosë protokolle për parandalimin e dhunës mes të miturve, si dhe e konstatoi edhe nevojën për intervenim të detyrueshëm dhe në kohë të edukatorëve në parandalimin e incidenteve dhe konflikteve midis të miturve në institucion, si dhe evidentimin në një regjistër/libër të veçantë të të gjitha rasteve të dhunës fizike midis fëmijëve dhe rasteve të vetëlëndimit.

Institucioni ka në dispozicion një dhomë për ambulancë, të pajisur në mënyrë solide në të cilën mjekohen sëmundje të caktuara më të lehta të personave nën përkujdesje dhe në të cilën është e punësuar në mënyrë të rregullt një infermiere, e cila është e përfshirë edhe në edukimin e aftësive të shëndosha të jetës, si dhe për parandalimin e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme. MPN-ja kërkoi që infermierja të përfshihet në përgatitjen e menysë në kuzhinën dhe në mënyrë të rregullt të nënshkruhet në listën djavore. Drejtoria e institucionit duhet të bëjë përpjekje për tejka-

⁵⁰ AP hapi procedurë për rastin në fjalë, të identifikuar nga ana e MPN-së gjatë vizitës së institucionit, në lidhje me çka është hartuar një informatë e cila i është drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila e ka njoftuar AP se është e ngritur procedurë për analizimin në detaje të rastit.

limin e situatës aktuale të dorëzimit të vonuar të kartonëve të kaltër për sigurim shëndetësor, me qëllim që t'u mundësohet qasje në kohë deri te shërbimet shëndetësore.

Në përbërje të institucionit është i vendosur Sheltër qendra për gra-viktima të dhunës në familje, si edhe Qendra për vendosjen e personave të zhvendosur brenda vendit, gjë e cila mund të ketë ndikim negativ mbi trajtimin edukativ dhe korrektues të të miturve që kanë probleme edukative-sociale.

Konstatime dhe rekomandime konkrete dhe të detajuara janë përmbajtur në raportin e veçantë të vizitës, i dorëzuar deri te Institucioni dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Në përgjigjen sipas raportit, institucioni dhe MPPS në masë të madhe pajtohen me gjendjet e konstatuara dhe e njoftuan MPN se pajtohen dhe se kanë vepruar në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të dhëna. MPN-ja gjatë realizimit të vizitës së fundit të institucionit do të bëjë një vlerësim për shkallën e implementimit të rekomandimeve të dhëna.

Ç.2. Qendra për Pranimin e të Huajve pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme

Në përputhje me rregullat pozitive vendase, në Qendrën për Pranimin e të Huajve pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme vendosen të huaj, të cilët për çfarëdo qoftë arsye nuk mund të largohen me forcë brenda 24 orëve nga territori i Republikës së Maqedonisë, i huaji për të cilin është miratuar një vendim për dëbim, ndërkaq nuk posedon dokumente të vlefshme⁵¹, i huaji për të cilin gjykata ka miratuar masë për ndalimin e të huajit⁵², të huaj të mitur të pashoqëruar⁵³ dhe viktima të trafikimit me njerëz në periudhën e miratimit të bashkëpunimit me organet shtetërore të ndjekjes⁵⁴. Respektivisht, shtetasit e huaj në këtë Qendër mund të mbahen në bazë të vendimit të miratuar nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme ose në bazë të vendimit gjyqësor (aktvendimit).

Mekanizmi Parandalues Nacional bëri kontroll në kapacitetet e vendosjes, dhomën e izolimit (karantinë), hapësirat e përbashkëta, nyjet sanitare dhe dushet, ambulançën, magazinën për valixhe, hapësirën për kontroll personal, zyrën e kujdestarisë së nëpunësve policorë dhe hapësirat e tjera, ndërsa zhvilloi edhe bisedë me strukturat udhëheqëse dhe me të punësuarit. Gjatë vizitës u zhvillua bisedë konfidenciale me personin e vetëm, shtetas të huaj, i cili gjatë vizitës ishte i vendosur në Qendër dhe i cili ishte i kënaqur nga sjellja dhe trajtimi me të nga ana e shërbimeve të Qendrës së pranimit. Personit i ishin siguruar mjetet themelore për higjienë personale dhe i njëjti nuk kishte ankesa sa i përket ushqimit. Avokati i Popullit – MPN realizoi takim dhe zhvilloi bisedë me disa të punësuar të shërbimit të sigurimit të Qendrës (nëpunësit policorë me uniformë) të cilët gjatë vizitës ishin në vendet e tyre të punës.

Si vërejtje e përgjithshme, MPN kërkoi të sigurohen informacione më të detajuara dhe në kohë për Rendin e shtëpisë, në gjuhën të cilën njerëzit e kuptojnë, përmes përkthimit të Rendit të shtëpisë në disa gjuhë që zakonisht e flet shumica e të huajve të vendosur.

Në Pavijonin 1, në të cilin vendosen kategoritë e posaçme vulnerable të shtetasve të huaj, në vend përkatës ishte theksuar Rendi i shtëpisë të Qendrës së pranimit në gjuhën angleze. Me vendosjen kolektive në këtë pavijon, MPN-ja konsideron se nuk

⁵¹ Neni 108 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit për të huajt ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 35/2006, nr. 66/2007, nr. 118/2008, nr. 92/2009, nr. 156/2010, nr. 158/2011, nr. 84/2012).

⁵² Neni 93 i Ligjit për kundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 62/2006, nr 51/2011).

⁵³ Neni 112, paragrafi 2 të Ligjit për të huajt.

⁵⁴ Neni 81, paragrafi 2 të Ligjit për të huajt.

plotësohen standardet e dëshiruara ndërkombëtare për sipërfaqe për një person të privuar nga liria, më saktë sipërfaqja është më e vogël se 4m² për person të vendosur në hapësirë, e as nuk realizohet në tërësi e drejta e privatësisë së personave të vendosur këtu. Në këtë drejtim, MPN-ja rekomandoi zvogëlimin e numrit të shtretërve në dhomat e mëdha të fjetjes, veçanërisht në Pavijonin 1, duke pasur parasysh kategorinë e personave të cilët vendosen në këtë pavijon, vulnerabilitetin dhe nevojat e tyre të veçanta.

Në Pavijonin 2, dhomat ishin në proces të rinovimit, më saktë shtroheshin me pllaka të reja në dyshemenë, plafon të ri me sistem ndriçimi, disa nga dritaret zëvendësoheshin me të reja, ndërsa muret ishin të ngjyrosura siç duhet. Në mënyrë plotësuese, MPN-ja kërkoi nga Ministria e Punëve të Brendshme të bëjë rinovimin e tualeteve të shkatërruara dhe të dëmtuara në pavijone. MPN-ja konsideron se deri te rinovimi i tyre dhe vënia e tyre në funksion, tualetet duhet të jenë të mbyllura dhe të paarrtshme, sepse të njëjtat paraqesin rrezik të mundshëm për shëndetin e personave, si dhe mund të jenë burim të sëmundjeve.

Në hapësirën e izolimit/karantinës, MPN-ja konstatoi se asnjë nga shtretërit nuk ishte i fiksuar për dyshemenë, me çka konsideron se nuk janë plotësuar standardet e sigurisë-mbrojtjes, ndërsa personi i vendosur këtu në varësi të gjendjes psiko-fizike, para dhe gjatë kohëzgjatjes së izolimit, lehtë mund të vetë lëndohet.

Mbrojtja primare shëndetësore zhvillohet në rrethin e Qendrës me çka pacientëve u lehtësohet qasja deri te mjeku, ndërsa dhoma e ambulancës është e pajisur me një barnatore të veçantë, në të cilën në mënyrë përkatëse ruhen dhe magazinohen medikamentet. Megjithatë, personi me të cilin MPN-ja zhvilloi bisedë nuk ishte kontrolluar nga ana e mjekut pas pranimit në Qendrën – MPN-ja konsideron se situata e tillë paraqet lëshim të shërbimeve, duke pasur parasysh se për shkak të vlerësimit të gjendjes shëndetësore, në përputhje me rregullat ekzistuese, personi duhej të ishte kontrolluar fillimisht nga mjeku gjatë pranimit në Qendrën. MPN-ja kërkoi përmirësimin e mbrojtjes shëndetësore nëpërmjet vendosjes së një sistemi të kontrollit të detyrueshëm të personit brenda 24 orëve gjatë pranimit në Qendrën, ndërsa qasje deri te libri i ambulancës, në të cilin regjistrohen kontrollat mjekësore dhe të dhënat për gjendjen shëndetësore të personave, të kenë vetëm personat profesional dhe jo edhe nëpunësit policorë me uniformë.

Në drejtim të parandalimit të torturës dhe uljes së rreziqeve nga trajtimi i mundshëm mizor ose çnjerëzor me të huajt e vendosur në këtë Qendër, MPN-ja kërkoi inkorporimin e protokollit me shkrim për trajtimin e të huajve gjatë dhunës fizike dhe incidenteve midis personave të vendosur në Qendrën e pranimit, si dhe udhëheqjen e një Regjistri të veçantë për përdorimin e mjeteve të detyrimit, pa dallim nëse të njëjtat janë përdorur nga personi zyrtar i punësuar në Qendrën e pranimit ose nëpunësi policor nga stacioni policor me kompetencë të përgjithshme.

Në Librin e ngjarjeve ditore, gjatë kontrollit MPN-ja konstatoi se në mënyrë të rregullt dhe efikase regjistrohen dhe evidentohen ngjarjet. Në pjesën e evidentimit përdoret korrektori për fshirjen e të dhënave të shkruara gabimisht, ndërsa MPN-ja kërkoi të vendosen formularë të posaçëm për fletët e pranimit dhe kartonët për të huajt, në përputhje me nenin 10 të Rregullores për Rendin e shtëpisë.

MPN-ja dërgoi rekomandim deri te Ministria e Punëve të Brendshme për ndryshimin e disa neneve të Rregullores për Rendin e shtëpisë së Qendrës së Pranimit për të Huajt dhe njëkohësisht kërkoi të zhvillohen programe për ndihmë psiko-sociale, si dhe programe për parandalimin e vetëlëndimit. MPN-ja konsideron se duhet të rriten aktivitetet rekreative ditore të personave të vendosur në Qendër, si dhe të rritet numri i të punësuarve në Qendër por edhe të përfshihen profile të reja të profesioneve.

Konstatime dhe rekomandime të detajuara dhe konkrete janë përmbajtur në raportin e veçantë të vizitës së dërguar deri te Qendra dhe Ministria e Punëve të Brendshme. Në përgjigje të raportit të dorëzuar, Qendra për të huaj e ka njoftuar MPN

se pajtohet dhe se ka vepruar dhe do të veprojë në drejtim të realizimit të rekomandimeve të dhëna. Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë, e njoftoi MPN se në Qendrën e pranimit është rritur numri i personelit dhe njëkohësisht hartohet një protokoll për veprimin e nëpunësve policorë gjatë incidenteve midis personave të vendosur në Qendrën. Qendra, sipas përgjigjeve të marra, tashmë është furnizuar dhe përdor një regjistër të veçantë për përdorimin e mjeteve të detyrimit. MPB-ja ka dërguar përgjigje se janë pranuar dhe janë në procedurë të implementimit propozimet e parashtruara për ndryshimin e Rregullores së Rendit të shtëpisë së Qendrës për Pranimin e të Huajve, të propozuar nga ana e MPN-së.

Ç.3. Enti Special Demir Kapi

Enti Special në Demir Kapi, në përputhje me rregullat ekzistuese pozitive-ligjore, është institucion për vendosjen e personave me pengesa në zhvillimin mendor, i cili siguron vendosjen, kujdesin, mbrojtjen shëndetësore, rehabilitimin, terapinë me punë dhe okupacionale, në përputhje me aftësitë e tyre dhe gjendjen shëndetësore⁵⁵. Vizitën në Entin Special në Demir Kapi, MPN-ja e realizoi i shoqëruar nga bashkëpunëtori i jashtëm-psikiatri, në përputhje me Memorandumin për bashkëpunim të nënshkruar midis Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë dhe Shoqatës së Psikiatërve të Republikës së Maqedonisë.

Mekanizmi Parandalues Nacional në fillim të vizitës bisedoi me drejtorin dhe personat udhëheqës të institucionit, ndërsa pastaj, duke u ndarë në dy ekipe, bëri kontroll në kapacitetet e vendosjes, departamentin e terapisë me punë dhe okupacionale, kuzhinën dhe hapësirat e tjera ndihmëse. Gjatë vizitës u zhvillua bisedë me shumicën e të punësuarve në institucionin (dado, infermiere, defektologë, instruktorë, etj.), si dhe me disa persona të vendosur në institucionin. Njëkohësisht, u kontrolluan edhe planet individuale për punë, evidenca mjekësore e disa personave të vendosur në këtë institucion dhe regjistrat e tjerë që udhëhiqen në institucionin.

MPN-ja gjatë vizitës së Entit nuk hasi në raste e as nuk mori ankesa për torturë të mundshme ose trajtim mizor apo ndëshkim të përdoruesve të institucionit. Kushtet materiale dhe gjendja në pjesën më të madhe i kënaqin standardet e dëshiruara minimale, ndërsa në rrjedhë është rikonstruksioni i Bllokut A në drejtim të përmirësimit të kushteve për vendosjen e përdoruesve. Hapësirat për vendosje gjatë vizitës ishin të ndriçuar dhe të ngrohura në mënyrë përkatëse.

MPN-ja konstatoi se një pjesë e përdoruesve përfshihen në terapinë okupacionale dhe fizikale që realizohen nga profilet profesionale përkatëse. Ekzistojnë ndryshime pozitive në lidhje me udhëheqjen e rregullt dhe cilësore të dokumentimit, evidentimit dhe regjistrave të Entit. Në Ent nuk realizohet çmobilizimi fizik (fiksimi) i përdoruesve, ndërsa gjatë vizitës nuk u vërejtën dhoma dhe instrumente për fiksime fizik, si dhe nuk u morën të dhëna për ekzistimin e tyre.

MPN-ja konstatoi edhe gjendje të caktuara negative. MPN shprehu shqetësim për trajtime të caktuara të cilat paraqesin rrezik dhe mund të çojnë deri në trajtim mizor dhe/ose çnjerëzor, ndërsa për të njëjtët kërkoi nga drejtorja e Entit që në mënyrë përkatëse të ndërmer masa konkrete. Kushtet materiale dhe gjendja, në pjesën më të madhe, i përmbushin standardet e dëshiruara minimale, ndërkohë që është në rrjedhë rikonstruksioni i Bllokut A, në drejtim të përmirësimit të kushteve të vendosjes së përdoruesve. Megjithatë, nyjet sanitare dhe banjat, ishin pjesërisht të shkatërruara dhe të papërshtatshme për këtë kategori personash dhe ishte shqetësuese edhe gjendja me kushtet materiale në shtojcën/depandansin e Entit ku ishin vendosur 51 përdorues.

⁵⁵ Neni 126 i Ligjit për mbrojtje sociale ("Gazeta zyrtare e RM-së nr. 79/2009, 36/2011, 51/2011 dhe 166/2012).

MPN-ja shprehu shqetësim për shkak të faktit se ashensori, në të ashtuquajturin objekt i ri, nuk ishte në gjendje të duhur dhe për këtë shkak qasja deri te terapia dhe hapësira e jashtme, për shëtitjen e shumicës së përdoruesve të vendosur në katin e dytë të objektit (gjysmë të lëvizshme dhe të palëvizshme), në mënyrë të konsiderueshme është e vështirësuar. MPN-ja konsideron se në këtë mënyrë kufizohet liria dhe hapësira e lëvizjes së përdoruesve.

MPN-ja konstatoi se ekziston staf i pamjaftueshëm në Ent me kuadër nga fushat në vijim: mjek për mjekësi të përgjithshme, neuropsikiatër, logoped, punëtor social dhe profile të tjera, ndërsa prania dhe vizitat e bashkëpunëtorëve të jashtëm (si gjinekolog, internist dhe fiziatër) nuk janë në nivelin e kënaqshëm.

Në Ent, gjatë vizitës kishte edhe mungesë të ushqimit dhe produkteve ushqimore, për shkak se jo gjithmonë përgatiten vaktet në përputhje me listën e caktuar të vakteve.

Veçanërisht është shqetësuese gjendja se gjatë dhënies së mjeteve të kontracëpsionit nuk kërkohet, as merret miratim nga kujdestari ose nga vet përdoruesi (nëse nuk i është marrë aftësia e punës), njëkohësisht përdoruesit jo gjithmonë informohen në mënyrë të duhur dhe përkatëse për qëllimin e mjetit të kontracëpsionit që jepen.

Si rezultat i vizitës së realizuar, Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional hartoi një raport të veçantë në të cilin i konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe dha rekomandime përkatëse, të cilat ia dërgoi Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe drejtorisë së Entit në Demir Kapi, me qëllim të shmangies së mangësive të identifikuara. Në përgjigjen ndaj raportit të dorëzuar Enti special e njoftoi MPN se pajtohet me gjendjen e konstatuar dhe sugjerimet. MPN-ja e thekson qasjen pozitive të drejtorisë së këtij institucioni, e cila ka hartuar Plan veprim të veçantë për zbatimin e masave dhe shmangien e mangësive dhe parregullsive të konstatuara nga ana e MPN-së. Në përputhje me planin e dorëzuar tek çdo rekomandim është cekur personi përgjegjës për zbatimin e tij, data e fillimit me implementim dhe kohëzgjatja e aktiviteteve.

3 VIZITAT PËR RI-KONTROLL NË VITIN 2012

A. VIZITA TË REALIZUARA PËR RI-KONTROLL

Në vitin 2012, Mekanizmi Parandalues Nacional filloi me realizimin e vizitave për ri-kontroll, me qëllim që të bëjë vlerësimin e nivelit të implementimit të rekomandimeve të dhëna në bazë të vizitave të rregullta të realizuara më parë në vendet e privimit nga liria. Vizitat për ri-kontroll u realizuan në 5 stacione policore (SP Çair, SP Aerodrom, SP Draçevë, SP Gostivar dhe SP Kisella Vodë), si dhe në një institucion ndëshkues-korrektues (Burgun Shkup) dhe Entin Edukues-Korrektues Tetovë.

Gjatë vizitës së **SP Çair**, Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi se SP Çair edhe më tej përdor hapësirën e njëjtë për mbajtje. Nga ana e stacionit policor janë bërë përpjekje për ngjyrosjen e tyre, si dhe për vendosjen e batanijeve shtesë, por edhe më tej mbeten kushtet johumane dhe degraduese për qëndrim. Gjatë vizitës për ri-kontrolli, MPN-ja konstatoi se hapësirat e vjetra të bodrumit edhe më tej janë të hapura dhe deri në to lehtësisht kanë qasje nëpunësit policorë të SP Çair. Gjatë kontrollit, MPN-ja vërejti se SP Çair edhe më tej përdor tualetet e njëjtë për personat zyrtar dhe personat e privuar nga liria, përkatësisht në këtë stacion policor nuk ka tualet të veçantë, i cili do të përdorej nga personat e mbajtur dhe në të cilin nuk do të ketë objekte të thyeshme, të cilët do të mund ta rrezikojnë sigurinë dhe shëndetin e personave të privuar nga liria, si dhe paraqesin rrezik të mundshëm për lëndim ose vetëlëndim. MPN-ja vlerësoi se ky rekomandim është realizuar pjesërisht, sepse ekziston mbikëqyrje e përfurcuar në rastet kur personat e mbajtur e përdorin tualetin, duke pasur parasysh se edhe më tej paraqiten mbajtje më të gjata edhe gjatë natës (gjatë kontrollit në evidencë u konstatuan mbajtje më të gjata se 12 orë) në këtë stacion policor, që çon në konkluzion se personat e mbajtur kanë nevojë nga përdorimi më i shpeshtë i tualeteve.

Nga vizita e MPN-së në vitin 2012 mund të përfundohet se gjendja me kushtet në të cilat qëndrojnë personat e mbajtur është e pandryshuar, përveç në pjesën e mbajtjes së higjienës dhe mbikëqyrjes më të madhe, të cilën e zbatojnë shërbimet në këtë stacion policor. Gjatë kontrollit të tre dosjeve të personave të mbajtur u konstatua se në këtë SP edhe më tej ka mbajtje gjatë natës, edhe pse një pjesë e personave të mbajtur transferohen, për të kaluar natën në SP Bit Pazar, për shkak të mungesës së kushteve të mbajtjes në këtë stacion. Në këtë drejtim, MPN-ja kërkoi nga stacioni policor, si edhe nga MPB-ja, të dërgojnë informacion nëse stacioni policor Çair edhe më tej do të përdoret si vend për mbajtje, me ç'rast përgjigjja ishte se i njëjti nuk do të përdoret për mbajtjen e personave për shkak të mosplotësimit të normativave dhe standardeve të përgjithshme për mbajtje. Në lidhje me gjendjet e tjera të konstatuara, SP Çair e njoftoi MPN se janë ndërmarr masa për zbatimin e sugjerimeve të dhëna.

Gjatë vizitës së **SP Aerodrom** u konstatua se rekomandimet ishin zbatuar plotësisht ose pjesërisht nga ana e SP Aerodrom, ndërsa hapësira për mbajtje vërehej se ishte ri-dedikuar në magazinë për armë, më saktë në ditën e vizitës ekipi i MPN-së konstatoi se ekipet teknike punonin në ri-dedikimin e hapësirës.

Gjatë kontrollit në 6 dosje të personave të mbajtur u konstatua se në këtë

stacion policor nuk ka mbajtur më të gjata dhe personat e mbajtur transferohen për mbajtje gjatë natës në SP Kisella Vodë dhe SP Gazi Babë, për shkak të mungesë së kushteve për mbajtje në SP Aerodrom. Nga kontrolli i bërë në evidenca, ekipi i MPN-së konstatoi se të gjitha dosjet e kontrolluara i përmbanin dokumentet themelore, në përputhje me procedurat standarde operative. Megjithatë, MPN-ja gjatë vizitës për ri-kontroll konstatoi mangësi të rrjedhës së logjikshme kohore të ngjarjeve, si dhe plotësimin jo të plotë të procesverbaleve për personat e mbajtur, mosthirrjen e mjekut në rast të lëndimeve të konstatuara të dukshme dhe ekzistimin e shenjave të dukshme të sëmundjes (çrregullim), si dhe një rast të mbajtjes së tre personave në periudhën nga rreth 8 orë në kushte kur në SP Aerodrom ka ekzistuar vetëm një hapësirë për mbajtjen individuale të personave.

Në raportin e dërguar për vizitën e ri-kontrollit të SP Aerodrom, MPN-ja u njoftua se stacioni policor ka mbajtur një takim pune me qëllim të tejkalimit të mangësive të konstatuara, si dhe veprimet sipas rekomandimeve të dhëna nga ana e Mekanizmit Nacional Parandalues. Njëkohësisht, sikurse për Stacionin Policor Çair, ashtu edhe për këtë stacion policor, Sektori i Punëve të Brendshme – Shkup dërgoi njoftim se në të ardhmen i njëjti nuk do të përdoret për mbajtjen e personave, për shkak të mosplotësimit të normave dhe standardeve të përgjithshme të hapësirave për mbajtje.

Nga vizita e MPN-së në vitin 2012, në **SP Draçevë**, u konstatua se në këtë stacion policor me përjashtim, edhe më tej mbahen persona dhe për mbajtje përdoren të njëjtat hapësira të cilat nuk i plotësojnë kushtet e përgjithshme minimale, edhe pse është përcaktuar një mënyrë e re e punës së SPB-së Shkup, në përputhje me të cilën në një pjesë të stacioneve policore në territorin e qytetit të Shkupit, duke përfshirë këtu edhe SP Draçevë, nuk do të mbahen persona të privuar nga liria. Nga evidenca, ekipi i MPN-së konstatoi se të gjitha dosjet e kontrolluara i përmbanin dokumente e nevojshme, në përputhje me procedurat standarde operative, dhe sidomos respektohej rekomandimi i ekipit të MPN-së nga viti 2011, që në përbërje të dosjes gjithmonë të bashkëngjitet edhe procesverbali i udhëzimit/mësimimit dhe të drejtave. Njëkohësisht, ishin korrigjuar gabimet dhe papërpunueshmëritë në numrat rendor të regjistrave të ngjarjeve ditore dhe regjistrat të personave të thirrur, të arrestuar dhe të mbajtur. Në mënyrë plotësuese, MPN-ja dha 4 rekomandime deri te Stacioni Policor me Kompetencë të Përgjithshme Draçevë, si dhe 1 rekomandim deri te Ministria e Punëve të Brendshme.

Nga ana e stacionit policor u dërgua përgjigje se do të veprohet sipas rekomandimeve të AP-së – MPN, ndërsa sa i përket mbajtjes së personave të privuar nga liria, MPN-ja u njoftua se Stacioni Policor Draçevë, duke filluar më 29.09.2012, nuk bën mbajtjen e personave, ndërsa dosjet e kontrolluara gjatë vizitës për ri-kontroll për personat e ndaluar kanë të bëjnë me kohën para kësaj date. Nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme u dërgua një informacion se hapësirat në SP Draçevë nuk përdoren nga data e lartpërmendur, kur është përpiluar edhe Informacioni i Sektorit të Punëve të Brendshme – Shkup deri te Avokati i Popullit.

Si një shembull pozitiv, MPN-ja e thekson gjendjen e hasur gjatë vizitës për ri-kontroll në **SP Gostivar**. Nga vizita e MPN-së në vitin 2012 mund të përfundohet se kushtet në të cilat vendosen personat e mbajtur i plotësojnë standardet minimale për mbajtjen e personave, përveç në pjesën e hapësirës së vjetër, e cila tanimë nuk përdoret. Gjatë kontrollit të regjistrave për ngjarjet e ditës dhe për personat të cilëve liria e lëvizjes u është e kufizuar, MPN-ja konstatoi se të njëjtat udhëhiqen në mënyrë efektive dhe në tërësi, ndërsa të dhënat e regjistruara korrespondojnë me dy regjistrat.

Nga kontrolli në 6 dosje për personat e mbajtur u konstatua se në këtë stacion policor ekziston një përmirësim i konsiderueshëm në pjesën e plotësimit të evidencave policore në lidhje me personat e mbajtur. MPN-ja konstatoi një përparim të madh në pjesën e udhëheqjes së evidencave të personave të mbajtur – të gjitha dosjet e kontrolluara ndihmëse i përmbanin dokumentet themelore dhe procesverbalet për per-

sonat e mbajtur në përputhje me Procedurat Standarde Operative – në të gjitha kishte Procesverbal për mbajtjen e personit dhe Procesverbal për udhëzimin për të drejta. Në pjesën më të madhe të dosjeve të kontrolluara, MPN-ja konstatoi se ka një rrjedhje logjike kohore të ngjarjeve. Në pjesën e dosjeve që kanë të bëjnë me mbajtjen e të miturve, AP – MPN nuk vërejtí tejkallim të afatit kohor, prej maksimumi 12 orë, në përputhje me rregullat pozitive-ligjore të Republikës së Maqedonisë. Në tri dosje, në të cilat personat e mbajtur kanë qenë shtetas të huaj, në procesverbalin për mbajtje nuk ishte evidentuar nëse është kontaktuar përfaqësia diplomatike-konsullore e vendit, shtetas i së cilës është personi.

AP – MPN konstatoi se një person i dehur (2.26% alkool në gjak), që nuk kishte lëndime të dukshme, menjëherë pas pranimit ishte dërguar në qendrën mjekësore dhe për të ishte përpiluar një shënim i veçantë zyrtar. MPN-ja si pozitive e theksoi edhe praktikën e udhëheqjes së shënimeve zyrtare për dërgimin e personit të mbajtur para gjykatës themelore.

Duke pasur parasysh se në hapësirat e reja për mbajtje, në përbërje të tualeteve ishin vërejtur edhe objekte të cilët mund të çojnë deri te lëndimi/vetëlëndimi i personave të privuar nga liria, MPN-ja kërkoi nga Ministria e Punëve të Brendshme t'í rrisin masat mbrojtëse dhe të sigurisë në tualetet, në të cilat qasje kanë personat e mbajtur, ndërsa në këtë mënyrë edhe zvogëlohet mundësia nga lëndimi ose vetëlëndimi i personave, përmes largimit të materialeve dhe objekteve të rrezikshme. Nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme përmes letrës së dërguar, MPN u informua se janë dhënë udhëzime për largimin e të gjitha objekteve të thyeshëm në tualetet, të cilët i përdorin personat e mbajtur. Njëkohësisht, u dha informacioni se hapësira e vjetër për mbajtje është shndërruar në hapësirë për ruajtjen materialeve të punës. Në pjesën e rekomandimeve të dhëna të reja deri te SP Gostivar, MPN-ja u njoftua se të njëjtat janë zbatuar në tërësi.

MPN, realizoi edhe një vizitë të paparalajmëruar nate për ri-kontroll në **SP Kisella Vodë**, në kornizat e mandatit dhe kompetencave që dalin nga Protokollí Fakultativ i Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve tjera Brutale, Jonjerëzore ose Nënçmuese dhe Ligji për Avokatin e Popullit. Nga vizita e MPN-së në vitin 2012 mund të përfundohet se gjendja me kushtet i plotësojnë standardet minimale për mbajtjen e personave. Gjatë kontrollit të regjistrave për ngjarjet ditore dhe për personat, të cilëve liria e lëvizjes u është kufizuar, MPN-ja konstatoi se të njëjtët udhëhiqen në mënyrë efikase, në tërësi, ndërsa të dhënat e regjistruara në këto dy regjistra korrespondojnë.

Në regjistrin për personat, të cilëve mbi çdo bazë u është kufizuar liria nuk kishte përmbledhje për numrin e personave të thirrur, të arrestuar dhe të mbajtur në bazë mujore, që është një detyrim në përputhje me Procedurat Standarde Operative për mbajtjen e personave.

Nga kontrolli i tri dosjeve të personave të mbajtur, u konstatua se në këtë stacion policor me kompetencë të përgjithshme ekziston një përmirësim i konsiderueshëm në pjesën e plotësimi të evidencave policore në lidhje me personat e mbajtur me disa përjashtime. Gjatë bisedës me zyrtarët e SPKP Kisella Vodë, AP – MPN u informua se në këtë stacion policor gjithmonë përdoren hapësirat e reja për zbatimin e bisedës me personat e privuar nga liria. Gjendjen e këtyre MPN-ja në mënyrë të drejtpërdrejtë e konstatoi edhe gjatë vizitës për ri-kontroll. Kontrolli i personave të mbajtur zakonisht zbatohet në të njëjtat hapësira, ku personat, gjithashtu, udhëzohen në lidhje me të drejtat e tyre në procedurë policore. Të drejtat e personave të privuar nga liria ishin theksuar me rregull para dhomës së udhëheqësit të turnit, në të cilën bëhet pranimi fillestar/pranimi i personave.

Si një shembull negativ mund të ceket shkalla e ulët e realizimit të rekomandimeve të dhëna nga ana e Burgut Shkup dhe Enti Edukues-Korrektues Tetovë. Burgu Shkup dhe Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve nuk i kanë zbatuar shumicën e

rekomandimeve të Avokatit të Popullit – Mekanizmit Parandalues Nacional të dhëna pas vizitës së realizuar në korrik të vitit 2011. MPN-ja gjatë vizitës për ri-kontroll të **Burgut Shkup** konstatoi se duke filluar më 05.07.2012 në burg është në funksion një repart pranimit me kapacitet prej 14 vendeve. Gjatë kontrollit të këtij reparti, MPN-ja konstatoi se bëhet fjalë për rregullimin e mëtejshëm të repartit me mjete të burgut, pa asnjë ndihmë nga ana e Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve. Dhomat e fjetjes në këtë repart nuk janë të rinovuara, por vetëm janë ri-dedikuar, ndërsa në mure ishin të dukshme njollat e zeza nga lagështia.

MPN-ja konstatoi se dy hapësira shërbejnë për më tepër dedikime, më saktë në të njëjtat vendosen personat të cilët për shkaqe të caktuara ndahen për një kohë të pacaktuar (zakonisht shkaqe të sigurisë) nga personat e tjerë të dënuar të repartit të mbyllur, personat të cilët duhet të vendosen në repartin e pranimit ose repartin e mbyllur të cilëve duhet të cilëve për shkak të mospagesës së gjobës, gjykata u ka përcaktuar dënime me burg në përputhje me Kodin Penal. Në këtë mënyrë stimulohet infeksioni kriminogjen midis kategorive të ndryshme të personave të dënuar që vuajnë dënimin me burg në këto hapësira, e që është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me procesin e risocializimit të tyre si funksion bazë i institucionit ndëshkues-korrektues. MPN-ja shprehu shqetësim serioz për mënyrën e kategorizimit dhe vendosjes së personave të dënuar në këto dy hapësira. Vendosja e këtyre ua shkurton të drejtat personave të dënuar dhe të njëjtit vihen nën një regjim të rreptë, ku liria e lëvizjes është e kufizuar maksimalisht dhe nuk u mundësohet pjesëmarrje në ndonjë aktivitet produktiv⁵⁶. Në këtë drejtim, MPN-ja kërkoi nga Drejtoria për ekzekutimin e Sanksioneve që në afat sa më të shkurtër të realizojë mbikëqyrje mbi ekzekutimin e dënimit me burg, me një theks të veçantë të kushteve materiale, vendosjes dhe realizimit të të drejtave të personave të vendosur në këto dy hapësira, me qëllim të ndërmarrjes së masave në drejtim të shmangies së parregullsive të konstatuara dhe rreziqeve, ndërsa për të njëjtën në mënyrë kthyesë ta njoftojë MPN. Nga ana e Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve u dërgua një informacion se mbikëqyrja është realizuar, me theks të veçantë mbi hapësirat e cekura, ku është konstatuar se kushtet për qëndrimin e personave të dënuar në këto hapësira janë tërësisht të papërshtatshme. Duke pasur parasysh gjendjen e konstatuar nga mbikëqyrja e realizuar nga DES-i i është dërguar sugjerim drejtorisë së Burgut Shkup, që personat e dënuar të zhvendosen në hapësira të tjera, ndërsa hapësirat që nuk i plotësojnë kushtet të mos përdoren në të ardhmen⁵⁷.

Gjatë vizitës për ri-kontroll 4 persona vuanin dënimin disiplinor – drejtim në izolim në atë mënyrë që ishin vendosur nga dy veta në dy hapësira të repartit të paraburgimit të burgut. MPN-ja konstatoi kushte pjesërisht të përmirësuara në hapësirat në të cilat personat vuajnë dënimin disiplinor – izolim. Asnjë nga personat që vuajnë dënimin – izolim, nuk u ankuan për dhunë fizike ose keqtrajtim nga shërbimet e burgut. Tre persona konfirmuan se para dërgimit në izolim ishin kontrolluar nga mjeku, derisa një person ka thënë se nuk ka qenë (megjithatë MPN gjatë kontrollit të kartonit të tij shëndetësor konstatoi se i njëjti ishte kontrolluar nga mjeku, me ç'rast si shtojcë ndaj kartonit kishte mendim përkatës të mjekut).

Gjendjen me kushtet materiale në repartin e mbyllur MPN-ja e vlerësoi si shqetësuese dhe serioze. Sa u përket konstatimeve të vitit të kaluar nuk kishte ndonjë përmirësim, përkundrazi, MPN-ja konstatoi përkeqësim të gjendjes. Nyjet sanitare ishin në gjendje të shkatërruar dhe të shpërfillur, ndërsa nga to përhapej një erë e pakëndshme e urinës. Në këtë repart, si edhe në pjesët e tjera të burgut, ekziston mungesa e ujit (për shkak të problemeve me furnizimin me ujë dhe konsumimit të madh të ujit në këtë pjesë të komunës Shuto Orizarë, që në mënyrë serioze kontribuon për jo higjienën në këtë repart, e cila megjithatë, mund të çojë edhe deri te përhapja

⁵⁶ Nga Burgu Shkup u dërgua përgjigje se vendosja në këto dy hapësira bëhet për shkak të mosdërrimit dhe ekzistimit të një mundësie për përplasje fizike midis personave të caktuar të dënuar.

⁵⁷ Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve është njoftuar nga Burgu Shkup se është vepruar sipas sugjerimeve të dhëna.

e sëmundjeve infektuese midis personave të dënuar. MPN-ja si shqetësim serioz e potencoi problemin e mungesës së qasjes së vazhdueshme deri te uji i freskët për pije, duke i pasur parasysh temperaturat e larta verore. Përveç kësaj nga përgjigja e Burgut Shkup u vu në dukje se implementimi i rekomandimeve në masë të madhe varet nga sigurimi i mjeteve shtesë financiare, ndërsa respektimi i të drejtave të personave të privuar nga liria realizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.

Në përgjigjen e dërguar nga Burgu Shkup, për një pjesë të rekomandimeve të dhëna, drejtorja e burgut ka shprehur mospajtim, me shpjegimin se një pjesë e vërejtjeve të sugjeruara tashmë implementohen në këtë burg (në mënyrë përkatëse respektohet qëndrimi në ambient të hapur prej dy orësh, në burg janë siguruar aktivitete sportive-rekreative dhe edukative). Për shkak të mbrojtjes dhe mbikëqyrjes më të madhe në repartin e mbyllur, drejtorja e burgut ka siguruar pranimin fizik të pjesëtarëve të sektorit të sigurimit (në periudhën nga ora 22:00 deri në orën 08:00), duke pasur parasysh se ekipi i MPN-së gjatë vizitës për ri-kontroll ka marrë ankesa serioze për keqtrajtim fizik dhe detyrim për punë nga një pjese të personave të dënuar nga të dënuar të tjerë të vendosur në repartin e mbyllur.

Nga Drejtorja për Ekzekutimin e Sanksioneve u dërgua informacion se është në rrjedhë realizimi i projektit "Rikonstrukcioni institucioneve ndëshkuese-korrektuese në Republikën e Maqedonisë" me të cilin parashikohet ndërtimi i objekteve të reja në Burgun Shkup, ndërsa në këtë mënyrë parashikohet edhe plotësimi i standardeve për vendosjen e personave të privuar nga liria.

Gjatë vizitës për ri-kontroll të **Entit Edukues-Korrektues Tetovë**, Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi se pjesërisht janë realizuar ose nuk janë realizuar rekomandimet e dhëna gjatë vizitës së rregullt, të realizuar në vitin 2011. Në vitin 2011 MPN-ja si posaçërisht shqetësuese e veçoi gjendjen e konstatuar në repartin me ndikim të përforcuar për riedukim. Në Raportin e vitit 2011, u konstatua se reparti me ndikim të përforcuar për riedukim (RNPR) nuk i plotëson parakushtet themelore minimale dhe standardet për vendosje, i njëjti nuk ka madhësi përkatëse, nuk ka ndriçim përkatës ditor dhe ventilim, ndërsa hapësira nuk ka mobile përkatëse. Gjatë vizitës së MPN-së, në vitin 2012, u konstatua se dhoma e fjetjes, në të cilën më parë ishin vendosur të përkujdesurit, është rinovuar dhe e njëjta përdoret si dhomë e përbashkët për qëndrim ditor, në të cilën janë vendosur stola, tavolina si edhe TV, por personat edhe më tej janë të vendosur dhe e kalojnë natën në një mjedis krejt johuman. Për shkak të kushteve, në të cilat janë të vendosur personat e mitur, hapësirat që janë të fëlliqura, në të cilat nuk ka depërtim të mjaftueshëm të dritës dhe ventilim, si dhe nuk ka numër të mjaftueshëm të krevateve, MPN konstatoi se rekomandimet e dhëna nuk janë zbatuar.

Gjatë vizitës në vitin 2012, Mekanizmi Nacional Parandalues takoi vetëm edukatoren, e cila është përgjegjëse e turnit dhe e cila është e autorizuar nga drejtori të bëjë mbikëqyrje mbi punën e Entit Edukues-Korrektues Tetovë. MPN-ja e potencoi rëndësinë e pranisë më të shpeshtë të drejtorisë së Entit Edukues-Korrektues, duke pasur parasysh se në këtë institucion janë vendosur persona të kategorisë së pambrojtur dhe të rrezikshme dhe të cilët duhet të kenë një qasje të papenguar, nëse duan që në mënyrë të drejtëpërdrejtë të drejtohen për ndihmë ose për realizimin e një të drejte të caktuar, në përputhje me Rendin e shtëpisë dhe Ligjin për ekzekutim të sanksioneve.

Gjatë vizitës për ri-kontroll të Mekanizmit Parandalues Nacional ishin marrë ankesa për keqtrajtim fizik të personave të përkujdesur të vendosur në Repartin me ndikim të përforcuar edukues. Avokati i Popullit – MPN shprehu shqetësim për të dhënat e marra, duke pasur parasysh se edhe gjatë vizitës së mëparshme të Entit Edukues-Korrektues Tetovë shumica e fëmijëve, të cilët në atë kohë ishin të vendosur në Repartin me ndikim të përforcuar edukues, kanë pasur ankesa për sjelljen joadekuate ndaj tyre nga ana e shërbimeve të sigurisë, madje u ankuan edhe për përdorimin e forcës fizike.

Për personat të cilët kanë tentuar ose që e kanë lënduar veten, nga ana e EEK

u shqiptohen masa disiplinore "dërgim në qeli". Duke filluar nga aspekti human si edhe kujdesi i veçantë ndaj personave që duan të vetë-lëndohen, MPN-ja është e shqetësuar për këtë praktikë të Entit Edukues-Korrektues Tetovë dhe konsideron se për këta persona është e nevojshme një mbikëqyrje më intensive dhe ndihmë nga ana e mjekut të Entit, i cili duhet t'u ndihmojë për t'i tejkaluar fazat e vetëlëndimit, e jo personave t'u shqiptojë dënim disiplinor dhe të njëjtët të vihen në gjendje akoma më të vështirë.

Gjatë vizitës për ri-kontroll Mekanizmi Nacional Parandalues bëri këqyrje në kuzhinë. Kuzhina u has në gjendje jo të rregullt, me një numër më të madh insektesh në afërsi të enëve dhe erëzave të cilat përdoren për drekë, ndërsa dreka ishte e përgatitur pa përdorur një numër të mjaftueshëm të erëzave të nevojshme për atë lloj ushqimi. Ajo që mund të konstatohet është se gjendja me kuzhinën dhe ushqimin është në një gjendje më të vështirë sesa gjatë vizitës së parë të MPN-së të Entit Edukues-Korrektues Tetovë, kur u konstatua se higjiena është në nivel të kënaqshëm, ndërsa inventari, kazanët dhe objektet në të cilat përgatitet ushqimi mirëmbahen në mënyrë të rregullt dhe të njëjtat janë të përdorshme.

Gjatë vizitës për ri-kontroll MPN-ja konstatoi se procesi arsimor nuk realizohet në Entin Edukues-Korrektues Tetovë. Në vizitën e tij të parë u konstatua se e drejta e arsimit nuk realizohet në mënyrë siç parashikohet me rregullat ligjore, duke pasur parasysh arsimin e obligueshëm fillor dhe të mesëm. Ajo që veçanërisht është shqetësuese në pjesën e arsimit është njoftimi i shërbimeve deri te organet kompetente gjyqësore. Përkatësisht, gjatë kontrollit të dosjeve profesionale u konstatua informim jo i besueshëm i gjykatës për zbatimin e procesit të arsimit të personave të përkujdesur në EEK Tetovë.

Pas përfundimit të vizitës për ri-kontroll MPN-ja dërgoi 9 rekomandime deri te Enti Edukues-Korrektues si edhe 4 rekomandime deri te Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve. Njëkohësisht, u kërkua nga Drejtoria për Ekzekutim të Sanksioneve të zbatohet mbikëqyrje në pjesën e udhëheqjes së dosjeve profesionale dhe përgatitjes së raporteve deri te gjykata, me theks të veçantë informim për realizimin e procesit arsimor. Pas mbikëqyrjes së realizuar, Drejtoria për Ekzekutim të Sanksioneve e njoftoi MPN, se janë të saktë të dhënat e cekura dhe se dosje të caktuara profesionale përmbajnë njoftime me të cilat në mënyrë të gabuar informohet gjykata, në pjesën e zhvillimit të procesit arsimor të personave të përkujdesur në Entin Edukues-Korrektues Tetovë.

Në një pjesë të përgjigjeve të dërguara të drejtorisë së Entit Edukues-Korrektues Tetovë, u vërtetuan gjendjet negative me shpjegimin se ky institucion përpiqet të siguroj kushte normale të jetës, sidomos për personat e mitur të vendosur në Repartin me ndikim të përforcuar për riedukim, por se vet objekti nuk i plotëson standardet për vendosjen e personave të mitur të cilëve u shqiptohen masa nga Enti. Për personat e mitur, që janë në izolim, bëhet një mbikëqyrje shtesë, d.m.th. personat çdo ditë vizitohen nga mjeku, ndërsa mbikëqyrje të përforcuar ka edhe për personat që vetë-lëndohen. Në pjesën e ankesave, MPN-ja u informua se janë ndërmarr masa nga ana e Entit Edukues-Korrektues Tetovë, si dhe se janë dhënë sugjerime përkatëse deri te të punësuarit e Sektorit të Sigurimit.

Sa u përket gjendjeve të konstatuara Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve vuri në pah se, si Burgu Shkup ashtu edhe ky institucion, do të përfshihet me projektin "Rikonstruimi i institucioneve ndëshkuese-korrektuese në Republikën e Maqedonisë", me ç'rast do të ndërtohet një kompleks i ri me kapacitete për vendosje, kuzhinë, repart shëndetësor, qendër për vizita si edhe punëtori e klasa.

B. SHKALLA E REALIZIMIT TË REKOMANDIMEVE TË DHËNA


Gjatë realizimit të vizitave për ri-kontroll, MPN-ja bëri përzgjidhje të rekomandimeve, të cilat ua dërgoi organeve dhe institucioneve gjatë vizitave të realizuara të rregullta gjatë vitit 2011, ndërkaq për të cilat rekomandime MPN-ja konsideronte se në periudhën deri në realizimin e vizitës së ri-kontrollit duhej të zbatoheshin në mënyrë përkatëse në praktikë. Jo të gjitha rekomandimet e dërguara deri te vendet e privimit nga liria kanë qenë objekt i vlerësimit gjatë realizimit të vizitave për ri-kontroll.

Krahas vlerësimit të shkallës së realizimit të rekomandimeve, nga raportet e mëparshme të veçanta, gjatë realizimit të vizitave për ri-kontroll, MPN-ja në përputhje me gjendjet e reja të konstatuara dhe rekomandimet e konstatuara të përealizuara në mënyrë përkatëse dërgoi rekomandime të reja (rekomandime nga viti 2012), me qëllim të tejkalimit ose shmangies së rreziqeve të identifikuara dhe trajtimeve të cilat mund të çojnë deri në torturë ose në trajtim apo ndëshkim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues të personave të privuar nga liria.

Tabela – Shkalla e realizimit të rekomandimeve:⁵⁸

REKOMANDIME	SP Çair	SP Aerodrom	SP Draçevë	SP Gostivar	SP Kisela Vodë	Burgu Shkup	EEK Tetovë
Të përealizuara	6	3	1	2	3	4	5
Pjesërisht të realizuara	3	1	0	1	1	3	2
Të realizuara	0	3	3	4	2	0	3
Rekomandime të reja	8	7	5	7	7	19	12

Shkalla e realizimit të rekomandimeve të MPN-së



⁵⁸ Tabela paraqet pasqyrën e shkallës së realizimit të rekomandimeve nga ana e organit/institucionit – prezantohen në mënyrë të përmblëdhur të gjitha rekomandimet e dhëna në lidhje me vizitën e vendit të privimit nga liria, pa dallim nëse rekomandimi i është drejtuar organit/ institucionit ose ministrisë përkatëse.

Përfundim: Gjatë vizitave për ri-kontroll në vendet e privimit nga liria, MPN-ja konstatoi se pjesa më e madhe e rekomandimeve nuk zbatohen ose zbatohen vetëm pjesërisht (gjithsej 35 rekomandime), ndërsa vetëm 15 rekomandime janë zbatuar në tërësi nga ana e organeve përkatëse, institucioneve dhe ministrive përkatëse. MPN-ja identifikoi edhe rreziqe dhe trajtime të reja, në përputhje me të cilat pas vizitave për ri-kontroll dërgoi gjithsej 65 rekomandime për tejkalimin e mangësive të reja dhe rekomandime paraprakisht të pazbatuara, në drejtim të mbrojtjes së personave të privuar nga liria, nga tortura ose trajtimi apo ndëshkimi tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues dhe rritjes së shkallës së realizimit të të drejtave të tyre.

4 MENDIME DHE INICIATIVA TË PARASHTRUARA

A. MENDIME DERI TE MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Në vitin 2012, Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN), në përputhje me nenin 19 (c) të Protokollit Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese, Ligjin për Avokatin e Popullit dhe Rregulloren për punë të Avokatit të Popullit, ka parashtruar disa mendime deri te Ministria e Punëve të Brendshme për ndryshimin dhe plotësimin e akteve nënligjore (rregullore) dhe akteve interne të kësaj ministrie.

Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional në mars të vitit 2012 ka parashtruar **Mendime** deri te Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë në drejtim të ndryshimit dhe plotësimit të **Rregullores për normativat dhe standardet e përgjithshme të cilat duhet t'i plotësojnë hapësirat për mbajtje të personave në stacionet policore me kompetencë të përgjithshme**. AP – MPN në këtë drejtim ka shprehur kënaqësinë e tij nga miratimi i Rregullores për normativat dhe standardet e përgjithshme të cilat duhet t'i plotësojnë hapësirat për mbajtjen e personave dhe konsideron se unifikimi i normativave për hapësirat e mbajtjes së personave në stacionet policore me kompetencë të përgjithshme, në përputhje me standardet e vendosura më parë të cilat i respektojnë të drejtat themelore të njeriut, në mënyrë të konsiderueshme do të kontribuojë për zvogëlimin e rreziqeve nga tortura e mundshme ose trajtimi apo ndëshkimi tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues i personave të mbajtur. Mendimi, në vetvete i përfshin standardet minimale për vendosjen e personit të mbajtur, të miratuar nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT), si edhe shembujt pozitivë dhe përvojat e vendeve të rajonit.

Mekanizmi Parandalues Nacional, konsideron se mbajtja nuk duhet të zbatohet në hapësirat e bodrumit, e as pranë ose në afërsi të hapësirave të magazinës ose hapësirave në të cilat ruhen armët e policisë. Distanca, midis mureve të hapësirës së njëjtë, duhet të jetë më së paku 2m²,⁵⁹ ndërsa hapësira në mënyrë përkatëse duhet t'i plotësojë edhe masat e domosdoshme të mbrojtjes-sigurisë. Vëmendje e veçantë duhet t'u përkushtohen masave të mbrojtjes-sigurisë dhe materialeve të ndërtimit të tualetit, ku duhet të mungojnë çfarëdo lloje sendesh që do të paraqesin rrezik për shëndetin dhe jetën e personit të mbajtur dhe të nëpunësve policorë. Prandaj, MPN-ja konsideron se guaska e tualetit duhet të jetë e prodhuar nga materiali metalik (sipas shembullit të hapësirave të reja në SP Tetovë), kazani i tualetit gjithmonë duhet të jetë i ngulitur në murin nën beton dhe i menaxhuar në prekje (sipas shembullit të hapësirave të tjera të SP Tetovë dhe SP Kisella Vodë), pasqyra të jetë e ngulitur në mur dhe të jetë e prodhuar nga material i pathyeshëm (sipas shembullit të hapësirave të reja të SP Kisella Vodë), ndërsa në nyjet sanitare të mungojë çfarëdo lloji i sendeve të tjera, të cilat do të paraqesin rrezik për shëndetin dhe jetën e personit (dorëza metalike, zorrë dushi etj.).

Hapësira për mbajtje duhet të ketë ndriçim të drejtpërdrejtë ditor, si dhe ven-

⁵⁹ Duke i pasur parasysh rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT).

tilim përkatës natyror dhe artificial dhe ngrohje përkatëse, por edhe t'i plotësojë parakushtet e domosdoshme me qëllim që personi i mbajtur papengesë të mund ta realizojë të drejtën e pushimit gjatë natës, por edhe të mundësohet video-mbikëqyrja gjatë orëve të natës. Në çdo stacion policor me kompetencë të përgjithshme, hapësirat e mbajtjes duhet të jenë të shënuara me numra, ndërsa me rregulloren e njëjtë në mënyrë përkatëse duhet të përcaktohen edhe normativat dhe standardet e përgjithshme për hapësirat për bisedë me personat e privuar nga liria. MPN-ja konsideron se në drejtim të realizimit të plotë të normativave dhe standardeve të Rregullores, në praktikë duhet të përcaktohen afate të qarta për ndërtimin ose para-adaptimin e hapësirave të mbajtjes dhe të parashikohen implikimet buxhetore.

Avokati i Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional në bazë të të dhënave për konstatimet negative dhe njohurive për mangësitë, në pjesën e trajtimit dhe respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, deri te të cilat MPN ka ardhur pas 24 vizitave të realizuara parandaluese (të rregullta dhe për ri-kontroll) të stacioneve policore me kompetencë të përgjithshme, gjatë muajit gusht të vitit 2012, ka përpiluar dhe parashtruar **Mendim** deri te Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë në drejtim të ndryshimit dhe plotësimit të rregulloreve si vijojnë:

- **Rregullore për kryerjen e punëve policore;**
- **Rregullore për veprimin e nëpunësve policorë me sendet përkohësisht të konfiskuara dhe të gjetura dhe**
- **Procedurave Standarde Operative për mbajtjen dhe trajtimin e personave të mbajtur**

Mekanizmi Parandalues Nacional, gjatë hartimit të këtij propozimi udhëhiqej nga të drejtat e garantuara të personave të privuar nga liria dhe detyrat e shtetit që dalin nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë dhe dokumentet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, të miratuara nga ana e Republikës së Maqedonisë, fillimisht, duke u udhëhequr nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (KEMDNJ), Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike (PNDCP) dhe Konventa e KB-ve Kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve tjera Brutale, Jon-jerëzore ose Nënçmuese, si edhe nga dokumentet e tjera ndërkombëtare dhe standardet me të cilat në mënyrë më të detajuar rregullohet trajtimi dhe realizimi i të drejtave të personave të privuar nga liria.

Në lidhje me **Rregulloren për mënyrën e kryerjes së punëve policore**, Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN) ka dhënë mendim, se për personat që janë të privuar nga liria dhe të cilët mbahen në stacion policor duhet të jetë përgjegjës një nëpunës i veçantë policor – personi për pranim e jo atë rol ta kryej udhëheqësi i turnit, i cili në përputhje me Ligjin për polici ka edhe detyra të tjera të cilat kanë të bëjnë me realizimin e autorizimeve policore. Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional, pas 24 vizitave të realizuara të rregullta dhe të ri-kontrollit të stacioneve policore me kompetencë të përgjithshme, konstatoi se zgjidhja ekzistuese me të cilën udhëheqësi i turnit caktohet si nëpunës policor për pranimin e personave nuk është përkatës dhe i përshtatshëm. MPN-ja, në shumicën e rasteve, sidomos në ato stacione policore që mbulojnë një territor më të madh dhe ku vëllimi i punëve policore është i konsiderueshëm, konstatoi se udhëheqësi i turnit nuk ka mundësi t'i realizojë edhe detyrat e nëpunësit të pranimit, duke pasur parasysh sigurinë e personit të privuar nga liria dhe realizimin e të drejtave të tij. Në drejtim të sigurimit të mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe të menjëhershme mbi personat e arrestuar dhe të mbajtur në stacion policor, ndërkaq me qëllim të mbrojtjes së tyre nga rreziqet e mundshme të padëshiruara për sigurinë e tyre dhe realizimin e plotë të të drejtave të tyre, si dhe rritjen e përgjegjësisë së drejtpërdrejtë gjatë trajtimit të kësaj kategorie personash, MPN-ja konsideron se roli i nëpunësit policor për pranim duhet të ndahet nga funksioni udhëheqësi i turnit. Ky rol duhet t'i besohet një nëpunësi policor të tra-

jnuar në mënyrë përkatëse, i cili do të punojë dhe veprojë vetëm me personat e privuar nga liria, më saktë të gjithë ata persona të cilëve u është kufizuar liria e lëvizjes: persona që janë të thirrur, të shoqëruar (në raste të personave të mitur), të arrestuar ose të mbajtur në stacion policor.

MPN-ja në drejtim të parandalimit të torturës dhe mbrojtjes së rritur të integritetit të personave që privohen nga liria kërkoi që biseda me personat e arrestuar dhe të mbajtur të realizohet gjithmonë në një hapësirë të caktuar në mënyrë të veçantë për marrje në pyetje dhe jo në hapësirat zyrtare të nëpunësve policorë dhe inspektorëve. Përveç të drejtave themelore të personave të privuar nga liria, MPN-ja përmes mendimit të dërguar sugjeroi se nevojitet rregullimi i së drejtës së vaktit dhe qasjes deri te uji i freskët për pije gatë periudhës së mbajtjes në stacionin policor. Më tej, MPN-ja kërkoi që kjo Rregullore të jetë në përputhje me dispozitat e Ligjit për të drejtën e të miturve, në pjesën e detyrimit për njoftimin e personave dhe organeve gjatë mbajtjes së të miturit. Bisedën me të miturin gjithmonë duhet ta zhvillojë vetëm nëpunësi policor për delikucencë të të miturve pa prani të nëpunësve tjerë policorë. Njëkohësisht, i mituri duhet të mbahet në hapësirën e mbajtjes së të miturve, siç parashikon neni 109 i Ligjit për të drejtën e të miturve.

MPN-ja konsideron se nëse personi, pas ndërprerjes së mbajtjes, nuk paraqitet para gjyqtarit hetues duhet të njoftohet se ka të drejtë që brenda 30 ditëve, nga dita e lëshimit në liri, të kërkojë nga gjyqtari hetues i gjykatës kompetente ta shqyrtojë ligjshmërinë dhe atë ta verifikojë me aktvendim të veçantë. Në rast të mbajtjes së personit nën ndikim të alkoolit dhe substancave të tjera psikotropike, MPN-ja kërkoi që në mënyrë të detyrueshme të thirret mjeku, i cili vërteton se personi mund vendoset në hapësirën e mbajtjes pa rrezikuar shëndetin dhe jetën e vet personit.

Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional gjatë realizimit të vizitave të rregullta dhe për ri-kontroll në stacionet policore me kompetencë të përgjithshme e konstatoi nevojën edhe për ndryshimin ose plotësimin e formularit 7 (**Shënimi zyrtar për arrestimin e personit pa urdhër me shkrim nga gjykata**) dhe 7-a (**Proces-verbal për mbajtjen e personit**) nga Rregullorja për mënyrën e kryerjes së punëve policore.

MPN-ja nëpërmjet mendimit të dërguar kërkoi që në formularin 7 (Shënimi zyrtar për arrestimin e personit pa urdhër me shkrim nga gjykata) në mënyrë të qartë dhe të saktë, përveç datës dhe kohës, të shënohet edhe vendi (adresa ose vendi i përafërt) i privimit nga liria, më saktë vendi nga ku personi është privuar në stacionin policor. MPN-ja konsideron se vetëm në këtë mënyrë do të sigurohet një rrjedhë e logjikshme kohore e ngjarjeve – do të përcaktohet saktë koha dhe vendi nga i cili personi është arrestuar nga ana e nëpunësit policor dhe koha kur personi i arrestuar i është dorëzuar nëpunësit policor për pranim. Vetëm në këtë mënyrë saktë do të përcaktohet koha e nevojshme për sjelljen (transportimin) e personit nga vendi i privimit nga liria deri te njësia organizuese e MPB-së, ku personi i dorëzohet nëpunësit për pranim. MPN-ja kërkoi që në vend të shënimit nga ana e personit zyrtar të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ky shënim zyrtar të ofrojë përshkrim të detajuar të ngjarjes.

Më tej, MPN-ja kërkoi që në procesverbalin për mbajtje (formulari 7-a) gjithashu në mënyrë të saktë të ceket data, koha, rruga dhe vendi ku personi është privuar nga liria dhe njëkohësisht në formular të shënohet emri dhe mbiemri i personit/personave që kujdesen për realizimin e të drejtave dhe për sigurinë e personit të mbajtur gjatë kohëzgjatjes së mbajtjes së tyre në stacionin policor. MPN-ja konsideron se në të njëjtin formular duhet të ceket me emër dhe mbiemër nëpunësi policor i cili e ka miratuar mbajtjen e personit.

Mekanizmi Parandalues Nacional, nëpërmjet mendimit të dërguar, sugjeroi se Rregullorja për mbajtjen e personit në mënyrë të detyrueshme duhet të plotësohet në pjesën e përcaktimit të gjendjes psikofizike të personit. Në këtë drejtim nëpunësi për pranim, në përputhje me konceptin momental të procesverbalit, konstaton mos/

ekzistimin e lëndimeve të dukshme dhe mos/ekzistimin e shenjave të dukshme të sëmundjes, çrregullimit mendor, gjendjen e alkoolizuar ose veprimin e narkotikëve. MPN-ja konsideron se në procesverbalin për mbajtje (formulari 7-a) në mënyrë të detyrueshme duhet të parashikohet obligimi për nëpunësin për praninë, i cili do të shënojë që personi, po që se i njëjti manifeston shenja të sëmundjes ose përgjigjet pozitivisht në çështjen për ekzistimin e sëmundjes së caktuar, merr medikamente të caktuara, si dhe intervalin kohor kur ai i merr këto medikamente, por edhe nëse personi i mban me vete medikamentet dhe nëse është nën mbikëqyrje mjekësore. Nëpunësi për praninë, në rast të përgjigjes pozitive, sa i përket nevojës për marrjen e medikamenteve të rekomanduara nga mjeku, detyrimisht e thërret mjekun.

MPN-ja, duke pasur parasysh praktikën e ndryshme të mënyrës së plotësimit të formularit 7-a (procesverbali për mbajtjen e personit) nga ana e nëpunësve policorë për praninë, kërkoi nga Ministria e Punëve të Brendshme të miratojë **udhëzimin për plotësimin e formularit 7-a**, në ç'mënyrë do ta unifikojë veprimin e nëpunësve policorë për praninë, me çka do të pamundësohen dallimet në kuptimin e terminëve dhe plotësimin e procesverbalit dhe do të zvogëlohet rreziku nga trajtimi i mundur i papërshtatshëm, çnjerëzor ose degradues me personat e mbajtur. MPN-ja kërkoi që udhëzimi për mënyrën e plotësimit të jep udhëzime të qarta me qëllim të sigurimit të rrjedhës logjike kohore të ngjarjeve, në drejtim të sigurimit të mostejkalimit të afatit kohor maksimal të mbajtjes nga 24 orë për personin e rritur ose 12 orë për personin e mitur, llogaritur nga momenti i privimit nga liria.

Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional, i rekomandoi Ministrisë së Punëve të Brendshme të mbajnë trajnime të detyrueshme për të gjithë nëpunësit policorë për praninë, në drejtim të njohjes së tyre me të drejtat e personave të arrestuar dhe të mbajtur, detyrat që dalin në drejtim të sigurimit të sigurisë së personave të privuar nga liria për kohëzgjatjen e arrestimit dhe mbajtjes së tyre, si edhe për mënyrën e plotësimit të formularëve përkatës (shënimet zyrtare dhe procesverbalet), me qëllim të unifikimit të trajtimit. MPN-ja konsideron se kjo detyrë, që del nga neni 10 i Konventës së KB-ve Kundër Torturës dhe Trajtimit apo Ndëshkimit tjetër Brutal, Jonjerëzor ose Nënçmues duhet të realizohet në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme, ndërsa përveç nëpunësve policorë për praninë duhet të përfshihen edhe nëpunësit e tjerë të cilët realizojnë kontakt me personat e mbajtur në përputhje me nenin 25, paragrafin 7 të Rregullores për mënyrën e kryerjes së punëve policore.

MPN-ja kërkoi plotësimin e Rregullores në drejtim të miratimit të formularëve të rinj nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, d.m.th., kërkoi të inkuorprohen formularë të rinj, dhe atë: *Shënimi zyrtar për ndihmë mjekësore të kërkuar dhe të ofruar për personin e arrestuar ose të mbajtur; Shënimi zyrtar/procesverbal për realizimin e së drejtës së ushqimit dhe ujit dhe Shënimi zyrtar për realizimin e kontrollit të menjëhershëm (mbikëqyrja e drejtpërdrejtë) të personit të mbajtur*. MPN-ja konsideron se përmes inkuorporimit të këtyre tre formularëve në mënyrë më precize do të rritet shkalla e respektimit të të drejtave të garantuara të personave të privuar nga liria.

MPN-ja konsideron se Rregullorja për mënyrën e kryerjes së punëve policore⁶⁰ në mënyrë shtesë duhet të përfordhet me një sistem të masave adekuate dhe efikase me qëllim të parandalimit të nëpunësve policorë për keqpërdorimin e armës që u është dhënë me qëllim të kryerjes së detyrimeve të tyre zyrtare⁶¹. MPN-ja e përkujtoi Ministrinë e Punëve të Brendshme me aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin e Sashko Georgievit kundër Republikës së Maqedonisë në pjesën se "...nga shtetet pritet të vendosin standarde të larta profesionale në kornizat e sistemeve të tyre për zbatimin e ligjit dhe të sigurojnë se personat që punojnë në ato sisteme i plotësojnë kriteret e kërkua (shih, *mutatis mutandis*, Abdullah Yilmaz, i cituar

⁶⁰ Njëpërmjet ndryshimeve të nenit 223-227 të Rregullores.

⁶¹ Sashko Georgiev kundër Republikës së Maqedonisë (Ankesa nr. 49382/06), Aktgjykimi i KEDNJ-it më 19.04.2012.

më lart, qëndrimet 56-57). Sidomos, kur forcat policore pajisen me armë, jo vetëm që duhet t'u jepen trajnimet e nevojshme teknike, por edhe seleksionimi i agjentëve të cilët kanë leje për mbajtje të armës së tillë, duhet të jetë objekt i një kontrolli të veçantë⁶².

Në këtë drejtim, duke e pasur parasysh se në Aktgjykimin në fjalë gjykata konstatoi se shteti e ka shkelur nenin 2 të KEDNJ (e drejta e jetës), ndërkaq duke e marrë parasysh se në përputhje me nenin 31 të Ligjit për polici, nëpunësi policor është i autorizuar për të mbajtur armë, MPN-ja konsideron se duhet të ndërmerren masa parandaluese shtesë në drejtim të:

a) forcimit të sistemit të kontrollit të rregullt mbi aftësitë psikofizike të nëpunësit policor,

b) implementimit të një sistemi të qartë të mbajtjes së armës gjatë dhe jashtë kohës së rregullt të punës së nëpunësve policorë, dhe

c) implementimit të një sistemi të qartë të ruajtjes së armës në hapësirat e stacionit policor.

Në lidhje me **Rregulloren për veprimin e nëpunësve policorë me sende përkohësisht të konfiskuara dhe të gjetura**, MPN-ja, nga përvoja e deritanishme, konstatoi raste të veprimit jo të rregullt të ruajtjes së sendeve përkohësisht të konfiskuara në zyrat e inspektorëve në disa stacione policore, me çka mënyrën e këtyre të ruajtjes së sendeve të konfiskuara e konsideron si rrezik për sigurinë dhe shëndetin e personave të arrestuar dhe të mbajtur. MPN-ja konsideron se duhet të theksohet detyra e nëpunësve policorë dhe inspektorëve që në të gjitha rastet sendet përkohësisht të konfiskuara t'i dorëzojnë për ruajtje në hapësirën përkatëse për atë qëllim, ndërsa në asnjë rast të mos ruhen në hapësirat e zyrave të tyre. Në këtë drejtim, MPN-ja propozoi, që çdo send i konfiskuar të ruhet në një hapësirë të pajisur në mënyrë të veçantë në stacionin policor me kompetencë të përgjithshme dhe i njëjti të evidentohet dhe shënohet në mënyrë përkatëse. Hapësira në të cilën dorëzohen për t'u ruajtur sendet përkohësisht të konfiskuara nuk duhet të jenë në afërsi të menjëhershme të hapësirave për mbajtjen e personave dhe hapësirave për bisedë me personat e mbajtur. Vetëm nëpunësi policor, përgjegjës për ruajtjen dhe përgjegjës për udhëheqjen e evidencës së sendeve përkohësisht të konfiskuara, duhet të ketë qasje deri të hapësira për ruajtjen e këtyre sendeve. Arma, përkohësisht e konfiskuara, ruhet e mbyllur në një kasafortë të veçantë metalike në përbërje të hapësirës për ruajtjen e këtyre sendeve.

MPN-ja në mënyrë shtesë konsideron se MPB-ja duhet të jep udhëzime dhe të zbatojë trajnime për të gjithë nëpunësit policorë përgjegjës për udhëheqjen e evidencës dhe ruajtjen e sendeve përkohësisht të konfiskuara, me çka do të unifikohet veprimi dhe do të zvogëloheshin rreziqet nga keqpërdorimet e mundshme të këtyre sendeve në drejtim të përdorimit të tyre të mundshëm, në kundërshtim me qëllimet e Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimit apo Ndëshkimit tjetër Brutal, Jonjerëzor ose Nënçmues.

MPN-ja dha mendimin e vet edhe për ndryshimin dhe plotësimin e **Procedurave Standarde Operative për mbajtjen dhe trajtimin e personave të mbajtur**. Ky dokument duhet të plotësohet në mënyrë që do të rregullohet çështja për videombikëqyrjen e personit derisa ai është në tualet, duke pasur parasysh sigurinë dhe privatësinë e tij. E drejta e privatësisë dhe dinjitetit njerëzor nuk lejojnë prani të nëpunësve policorë, derisa personi gjendet në tualet.

MPN-ja kërkon që në këtë dokument të shënohet qartë se kontrolli mund të kryhet vetëm nga nëpunësit policorë të gjinisë së njëjtë, ndërsa gjatë kontrollit të merit parasysh integriteti personal dhe e drejta e privatësisë së personit. MPN-ja kërkon që sendet e konfiskuara të personit të mbajtur, derisa personi është i vendosur në

⁶² Sashko Georgiev kundër Republikës së Maqedonisë (Ankesa nr. 49382/06), Aktgjykimi i KEDNJ-it më 19.04.2012, paragrafi 51

hapësirën e mbajtjes, të ruhen në një hapësirë të veçantë të rregulluar, në të cilën ka mbikëqyrje mbi personin për praninë.

Më tej, nëse i mbajturi është dukshëm i lënduar ose ankohet në lëndim ose dhimbje, në mënyrë të detyrueshme duhet të thirret mjeku. Nëse i mbajturi ka lëndime më të lehta ose më të rënda trupore, në këtë rast të thirret ambulanca. Derisa të arrijë ambulanca, ndihma e parë t'i jepet nga ana e nëpunësit policor, i cili është i trajnuar për dhënien e ndihmës së parë.

Mekanizmi Parandalues Nacional konsideron se, në përputhje me parimet e trajtimit njerëzor me personat e privuar nga liria dhe të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, personi i mbajtur ka të drejtë për ushqim dhe qasje deri te uji i freskët për pije. MPN-ja rekomandoi në mënyrë plotësuese se e drejta e ushqimit dhe ujit duhet të jetë e mbrojtur, ndërsa realizimi i së njëjtës të rregullohet me ligj, së bashku me të drejtat e tjera të cilat janë të garantuara për personat e privuar nga liria, dhe jo me akt nënligjor ose të brendshëm të MPB-së. MPN-ja konsideron se ushqimi duhet të sigurohet nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Brendshme, për të cilin qëllim MPB-ja e RM-së duhet të parashikojë paragraf të veçantë buxhetor.

Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional konsideron se me rëndësi të veçantë dhe e domosdoshme është të rregullohet mënyra e qasjes deri te uji i freskët për pije. MPN-ja kërkoi nga MPB-ja të sigurojë një buxhet të veçantë me të cilin do të lejohet kjo nevojë nëpërmjet furnizimit të ujit në shishe për pije për personat e mbajtur në stacion policor.

Përveç vërejtjes për rregullimin e çështjes së sigurimit të ujit dhe ushqimit për personat e mbajtur, MPN-ja dha mendimin e vet edhe për nevojën e thirrjes së mjekut, në rast të mbajtjes së një personi nën ndikim të alkoolit ose substancave të tjera psikotropike, që duhet të vërtetohet se personi mund të jetë i vendosur në hapësirën për mbajtje, pa ndonjë rrezik për shëndetin dhe jetën e personit.

Në mënyrë të veçantë theksoi se në hapësirat, ku është e vendosur video-mbikëqyrja dhe ku mbahen personat, duhet të vendoset një lajmërim përkatës për video-mbikëqyrjen dhe për kryerjen e video-mbikëqyrjes duhet të informohet edhe personi i mbajtur, duke pasur parasysh standardet vendase dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale.

B. MENDIME DERI TE MINISTRIA E DREJTËSISË

Në bazë të nenit 30 të Ligjit për Avokatin e Popullit dhe nenit 19 të Rregullores për punën e Avokatit të Popullit, ndërsa në përputhje me kompetencat që dalin nga neni 3 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Avokatin e Popullit, në lidhje me nenin 19 (c) të Protokollit Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimin apo Ndëshkimit tjetër Brutal, Jonjerëzor dhe Nënçmues, Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN) paraqiti **Mendim** edhe deri te Ministria e Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë në lidhje me **Propozimin e Ligjit për të drejtat e fëmijëve**.

Mekanizmi Parandalues Nacional konsideron se kjo iniciativë do të kontribuojë për përmirësimin e cilësisë së këtij ligji në drejtim të zvogëlimit të rreziqeve nga tortura e mundshme ose trajtimi tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues me fëmijët e privuar nga liria. Njëkohësisht, AP – MPN konsideron se në këtë Propozim të Ligjit për të drejtat e fëmijëve, duhet të forcohen mekanizmat për mbajtje dhe mbikëqyrje mbi fëmijët e privuar nga liria, në përputhje me rregullat standarde minimale të KB-ve për administrimin e të drejtave të të miturve (të ashtuquajtura Rregullat e Pekinit)⁶³. Përkatësisht me nenin 116 nuk përcaktohet nëpunësi policor që do ta zbatojë procedurën me fëmijët gjatë thirrjes, shoqërimit ose mbajtjes së tij në stacionin policor, por i njëjtë vetëm jep udhëzime sipas dispozitave të Ligjit për polici. MPN-ja konsideron se me zgjidhjen e këtillë nuk realizohet mbrojtja shtesë e fëmijës në procedurën para Ministrisë së Punëve të Brendshme, sepse Ligji për polici edhe pse parashikon se autorizimet policore ndaj personave të mitur duhet t'i përdorin nëpunësit me autorizim të veçantë, megjithatë, lejohet që në situata të caktuara autorizimet policore ndaj personave të mitur të mund t'i përdorin edhe nëpunësit e tjerë policorë. Me këtë lihet hapësirë për interpretim të gjerë të fjalëve: "situata të jashtëzakonshme" nga paragrafi 2 i nenit 37 të Ligjit për polici.

MPN-ja gjatë vizitave të rregullta dhe për ri-kontroll të stacioneve policore me kompetencë të përgjithshme, me autorizime për të mbajtur persona, konstatoi se një pjesë e caktuar e tyre nuk kanë përcaktuar inspektor të veçantë për delikucencë të të miturve, që do të ishte i trajnuar në mënyrë përkatëse për veprim të tillë. Prandaj, MPN-ja kërkon zbatimin e plotë të këtij standardi ndërkombëtar-ligjor drejtpërdrejtë në Ligjin e të drejtave të fëmijëve, duke e pasur parasysh qëllimin e këtij ligji – harmonizimin me standardet ndërkombëtare për avancimin e legjislacionit të fëmijëve, përmirësimin dhe përparimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.

Në Republikën e Maqedonisë, në një numër të caktuar të stacioneve policore, bisedën me fëmijën, për të cilin ekzistojnë baza për dyshim se ka bërë një veprim i cili me ligj parashikohet si vepër penale, e zbaton nëpunësi policor i trajnuar për trajtimin e të miturve në prani të nëpunësit policor që punon në problematikën përkatëse. Vetëm në një numër të caktuar të rasteve, biseda realizohet vetëm nga ana e nëpunësit policor për trajtim me të miturit pa prani të zyrtarëve të tjerë. Në përputhje me analizat e bëra dhe të dhënat të cilat MPN-ja i ka në dispozicion, gjendja e tillë kryesisht është për shkak të dy arsyeve: jo në çdo stacion policor ka të punësuar inspektor të veçantë për delikucencë të të miturve dhe jo në çdo stacion policor kushtet materiale lejojnë realizim të bisedës me fëmijë në mungesë të zyrtarëve të tjerë. D.m.th., në shumicën e stacioneve policore, në mënyrë të veçantë inspektorët e trajnuar nuk kanë hapësirën e tyre zyrtare, por të njëjtën e ndajnë me inspektorët policorë për krime të përgjithshme ose ekonomike. Vetëm një nga 38 stacionet policore, të cilat sipas Vendimit të Ministrit të Punëve të Brendshme kanë autorizim për të mbajtur persona, ka hapësirë të veçantë për realizimin e bisedës me personin e mitur (SP Kisella Vodë), ndërsa në një stacion tjetër policor, gjatë vizitës së MPN-së, në procedurë ishte riadaptimi i një hapësire të caktuar, e cila në të ardhmen do të përdoret për realizimin e

⁶³ art.12.1 of the United Nations Standard Minimum Rules for the Administration of Juvenile Justice ("The Beijing Rules"), adopted by General Assembly resolution 40/33 of 29 November 1985.

bisedave me fëmijët (SP Dibër). Në këtë drejtim, MPN-ja konsideroi se propozim-ligji duhet të plotësohet në atë mënyrë që biseda me fëmijën të realizohet vetëm nga ana e nëpunësit policor të trajnuar në mënyrë përkatëse për këtë qëllim, ndërsa në mungesë të nëpunësve të tjerë policorë.

MPN-ja, me këtë Mendim, kërkoi të realizohet konstruksioni financiar i nevojshëm për ndërtimin e hapësirave të pajisura në mënyrë të veçantë për mbajtjen e fëmijëve në stacionet policore me kompetencë të përgjithshme. Në përputhje me analizën e vizitave parandaluese të MPN-së, vetëm dy stacione policore (SP Veles dhe SP Kisella Vodë) kanë nga një hapësirë të pajisur në mënyrë të veçantë për mbajtjen e personit të mitur, e cila është e ndryshme nga hapësira e mbajtjes së personave të moshës madhore.

MPN-ja dha mendimin e vet sa i përket përkufizimit se çka paraqet interes më i mirë për fëmijën, me ç'rast në bazë të njohurive nga vizitat e realizuar është e nevojshme të konstatohet se: "Interesi më i mirë i fëmijës kërkon që ai të mos jetë vazhdimisht dhe tërësisht i vetmuar dhe i ndarë, gjë që do të ndikonte negativisht mbi zhvillimin e tij normal psiko-fizik". Vendosja e fëmijëve në paraburgim, ndaras nga personat e moshës madhore është standard dhe detyrim ndërkombëtar-ligjor, i cili del kryesisht nga neni 10 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Megjithatë, në raste të caktuara, vetëm kur këtë e kërkon interesi më i mirë i fëmijës, MPN-ja konsideron se duhet të lejohen përjashtime, të cilat kanë të bëjnë vetëm me mundësimin e kontakteve ditore dhe të përkohshme me persona më të ri të rritur të zgjedhur me kujdes. Këto përjashtime do t'u dedikoheshin vetëm pjesës së kontakteve dhe përfshirjes në aktivitete të përbashkëta dhe jo edhe aspektit të vendosjes së fëmijës.

MPN-ja konsideron se në afat të gjatë, privimi i fëmijës nga liria, duke përfshirë këtu edhe kryerjen e masës së paraburgimit, duhet të realizohet vetëm në institucione të veçanta për fëmijë të privuar nga liria, që përfshijnë personel të trajnuar dhe politika e praktika të veçanta të cilat në qendër të vëmendjes së tyre do ta kenë trajtimin me fëmijët.

Duhet të theksohet se Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional për të gjitha **mendimet e dërguara deri te Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë nuk ka marrë përgjigje kthyese**, me çka Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional nuk ka këqyrje mbi shkallën e pajtueshmërisë dhe pranimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të propozuara.

C. MENDIME DERI TE ORGANET DHE INSTITUCIONET

Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional në bazë të gjendjeve të konstatuara në raportet e veta të veçanta kërkoi ndryshime në Rregulloren e Rendit të shtëpisë në Qendrën e Pranimit të të Huajve dhe ndryshime në Rregulloren për kryerjen e video-mbikëqyrjes në burgun Manastir.

Me raportin e veçantë të Avokatit të Popullit – Mekanizmit Parandalues Nacional për vizitën e Qendrës së Pranimit të të Huajve, kërkoi ndryshime në Rregulloren e Rendit të shtëpisë së Qendrës së Pranimit. Mekanizmi Parandalues Nacional sugjeroi kontroll të detyrueshëm mjekësor të personit, përkatësisht pas pranimit të tij në Qendër kontrolli të zbatohet brenda 24 orëve. Njëkohësisht, MPN-ja kërkoi rritjen e kohëzgjatjes së shëtitjes ditore në ambient të hapur nga një në dy orë, duke përdorur standardin e njëjtë tashmë të caktuar me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve. Më tej, AP – MPN kërkoi të përcaktohen qartë kushtet e veçanta nën të cilat i huaji, i vendosur në Qendër, mund të përdor telefon, si dhe të rritet kohëzgjatja e vizitës në një orë. MPN-ja konsideron se izolimi në një hapësirë të veçantë duhet të përcaktohet me Ligjin për polici, si një mjet detyrimi, ndërsa me këtë rregullore në mënyrë shtesë të rregullohen kushtet dhe mënyra e përdorimit të izolimit.

Në përgjigjen e MPB-së së RM-së pas dorëzimit të raportit, Ministria e njoftoi AP – MPN se është kërkuar mendim nga shërbimet kompetente të MPB-së për rishikimin e nevojës dhe arsyeshmërisë për ndryshimet në Rregullore. AP – MPN deri te MPB-ja dërgoi edhe një kërkesë të re për informimin se në ç'masë Ministria i pranon ndryshimet e propozuara të Rregullores së Rendit të shtëpisë, ndërsa për të njëjtën u informua se ndryshimet e propozuara të Rregullores për Rendin e shtëpisë të Qendrës për Pranimin e të Huajve janë pranuar dhe janë në procedurë të implementimit.

MPN-ja dërgoi kërkesë deri te drejtorja e Burgut Manastir ndryshimin e Rregullores për mënyrën e kryerjes së video-mbikëqyrjes, përkatësisht video-mbikëqyrja të përjashtohet nga dhomat e gjumit të repartit të pranimit dhe repartit të mbyllur (neni 2 i Rregullores). Në përgjigjen e drejtorit të INK Burgu Manastir, MPN-ja u njoftua se është bërë ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores, në përputhje me kërkesën dhe njëkohësisht kamerat ishin të larguar nga këto dy hapësira për vendosjen e personave të dënuar⁶⁴.

⁶⁴ Më shumë për këtë kërkesë dhe analizë të gjendjes mund të lexohet në pjesën e përshkrimit të gjendjeve të hasura në institucionet ndëshkuese-korrektuese.

5 KATEGORITË E PERSONAVE TË MARGJINALIZUAR DHE TË PAMBROJTUR NË VENDET E PRIVIMIT NGA LIRIA

Romët e privuar na liria

Në mënyrë të veçantë është vulnerabile gjendja dhe pozita e romëve në vendet e privimit nga liria. Gjatë vizitës së repartit të mbyllur të Burgut Shkup, MPN-ja, me kërkesë të tyre, realizoi bisedë me katër persona. pjesëtarë të bashkësisë etnike të romëve, të vendosur në një hapësirë të njëjtë. Gjatë bisedës, MPN-ja pranoi ankesa serioze për keqtrajtim fizik dhe detyrim për punë të këtyre personave nga ana e personave të tjerë të dënuar, të vendosur në repartin e mbyllur. Përkatësisht, personat kanë cekur se i kryejnë punët e rregullta të rojës për të gjithë personat e dënuar të vendosur në këtë repart. MPN-ja konsideron se ky institucion, pa dallim se a është në bazë vullnetare ose jo-vullnetare, është e palejueshme dhe në kundërshtim me orarin e rojës të përgatitur nga Sektori për Risocializim. Në lidhje me keqtrajtimin fizik, ishte dukshme frika e cila ekzistonte tek këta persona derisa bisedonin vetëm për vetëm me përfaqësuesit e MPN-së, duke theksuar vazhdimisht se frikësohen nga hakmarrjet, për shkak se kanë vendosur të flasin hapur për këtë problem të tyre. Njëri nga personat u ankua, se një ditë para vizitës, është rrahur dhe keqtrajtuar nga ana e personave të tjerë të dënuar (të vendosur në një dhomë tjetër të repartit të mbyllur), ndërsa një person tjetër, edhe pse vetëm para disa ditësh ishte vendosur në repartin e mbyllur, u ankua se ishte rrahur dhe goditur me duar dhe këmbë nga persona të tjerë të dënuar, me ç'rast kishte marrë gërvishtje nëpër shpinë. Gjatë bisedës, disa persona kanë provuar të hyjnë në dhomë dhe të kontrollojnë nëse këta persona ankohen në lidhje me punën e rojës së detyruar dhe dhunën nga ana e personave të tjerë të dënuar, një gjë që te MPN shkaktoi dyshim për dhunë të mundshme në të ardhmen mbi të njëjtët. Ata konsideronin se e gjithë kjo u ndodh për shkak të përkatësisë së tyre etnike, më saktë se personat u takojnë bashkësisë rome.

Në drejtim të veprimit parandalues, MPN-ja menjëherë e ka thirrur nëpunësin përgjegjës-komandant, me të cilin u diskutua problemi në drejtim të gjetjes së zgjidhjes përkatëse. Gjithashtu, MPN-ja për këtë problem bisedoi edhe me dy edukatorët (përgjegjës për repartin e mbyllur dhe për repartin e pranimit). Njëri nga edukatorët pohoi se po atë ditë ishte njoftuar me situatën e tillë gjatë bisedës së zhvilluar me njërin nga personat që iu ankuan MPN-së, për të cilën gjë tashmë kishte hartuar edhe një shënim zyrtar me të cilin do të kërkojë veprim përkatës nga Shërbimi i sigurimit dhe zhvendosjen e personave të dënuar nga reparti i mbyllur në një pjesë tjetër të burgut.

MPN-ja kërkoi nga të gjitha shërbimet e burgut të punojnë në mënyrë të koordinuar, me qëllim të zbulimit në kohë të rasteve të diskriminimit etnik, fetar ose të llojeve tjera të diskriminimit të një popullsie të caktuar në burg nga ana e të tjerëve, ndërsa në drejtim të parandalimit të rreziqeve të mundshme të torturës ose trajtimit tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues. Mosmarrja e masave parandaluese dhe reaktive, në raset e dhunës midis vet personave të dënuar nga ana e shërbimeve të burgut (pasivitet gjatë parandalimit dhe /ose mosfekasitet gjatë mbrojtjes), mund të arrijë një shkallë

të shkëlqes së të drejtës së mbrojtjes nga tortura dhe trajtimit tjetër çnjerëzor ose degradues, të mbrojtura me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

MPN-ja i rekomandoi drejtorisë së Burgut Shkup të vendosë prezencë fizike 24-orëshe dhe mbikëqyrje të Sektorit të Sigurimit në repartin e mbyllur, ndërsa në drejtim të reduktimit të rreziqeve të mundshme të dhunës midis popullsisë së dënuar. Megjithatë, rekomandimi i tillë pjesërisht u pranua nga ana e drejtorisë së burgut me arsyetimin se prezenca fizike e një anëtari të Sektorit të Sigurimit bëhet gjatë periudhës nga ora 22:00 deri në orën 08:00, ndërsa në pjesën tjetër të ditës mbikëqyrja dhe kontrolli bëhet nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të rregullta të përditshme të Sektorit të Sigurimit.

Edhe gjatë vizitës së Burgut Strumicë, MPN-ja realizoi bisedë me një grup personash të dënuar të përkatësisë etnike rome, të cilët u ankuan për keqtrajtim, si dhe për përcmim nga persona konkret të punësuar në Shërbimin e Sigurimit. Në këtë pjesë, MPN-ja e informoi drejtorinë e burgut se në Sektor ekzistojnë ankesa për keqtrajtim fizik nga persona konkret të punësuar në Shërbimin e Sigurimit, me ç'rast drejtoria ka dhënë një informacion se kundër njërit zyrtar është në rrjedhë procedura disiplinore për shkak të informatave për keqtrajtim fizik, ndërsa për personin tjetër deri më tani nuk kishte pasur ankesa të llojit të tillë. Drejtori e lajmëroi ekipin e MPN-së se gjithmonë, kur merr informacione të këtij lloji, zbaton hetim dhe procedurë përkatëse, megjithatë ekziston edhe kolegjaliteti mes personave zyrtarë, të cilët zakonisht këtë lloj të keqtrajtimit fizik e bëjnë jashtë pjesës që përfshihet me monitorim nga kamaret e instaluar në burg.

MPN-ja u referohet rekomandimeve të KPT-së, që kujdesin të cilin Sektori i Sigurimit është i detyruar t'u ua ofrojë personave që janë nën përgjegjësinë e tij e përfshin edhe përgjegjësinë për t'i mbrojtur nga burgosurit e tjerë të cilët duan t'u shkaktojnë dëm. Zgjidhja e problemit të dhunës mes të burgosurve, kërkon që personeli i burgut të jetë i vendosur në atë nivel, duke përfshirë edhe përfaqësimin e tij, ta kryejë punën dhe detyrat e tij për supervision në mënyrë përkatëse. Personeli i burgut duhet të reagojë në shenjat e shqetësimit dhe të jetë i vendosur dhe i trajnuar në mënyrë përkatëse për të intervenuar kur do të ketë nevojë⁶⁵.

Si veçanërisht të pambrojtur, MPN-ja e vlerësoi edhe gjendjen me romët e vendosur në repartin shkollor (të ashtuquajtur shkollorët) në ENK "Idrizovë". Reparti shkollor është i destinuar për personat e dënuar të cilët nuk e kanë përfunduar arsimin fillor dhe të mesëm dhe në cilën klasë do të duhej ta rumbullakojnë procesin arsimor. Në praktikë, në këtë repart pjesa më e madhe e personave të vendosur të dënuar janë romë.

Gjatë bisedës me personat në repartin shkollor u vu në pah se sjellja e të punësuarve në Sektorin e Sigurimit është jo-korrekte, në situata të caktuara kanë thënë se ka ndodhur që të ofendohen në bazë etnike nga të punësuarit e Shërbimin e Sigurimit, si dhe për shkak se shumica e personave të vendosur në këtë repart janë raste sociale. Ekipi i MPN-së ishte edhe dëshmitar i drejtpërdrejtë i sjelljes jo-korrekte të njërit nga të punësuarit në Sektorin e Sigurimit.

Personat i konsumojnë vaktet në hapësirat në të cilat e kalojnë natën. Në repartin shkollor nuk ka dhomë të veçantë për qëndrim ditë – personat, pjesën më të madhe të ditës e kalojnë në hapësirat e tyre (dhomat e fjetjes) ose në korridorin e përbashkët. Vetëm një person, nga 72 persona që vuajnë dënimin me burg në repartin shkollor, ishte i angazhuar me punë. Këta persona, pjesën më të madhe të ditës e kalojnë në dhomat e tyre dhe në korridorin e përbashkët brenda repartit.

MPN-ja e vlerëson vendosjen dhe gjendjen e romëve në repartin shkollor të ENK "Idrizovë" si tejet poshtëruese, duke pasur parasysh se në dhomat dhe në korridorin ku personat e kalojnë pjesën më të madhe të ditës (madje edhe 22 orë) ekzistojnë kushte

⁶⁵ Pasusi 27, fragment nga Raporti i përgjithshëm i 11-të [CPT/Inf(2001)16].

jashtëzakonisht jo-higjienike. Ekziston mbipopullim dhe nuk plotësohen standardet themelore minimale për vendosjen e personave të privuar nga liria, ndërsa personat e privuar nga liria konsiderojnë se raporti i një pjese të të punësuarve në Sektorin e Sigurimit është jo-korrekt për shkak të përkatësisë së tyre etnike.

Persona të dënuar – përdorues të drogës

Gjatë vizitës së institucioneve ndëshkuese-korrektuese, MPN-ja konstatoi se në shumicën prej tyre zbatohet terapia e metadonit për përdoruesit e drogës, megjithatë në asnjë nga institucionet nuk ndërmerret ndonjë masë tjetër, e as nuk zbatohen programe të tjera në drejtim të zvogëlimit të dëmeve.

Si veçanërisht kritike, MPN-ja e vlerësoi gjendjen me vendosjen e përdoruesve të drogës, të cilët dënimin me burg e vuajnë në ENK "Idrizovë" – Shkup, ku funksionon një qendër e veçantë metadoni me një ekip ekspertësh që është përgjegjës për trajtimin dhe shpërndarjen e terapisë për 128 përdorues të terapisë së metadonit. Për përdoruesit e terapisë së metadonit udhëhiqen kartonë të veçantë, ndërsa personat nënshkruajnë marrëveshje me të cilën janë dakord që të përfshihen me terapinë dhe detrohen të bëjnë kontroll të rregullt të urinës.

MPN-ja konstatoi se këta persona ndahen (segregohen) nga personat e tjerë të dënuar, në atë mënyrë që pjesa më e madhe e tyre janë të vendosur në stacionarin e burgut. Edhe pse stacionari është i paraparë për vendosje spitalore (hospitalizim) të pacientëve, MPN-ja konstatoi se pjesa më e madhe e personave ishin të dënuar të cilët janë përdorues të terapisë së metadonit. Prandaj, personat të cilët janë vendosur aty nuk janë persona të sëmurë, për të cilët është i nevojshëm një kujdes shtesë mjekësor, por përkundrazi, të njëjtët janë të ndarë dhe të vendosur në një ndërtesë të veçantë vetëm për shkak të gjendjes së tyre – përdorues të narkotikëve.

Në këtë mënyrë bëhet diskriminim i drejtpërdrejtë i kësaj kategorie të personave të dënuar dhe mbylljes së tyre, d.m.th., janë vënë në një gjendje të pafavorshme dhe janë vendosur në kushte të papërshtatshme, si dhe janë ndarë nga të dënuarit e tjerë vetëm për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore, përkatësisht për shkak se janë përdorues të terapisë së metadonit. MPN-ja shprehu shqetësim që përdoruesit e terapisë së metadonit, trajtimin mjekësor e marrin në kushte të papërshtatshme, të ndarë nga personat e tjerë dhe të vendosur në një gjendje më të keqe se sa në kapacitetet e tjera të vendosjes. Sipas Rekomandimit nr. R (98)73 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, deri te shtetet anëtare në lidhje me aspektet etike dhe organizuese të mbrojtjes shëndetësore në burg *"kurimi i të burgosurve të cilët kanë probleme në lidhje me përdorimin e alkoolit dhe drogës duhet të përparohet, veçanërisht duke i pasur parasysh shërbimet që duhet të jepen të varurve nga droga, sipas rekomandimeve të Grupit për bashkëpunim kundër keqpërdorimit të drogës dhe tregtisë së palejueshme me droga ("Grupi Pompidu")*. Mjekimi i simptomave, të heqjes dorë nga abuzimi i drogës, alkoolit ose medikamenteve, në burg duhet të zbatohet në të njëjtën mënyrë si edhe në bashkësi"⁶⁶.

⁶⁶ Recommendation No R (98) 7 concerning the ethical and organisational aspects of health care in prison.

Persona të dënuar me sëmundje mendore

Gjendja me personat e dënuar me sëmundje mendore është sidomos shqetësuese në ENK "Idrizovë"-Shkup. MPN-ja, me ndihmën e bashkëpunëtorit të jashtëm-psikiatrin, në bisedat e zhvilluara me personat e dënuar konstatoi se në ENK "Idrizovë"-Shkup janë vendosur persona me vështirësi psikike të cilët kanë mendime paranoide. Te një pjesë e tyre, me ekspertizë është konstatuar përgjegjësi e pjesëshme, ndërsa për një person të dënuar u konstatua se nga viti 2008 ka probleme psikike.

Për një person, që ka shprehur qëllime suicidale, në kartonin e tij në mënyrë të rregullt ishin shënuar çrregullimet, diagnoza psikike dhe masat e ndërmarra. I njëjti person ka marrë masën - izolim për shkak të vetëlëndimit, ndërsa mjeku ka konstatuar se personi është i aftë për vuajtjen e masës. MPN-ja shpreh shqetësim, për shqiptimin e masës izolim të një personi tek i cili është konstatuar çrregullim disocial dhe person që dëshiron të vetë-lëndohet. Edhe pse në karton është regjistruar se personi është kontrolluar çdo ditë nga ana e mjekut, derisa ka qenë në vuajtjen e dënimit me izolim, megjithatë, MPN-ja konsideron se qëllimet suicidale nuk duhet të dënohen me izolim, por ata persona duhet të jenë nën mbikëqyrje dhe kujdes të forcuar psikiatrik.

Personat me sëmundje mendore vendosen në më shumë reparte të ENK "Idrizovë" – Shkup, MPN-ja në këtë drejtim e përkujtoi drejtorin e Entit dhe Drejtorinë për Ekzekutimin e Sanksioneve se Rregullat Evropiane të Burgjeve përcaktojnë "*për personat me çrregullime mendore ose anomalitë duhet të ekzistojnë ente të specializuara ose reparte nën kontroll mjekësor për vëzhgim dhe mjekim, ndërkaq vëmendje e veçantë i përkushtohet parandalimit të vetëvrasjeve*"⁶⁷. Njëkohësisht, këtu duhet të kihet parasysh Rekomandimi nr. **R (98) 73** i Komitetit të Ministrave deri te shtetet anëtare në lidhje me aspektet etike dhe organizuese të mbrojtjes shëndetësore në burg, me të cilët kërkohet "*personave të dënuar për vepra penale seksuale duhet t'u bëhen analiza psikiatrike dhe psikologjike, si edhe mjekim përkatës derisa janë në burg dhe pas kësaj. Të burgosurit që vuajnë nga një çrregullim i vështirë shpirtëror duhet të vendosen dhe të përkujdesen në repartin spitalor, që është i pajisur në mënyrë adekuate dhe ku janë të punësuar kadro të trajnuara në mënyrë përkatëse. Vendimin për pranimin e të burgosurit në spital publik duhet ta marrë psikiatri, ndërkaq i njëjti i nënshtrohet edhe miratimit nga organet kompetente*".

MPN-ja, me keqardhje konstaton se, për shkak të mosekzistimit të parakushteve përkatëse materiale-teknike, në praktikë nuk zbatohet neni 128 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve dhe neni 31 i Ligjit për shëndetin mendor, më saktë personat e dënuar, të cilët gjatë vuajtjes së dënimit do të sëmurën nga ndonjë sëmundje mendore ose manifestojnë çrregullim të vështirë psikik, të konstatuar nga psikiatri, organi kompetent për ekzekutimin e sanksioneve nuk i dërgon në institucion përkatës shëndetësor për mjekim dhe ruajtje. Këta persona, krahas përcaktimeve të dokumenteve ndërkom-bëtare dhe kornizës ekzistuese ligjore vendase, dënimin me burg e vuajnë në repartet e rregullt të ENK "Idrizovë"-Shkup, ndërsa disa prej tyre në mënyrë të përkohshme vendosen edhe në repartin e paraburgimit i cili është i vendosur në rrethin e Qendrës Klinike në Shkup.

⁶⁷ Pika 47.1 e Rregullave evropiane të burgjeve.

Persona të dënuar me invaliditet

MPN-ja si më shqetësuese e theksoi gjendjen në ENK "Idrizovë"-Shkup ku në kushte krejt degraduese dhe çnjerëzore vendosen personat me invaliditet, më saktë të njëjtët vendosen në kushte më të këqija, krahasuar me personat e tjerë të dënuar. MPN-ja konsideron se gjendja e tillë mund të paraqes bazë për diskriminimin e tyre për shkak të ekzistimit të trajtimit faktik jo të barabartë, me çka këta persona ekspozohen ndaj sjelljes jo të drejtë, degraduese dhe çnjerëzore në krahasim me personat e tjerë në situatë të ngjashme.

MPN ishte shumë i shqetësuar edhe për sjelljen joadekuatë të shërbimeve (me theks të Sektorit të Sigurimit, edukatorit dhe shërbimit mjekësor përgjegjës për repartin e hapur), të cilët kanë lejuar që një person me nevoja të posaçme, të cilit i është amputuar njëra këmbë, të vendoset në një hapësirë grupore të repartit ku nuk ka kurrfarë parakushte për vendosje dhe jetesë në kushtet e burgut⁶⁸. Gjatë vizitës së repartit të pranimit, MPN-ja vërejti edhe një të dënuar e cila ishte invalid e përhershme me protezë në njërin këmbë, e cila dukshëm e kishte të kufizuar mënyrën e lëvizjes së pavarur dhe e njëjta varej nga ndihma e të dënuarave të tjera. MPN-ja konsideron se edhe ky person nuk i ka kushtet e nevojshme për vendosje dhe jetë në ENK "Idrizovë"-Shkup.

Trajtimin e këtyre dhe mosdërmarrjen e masave përkatëse parandaluese, MPN-ja e konsideron si një trajtim krejt degradues dhe çnjerëzor dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me detyrimet që dalin nga disa akte ndërkombëtare: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁶⁹ dhe sidomos Konventa për të Drejtat e Personave me Pengesa: "*Vendet nënshkruese sigurojnë se, nëse personat me invaliditet janë të privuar nga liria nëpërmjet procedurës, ata në bazë të njëjtë me të tjerët, kanë të drejtën e garantimeve në përputhje me të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe trajtohen në përputhje me qëllimet dhe parimet e kësaj Konvente*". Gjatë vendosjes së personave të dënuar me invaliditet, MPN-ja kërkon të respektohet parimi i "*përshtatjes së arsyeshme*", që nënkupton një modifikim të domosdoshëm dhe përkatës dhe përshtatje duke mos shkaktuar një ngarkesë jo-proporcionale dhe të papërshtatshme, nëse është e domosdoshme në ndonjë rast konkret, për t'u siguruar personave me invaliditet t'i gëzojnë ose realizojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në bazë të njëjtë me të tjerët⁷⁰.

Persona të mbajtur në stacionet policore – përdorues të alkoolit

MPN-ja konstatoi se në rastet kur te personat e mbajtur në stacionet policore konstatohet një shkallë më e lartë e alkoolizimit, për një pjesë të këtyre rasteve në mënyrë parandaluese nuk është lajmëruar mjeku nga ana e udhëheqësit të turnit ose një person tjetër zyrtar, edhe pse në procesverbalin e mbajtjes së personit është konstatuar se personat kanë shfaqur shenja të dukshme të alkoolizimit. Në një rast, per-

⁶⁸ Kjo hapësirë u mbyll me kërkesë të MPN-së.

⁶⁹ MPN vë në pah Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin D. G. v. Poland (no. 45705/07). Aplikuesi, paraplegjik në karrocë invalide i cili ka pasur edhe një sërë probleme të tjera shëndetësore, është ankuar se kushtet e vuajtjes së dënimit me burg nuk ishin përkatëse me nevojat dhe gjendjen e tij shëndetësore. Në mënyrë të veçantë ankohej se kushtet materiale nuk ishin të përshtatura për personat në karroca invalide, të cilat i kanë shkaktuar problem serioz gjatë qasjes deri në nyjet sanitare, dhe ka konsideruar se në hapësira ka pasur mbipopullim dhe është dashur ta ndajë dhomën e fjetjes me njerëz që pinë duhan. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka konstatuar shkelje të nenit 3 të Konventës, para se gjithash duke pasur i parasysh kushtet materiale në burg, nga aspekti i nevojave të posaçme, të cilat ky person i ka pasur.

⁷⁰ Neni 14, paragrafi 2 në lidhje me nenin 2 – Konventa për të Drejtat e Personave me Pengesa të Kombeve të Bashkuara, e ratifikuar nga Republika e Maqedonisë në dhjetor të vitit 2011.

soni i mbajtur ka shfaqur shenja të dukshme të dehjes (përqindje të lartë të konstatuar të alkoolit në gjak prej 3,05%), megjithatë, nëpunësi i cili e ka plotësuar procesverbalin ka vlerësuar se nuk ka nevojë për mjek (në SP Kavadar). Në katër nga dosjet e kontrolluara të personave të mbajtur në SP Dellçevë ishte konstatuar se personat ishin në gjendje të alkoolizuar dhe atë nga 1.50% deri 3.30%, megjithatë në asnjërin nga këta raste nuk është thirrur mjeku nga ana e udhëheqësit të turnit, edhe pse në procesverbalin e mbajtjes së personit është konstatuar se personat kanë shfaqur shenja të dukshme të alkoolizimit.

Në stacione të caktuara policore, në raste të mbajtjes së personave me lëndime të dukshme ose me përqindje të lartë të alkoolit, në mënyrë parandaluese thirret mjeku i cili duhet ta vlerësojë gjendjen shëndetësore të personave të mbajtur (shembull, SP Strugë, SP Gjorçe Petrov dhe të tjera). Në një rast, personit të mbajtur, tek i cili ishte konstatuar 1.76% alkool, është thirrur mjeku, dhe ishte plotësuar procesverbali për të drejtën e mjekut dhe në regjistrin e personave të thirrur, të arrestuar ose të mbajtur ishte regjistruar se personi i njëjtë ka marrë ndihmë mjekësore (në SP Kratovë). Në një rast tjetër, MPN-ja konstatoi se për personin ishte konstatuar nevoja për mjek për shkak të ekzistimit të lëndimeve të dukshme dhe gjendjes së alkoolizimit prandaj dhe në mënyrë përkatëse ishte thirrur ndihma e shpejtë, për të cilën ka edhe një shënim përkatës me nënshkrim dhe vulë të punëtorit mjekësor (SP Gjevgjeli).

MPN-ja konsideron se stacioni policor, detyrimisht duhet të thirr mjek në rastet kur konstatohet nivel i lartë i alkoolizimit të personit të mbajtur, pa dallim nëse ky person kërkon apo jo ndihmë mjekësore, ndërsa me qëllim që të veprohet në mënyrë parandaluese në drejtim të mbrojtjes me kohë të shëndetit të personit të privuar nga liria. Nëse personi i alkoolizuar nuk dëshiron ta shfrytëzojë të drejtën e mjekut, e njëjta në mënyrë përkatëse duhet të evidentohet nga ekipi mjekësor dhe nëpunësit policorë.

6 REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

Avokati i Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional, në përputhje me autorizimet e tyre që dalin nga OPKAT-i dhe nga Ligji për Avokatin e Popullit, pas çdo vizite dërgon raport të veçantë, i cili përmban analizë të detajuar të gjendjeve dhe masave konkrete për përmirësimin e mangësive dhe shmangien e rreziqeve të identifikuara. Rekomandimet, të cilat i përmban ky Raport vjetor, janë të përgjithshme dhe paraqesin udhëzime të përgjithshme, në përputhje me gjendjet dhe trendet e konstatuara gjatë vizitave të realizuara të rregullta dhe për ri-kontroll gjatë vitit 2012, ndërsa me qëllim të veprimit parandalues nga ana e organeve përkatëse shtetërore.

Rekomandime për përmirësimin e bashkëpunimit:

- Organet dhe institucionet ta forcojnë dhe thellojnë bashkëpunimin me Avokatin e Popullit – Mekanizmin Parandalues Nacional në pjesën e dërgimit të përgjigjeve cilësore dhe në kohë sipas raporteve të veçanta.
- Rritje e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të Mekanizmit Parandalues Nacional të drejtuara deri te vendet e privimit nga liria dhe ministritë përkatëse.
- Organet e drejtorisë shtetërore të dërgojnë përgjigje sipas mendimeve dhe iniciativave të parashtruara nga MPN-ja për ndryshimin dhe plotësimin e kornizës ligjore, e cila ka të bëjë me kushtet, trajtimin dhe realizimin e të drejtave të personave në vendet e privimit nga liria.

Rekomandime për stacionet policore:

- Hetim në kohë dhe efikas për të gjitha pohimet për keqtrajtim fizik dhe pamundësi për realizimin e të drejtave të përcaktuara në procedurë policore nga ana e personave të privuar nga liria.
- Vazhdimi i procesit të rinovimit të hapësirave për mbajtje në stacionet policore, në përputhje me kornizën e caktuar të veprimit, me qëllim të plotësimit të standardeve minimale ndërkombëtare për vendosjen dhe mbrojtjen e personave të privuar nga liria.
- Hapësirat e vjetra, të cilat nuk përdoren në stacionet policore, në mënyrë të dukshme dhe përkatëse të riadaptohen me qëllim të shmangies së çfarëdo lloji keqpërdorimi gjatë trajtimit të personave të privuar nga liria.
- Gjatë projektimit dhe realizimit së ndërtimit të tualeteve, në vendet e reja të mbajtjes, të merren parasysh rreziqet e sigurisë, të cilat mund të shfaqen në objektin për mbajtjen e personave të privuar nga liria.
- Vendosja e platformave për qasje si në hyrjen e stacioneve policore, ashtu edhe në hyrjet e hapësirave të mbajtjes, me çka do të ketë një qasje të ndjeshme ndaj kategorive të pambrojtura të personave, si edhe zbatimi i dispozitave të Konventës së KB-së për të Drejtat e Personave me Pengesë.
- Stacionet policore, të cilat me vendim janë caktuar si vende të mbajtjes në mënyrë përkatëse duhet të pajisen me makina të reja transporti, të cilat i plotësojnë

masat e sigurisë-mbrojtjes për transferimin e personave të privuar nga liria.

- Biseda me personat e privuar nga liria të realizohet në hapësira të shënuara në mënyrë të veçantë në stacionet policore dhe sidomos kjo të praktikohet atje ku janë ndërtuar hapësira të reja për marrje në pyetje, në të cilat është vendosur videombikëqyrja, si dhe masa të tjera të sigurisë.

- Informimi në kohë dhe udhëzimi/mësimi për të drejtat e personave të privuar nga liria, si dhe realizimi i të drejtave të tjera gjatë mbajtjes në stacionin policor, me theks të veçantë për realizimin e së drejtës së mjekut për personat që kanë lëndime të dukshme ose shenja të sëmundjes, alkoolizimit ose janë nën veprim të narkotikëve. Në mënyrë të detyrueshme duhet të thirret mjeku në raste të këtilla, pa dallim nëse personi kërkon apo jo ndihmë mjekësore, me qëllim që të vepohet në mënyrë parandaluese në drejtim të mbrojtjes në kohë të shëndetit të personit që është i privuar nga liria.

- E drejta e ushqimit dhe ujit të rregullohet me ligj së bashku me të drejtat e tjera që u garantohen personave të privuar nga liria dhe jo kjo të rregullohet vetëm me një akt të brendshëm nënligjor, ndërsa realizimi i kësaj të drejte të evidentohet me plotësimin e shënimit zyrtar.

- Plotësim i detajuar, i plotë dhe në kohë i evidencave, të cilat kanë të bëjnë me personat e arrestuar dhe të mbajtur, me theks të veçantë të procesverbalit për mbajtjen e personit dhe procesverbalit për udhëzim/mësim dhe realizimin e të drejtës për mbrojtës dhe të drejtave të tjera. Sidomos gjatë plotësimit të evidencave të merret parasysh rrjedha logjike e ngjarjeve, nga koha e privimit nga liria deri te mbajtja në stacion policor, me qëllim të përcaktimit me rregull të kohëzgjatjes totale të privimit nga liria.

- Është i nevojshëm edhe unifikimi i praktikave të mira në mënyrën e udhëheqjes së regjistrave dhe evidencave dhe trajtimit me personat e privuar nga liria në nivel të territorit të Republikës së Maqedonisë.

Rekomandime për institucionet ndëshkuese-korrektuese:

- Mekanizmi Nacional Parandalues e sugjeron nevojën për krijimin e kushteve reale për implementimin e plotë të Rregullave Evropiane të Burgjeve dhe standardeve të tjera relevante ndërkombëtare, si dhe realizimin e plotë të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve në praktikë.

- Me qëllim të parandalimit të shfaqjes së dukurive të mundshme të torturës ose formave të tjera të trajtimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose degradues, nevojitet ndërmarrja e masave për parandalimin e dhunës fizike dhe vetëlëndimin, si dhe analizimin dhe konstatimin e të gjitha rrethanave sipas ankesave individuale dhe rasteve të dhunës së personave të arrestuar dhe të dënuar. Shteti duhet të ndërmerr hapa konkret dhe serioz në drejtim të zvogëlimit të mosndëshkimit dhe përcaktimit të përgjegjësisë së autorëve të mundshëm.

- Vendosja e një sistemi të trajnimeve të vazhdueshme për të punësuarit në INK, me theks të trajnimeve për të punësuarit në sektorët e sigurimit në drejtim të veprimit profesional, etik dhe pa dhunë me personat e privuar nga liria, respektimit të të drejtave të njeriut dhe përdorimit të lejuar të mjeteve të detyrimit.

- Përmirësimi i kushteve materiale të vendosjes së personave të dënuarve dhe të paraburgosur, duke i respektuar rekomandimet minimale ndërkombëtare dhe standardet vendase dhe zvogëlimi i mbipopullimit në institucionet ndëshkuese-korrektuese.

- Krijimi i reparteve të pranimit në të gjitha institucionet ndëshkuese-korrektuese, të cilët fizikisht do të ishin të ndarë nga repartet e tjerë, me qëllim që të mundësohet një proces cilësor i pranimit dhe adaptimit, si dhe të zvogëlohet shkalla e infeksionit kriminogjen gjatë pranimit.

- Sigurimi i mbrojtjes së vazhdueshme, cilësore dhe në kohë shëndetësore nëpërmjet sigurimit të qasjes dhe kushteve të shërimit, ndërsa në përputhje me rregullat e KB-së, Rregullat Evropiane të Burgjeve, rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe rekomandimet e OBSH-së.

- Sigurimi i ushqimit cilësor dhe të shumëllojshëm për personat e paraburgosur dhe të dënuar, i cili nga aspekti i sasisë do t'i plotësojë nevojat dhe do ta plotësojë vlerën energjike të vakteve të parashikuara me ligj.

- Të sigurohen kushte për realizimin papengesë të arsimit fillor dhe të mesëm në përputhje me ligjin, si dhe të inkuorohen programe për aftësimin profesional të popullsisë së dënuar.

- Krijimi i parakushteve të domosdoshme materiale në drejtim të motivimit të personave të dënuar për të rritur angazhimin e tyre të punës, si promotor themelor në procesin e risocializimit, që paraqet funksion themelor të institucionit ndëshkues-korrektues.

- Respektimi i standardeve ndërkombëtare dhe rekomandimeve në pjesën e kushteve të vendosjes dhe jetës së personave të dënuar me nevoja të posaçme, si dhe realizimi në praktikë i parimit të "përshtatjes së arsyeshme".

- Veprimi, trajtimi dhe strehimi i personave të paraburgosur dhe të dënuar me sëmundje mendore, në përputhje me të Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rekomandimin (98) 73 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës dhe Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve.

- E drejta e qëndrimit në ambient të hapur të realizohet çdo ditë për të gjitha kategoritë e personave të dënuar, në përputhje me rregullat ligjore në fuqi.

- Rritja e numrit të të punësuarve në institucionet ndëshkuese-korrektuese, në përputhje me aktet e konstatuara të sistematizimit, sidomos në Sektorin e Sigurimit, Sektorin e Risocializimit dhe Sektorin e Mbrojtjes Shëndetësore.

- Udhëheqja me rregull e evidencave për personat e privuar nga liria, sidomos në pjesën e plotësimin të regjistrave, në të cilët regjistrohet çdo përdorim i mjeteve të detyrimit, nëpërmjet evidentimit të detyrueshëm të çdo përdorimi të mjeteve për lidhje dhe ndarje si një mjet detyrimi.

Rekomandime për spitalet psikiatrike:

- Përmirësimi i kushteve materiale në drejtim të plotësimin të standardeve të dëshiruara: rinovimi i objekteve të vjetra të vendosjes, përmirësimi i gjendjes në nyjet sanitare dhe adaptimi i të njëjtave për këtë kategori personash, sigurimi i krevateve të reja dhe dyshekëve për fjetje për çdo pacient të vendosur në spitalin psikiatrik, si dhe përmirësimi i ngrohjes dhe ventilimit në hapësirat e vendosjes.

- Zvogëlimi i mbipopullimit në disa nga repartet e spitaleve psikiatrike, njëkohësisht në repartet e psikiatrisë urgjente dhe repartet akute të vendosen vetëm pacientë të shqetësuar dhe violentë, d.m.th. pacientë akut, e jo edhe persona me gjendje kronike afatgjatë që janë në një gjendje më stabile.

- Spitalet psikiatrike në mënyrë përkatëse dhe në tërësi të strukturohen dhe të pajisen me personel i cili do të mund t'i plotësojë nevojat për mjekim, rehabilitim dhe kujdes të pacientëve, si dhe zbatim i edukimit të vazhdueshëm të personelit mjekësor dhe jo-mjekësor për të drejtat e njeriut dhe trajtim njerëzor me personat me sëmundje mendore.

- Ministria e Shëndetësisë, në koordinim me spitalet psikiatrike, të përpilojë një informacion deri te Ministria e Drejtësisë për: zbatimin (ose moszbatimin) në praktikë të dispozitave të nenit 59, paragrafit 2 të Ligjit për procedurë jashtëgjyqësore dhe zbatimin në praktikë të nenit 66 të Ligjit për procedurë jashtëgjyqësore nga ana e gjykatave.

- Në mënyrë përkatëse dhe në mënyrë të rregullt të përdoren Protokollet e miratuar për fiksion (çmobilizim fizik) të pacientëve: krijimi i hapësirave të veçanta për fiksion, të cilat do t'i plotësojnë standardet e dëshiruara, në kohë dhe në mënyrë të rregullt të regjistrohet kohëzgjatja e çmobilizimit fizik në evidencë, ndërkaq derisa një person është fizikisht i çmobilizuar në dhomën e fiksimit, në të njëjtën hapësirë në asnjë rast të mos vendosen në të njëjtën kohë edhe persona të tjerë që janë nën mbikëqyrje të përforcuar dhe të cilët nuk janë të fiksuar.

- Të respektohen dispozitat ligjore në pjesën e sigurimit të dhënies së pëlqimit nga ana e personit gjatë pranimit të tij vullnetar në spitalin psikiatrik, si dhe të respektohet procedura e përcaktuar ligjore gjatë zbatimit të të ashtuquajturit hospitalizim i detyruar.

- Të bëhen përpjekje të vazhdueshme për motivimin e pacientëve në drejtim të përfshirjes së tyre në terapinë me punë ose okupacionale.

- Të përmirësohet kontrolli i cilësisë dhe sasisë së ushqimit, me qëllim që pacientët e vendosur në spitalet psikiatrike të marrin vakte përkatëse me vlerat e nevojshme energjike.

Rekomandime për vendet tjera:

- Përmirësimi i kushteve të vendosjes në Qendrën e Pranimit të të Huajve pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, sigurimi i mbrojtjes shëndetësore më cilësore dhe në kohë, udhëheqje e evidencës përkatëse, në përputhje me ligjin dhe Rendin e shtëpisë dhe sidomos Regjistrin për përdorimin e mjeteve të detyrimit, implementimin e protokollit me shkrim për veprim gjatë dhunës fizike dhe incidenteve midis personave të vendosur në Qendrën e pranimit, si edhe njoftimi në kohë dhe përkatës i të huajve me të drejtat e tyre dhe kushtet e vendosjes, nëpërmjet sigurimit të informacioneve për Rendin e shtëpisë në gjuhën të cilën e kuptojnë.

- Rinovimi, mirëmbajtja në kohë dhe ngrohja e rregullt e hapësirave të vendosjes dhe qëndrimit në IP për Përkujdesin e Fëmijëve me Probleme Edukative-Sociale "Shkup", ndërmarrje e detyrueshme e të gjitha masave ligjore, në raste të kryerjes së veprave me elemente të veprës penale dhe analizë e detyrueshme dhe e detajuar për çdo ankesë nga personat e mitur për dhunë fizike dhe abuzim seksual, ndërkaq me qëllim të zbatimit të procedurës përkatëse dhe përcaktimit të përgjegjësisë. MPN-ja kërkon që ky institucion të vë nën përkujdesje vetëm persona të mitur me probleme edukative-sociale, por jo edhe kryesit e veprave me elemente të veprës penale, me qëllim të tejkallimit të mundësisë nga ndikimi negativ dhe përhapja e infeksionit kriminogjen.

- Përmirësimi i kushteve materiale për vendosjen e personave me pengesa të rënda dhe shumë të rënda në zhvillimin intelektual në Entin Special në Demir Kapi, sigurimi i qasjes pa pengesë i shfrytëzuesve në të gjitha objektet dhe shërbimet e Entit, nëpërmjet përshtatjes së arsyeshme përkatëse, ndërkaq gjatë dhënies së mjeteve të kontracepsionit përdoruesit, gjithmonë të kërkohet dhe të merret pëlqim nga ana e kujdestarit ose përdoruesit. MPN-ja kërkoi të rritet numri i aktiviteteve organizuese jashtë rrethit të Entit në drejtim të përfshirjes së shfrytëzuesve në bashkësi, si dhe procesi i deinstitutionalizimit të zhvillohet në përputhje me parimet dhe qëllimet e përcaktuara në Strategjinë Nacionale për Deinstitutionalizim (2008-2018), me çka në mënyrë të vazhdueshme duhet të reduktohet numri i shfrytëzuesve në Ent.

